

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 2685/4 prot.

Tiranë, më 25.09.2023

Lënda: Dërgohet raporti përfundimtar i auditimit dhe plani i veprimit të zbatimit të rekomandimeve

ZNJ. GERTA LUBONJA
DREJTOR I PËRGJITHSHËM I AGJENCISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE
(AMBU)
Tiranë

Në mbështetje të ligjit nr.114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, të Programit të Angazhimit të Auditimit me nr.2685/1, datë 27.6.2023, Drejtoria e Auditimit, në vijim të procedurave të ndjekura, ka përgatitur raportin përfundimtar të auditimit dhe planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

Referuar legjislacionit të sipërpërmendur, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së raportit përfundimtar të auditimit, duhet të plotësohet, të miratohet dhe të përcillet në Drejtorinë e Auditimit në Kryeministri plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

Bashkëlidhur kësaj shkrese gjeni raportin përfundimtar të auditimit dhe planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Engjëll AGAÇI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA
DREJTORIA E AUDITIMIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE

Tiranë, SHTATOR 2023

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), është person juridik publik, në varësi të Kryeministrit, që financohet nga buxheti i shtetit dhe nga çdo burim tjetër i ligjshëm.

Agjencia është e organizuar dhe funksionon, bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar dhe të VKM nr. 221, datë 26.4.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, i ndryshuar.

Misioni i Agjencisë, është mirëqeverisja e burimeve ujore, me qëllim përmbushjen e të gjitha nevojave jetësore, duke mbajtur në vëmendje qëndrueshmërinë e ekosistemeve, duke nxitur konkurrueshmërinë e përdorimeve dhe prioritizimin drejt përfitueshmërisë ekonomike.

Auditimi i kryer, synoi në përmbushjen e objektivave audituese:

- i. Të ndihmojë Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), në realizimin e objektivave të veprimtarisë institucionale, duke përmirësuar sistemet e menaxhimit dhe të kontrollit.
- ii. Të vlerësojë e japë siguri nëse, sistemet e menaxhimit dhe të kontrollit, të ngritura për përmbushjen e detyrimeve specifike, në cilësinë e përfituesit për projektin “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri”, funksionojnë në mënyrë efikase dhe janë në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullativ.
- iii. Të adresojë rekomandime, për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit dhe të kontrollit objekt auditimi.

Objekti i auditimit të ushtruar në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) është:

- Funksionimi i sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm, për përmbushjen e detyrimeve specifike, në cilësinë e përfituesit për projektin “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri”.

Auditimi u krye për periudhën 1.1.2021 – 31.3.2023.

Në përfundim të misionit të auditimit në institucion, mbështetur në konkluzionet e nxjerra nga vlerësimi i të gjithë dokumentacionit të veprimtarisë audituese, përpara hartimit të projekt raportit, u krye takimi ballafaques me Drejtorin e Përgjithshëm (titullar i institucionit) dhe me Drejtorin e Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik, njëherazi titullar i strukturës përgjegjëse për ndjekjen dhe koordinimin e zbatimit të projektit.

Gjatë këtij takimi, nga grupi i auditimit u bënë prezent dhe u dakortësuan, gjetjet e rekomandimet si dhe afatet e zbatimit të rekomandimeve për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit dhe të kontrollit, objekt auditimi.

Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet e trajtuara në raport, sipas sistemeve të audituara rezultojnë:

1. *Vlerësimi i funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në institucionin e AMBU-t, për përmbushjen e detyrimeve specifike, në cilësinë e përfituesit në kuadër të implementimit të projektit “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri” sikurse përcaktuar në VKM nr. 587, datë 4.9.2019 “Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Austriake të Zhvillimit për projektin “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri”.*

1.1 Vlerësimi i komponentit të mjedisit të kontrollit.

-Mbi kuadrin rregullator institucional dhe termat e kushtet e projektit “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri”.

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (ABU) është e organizuar dhe funksionon, bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar dhe të VKM nr. 221, datë 26.4.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, i ndryshuar.

Kompetencat e Agjencisë, janë përcaktuar në nenin 11, të Ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar si dhe përgjegjësitë dhe detyrat janë përcaktuar në VKM nr. 221, datë 26.4.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”.

Misioni i Agjencisë, është përcaktuar në pikën 2, të Kreut I, të VKM nr. 221, datë 26.4.2018 dhe konkretisht: “Misioni i Agjencisë është mirëqeverisja e burimeve ujore me qëllim përmbushjen e të gjitha nevojave jetësore, duke mbajtur në vëmendje qëndrueshmërinë e ekosistemeve, duke nxitur konkurrueshmërinë e përdorimeve dhe priorizimin drejt përfitueshmërisë ekonomike”.

Me VKM nr. 587, datë 4.9.2019 është miratuar, Marrëveshja e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Austriake të Zhvillimit, për projektin “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri” dhe me VKM nr.764, datë 12.12.2022 është miratuar *Marrëveshja ndryshuese nr.1* e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Austriake të Zhvillimit, për projektin “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri”.

Në Marrëveshjen e miratuar, për projektin “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri” janë përcaktuar ndër të tjera, termat dhe kushtet si më poshtë:

Neni 3 “Qëllimi dhe objektivat e projektit” janë:

Objektivi i përgjithshëm: Kontribuimi për përmirësimin e zbatimit të reformës kombëtare të ujit dhe progresin e Shqipërisë drejt kërkesave të legjislacionit të BE-së për ujin.

Objektivi specifik: Fuqizimi i kapaciteteve për menaxhimin e sektorit në pajtim me politikat e BE-së dhe konsolidimi i përpjekjeve të mëparshme në këtë drejtim.

Në marrëveshje janë përcaktuar dhe *rezultatet e pritshme të projektit* që janë:

Rezultatet e pritshme 1 - RP1

Kuadri ligjor në fushën e menaxhimit të ujit të përmirësohet në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe bazuar në prova të zbatohet dhe të realizohet ë pajtim me kërkesat e BE-së.

Rezultatet e pritshme 2 - RP2

Planet e Menaxhimit të Baseneve të Lumenjve të zbatohen për basene të zgjedhur të lumenjve, dhe në pajtim me kërkesat e BE-së.

Rezultatet e pritshme 3 - RP3

Të forcohet kapaciteti institucional në nivelin e basenit të lumit për të zbatuar Menaxhimin e Integruar të Ujit.

Rezultatet e pritshme 4 – RP4

Kuadri buxhetor dhe analiza ekonomike e përfutimit dhe përdorimit të ujit në nivel baseni të përmirësohet në pajtim me parimet e direktivës kuadër për ujin, struktura tarifore të rishikohet dhe zbatohet.

Agjencia Austriake për Zhvillim (AAZH), bazuar në nenin 2 të Marrëveshjes, realizon zbatimin e kësaj marrëveshje, nëpërmjet Zyrës së saj të Bashkërendimit për Bashkëpunim Teknik të Ambasadës Austriake në Tiranë.

Përfutues i projektit “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri” referuar paragrafit nr. 2, të nenit 2 të Marrëveshjes, është Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i cili *monitoron zbatimin e kësaj marrëveshje*, nëpërmjet Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) .

Në pikën nr. 2, të nenit 4 të Marrëveshjes së projektit, janë përcaktuar *detyrimet specifike të përfutuesit* që përfshijnë:

1.i) Bashkëpunimin me ekipin e Projektit mbi bazë ditore në lidhje me çështjet operationale, duke caktuar një person kontakti; ii) Garantimi i bashkëpunimit ndërmjet grupeve kryesore të interesit; iii) Verifikimi dhe miratimi i të gjitha raporteve të paraqitura nga Agjencia Austriake për Zhvillim (AAZH); iv) Garantimi i pjesëmarrjes aktive në zbatimin e aktiviteteve; v) Sigurimi i të dhënave dhe informacionit të kërkuar dhe, sipas rastit, ofrimi i një zyre për Ekipin e Projektit;

vi) Garantimi i lidhjes së Projektit me politikat kombëtare dhe kuadrin përkatës ligjor për prioritetet e reformës së ujit, me qëllim që tu mundësohet dhe nxitet koherenca e objektivave të Projektit me kushtet e brendshme kuadër;

2. Mbështetja e lehtësimit dhe shpërndarjes së përvojave dhe informacionit, bazuar në rezultatet e arritura dhe ndikimet e projektit në nivel kombëtar;

3. Mbështetja dhe lehtësimi i lidhjes dhe bashkëpunimit me ministritë e institucionet e tjera dhe Bashkitë, Prefekturat dhe zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore që kanë rol thelbësor në zbatimin e projektit;
4. Ofrimi i alokimit të nevojshëm buxhetor për të rimbursuar TVSH-në në lidhje me koston lokale të Agjencisë Austriake për Zhvillim, të përfaqësuar nga Zyra e Koordinimit për Bashkëpunim Teknik të Ambasadës Austriake në Tiranë;
5. Garantimi që dispozitat e përgjithshme për Doganat dhe Përjashtimet Tatimore dhe kushtet për Institucionet e Jashtme, OJQ-të dhe shoqëritë që specifikohen në nenin 5 dhe 6 të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Austrisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin për Zhvillim, zbatohen në kontekstin e zbatimit të Projektit.

Auditimi u fokusua në vlerësimin e përshtatshmërisë, së funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në institucionin e AMBU-së me synim përmbushjen e detyrimeve specifike të përfituesit të projektit, sikurse përcaktuar në Marrëveshje.

-Mbi planin strategjik, planet vjetore operacionale.

-Dokumenti i Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027, miratuar me VKM nr.73, datë 2.2.2018, përmban objektiva strategjike dhe aktivitetet për përmbushjen e objektivave strategjike, ku institucioni i AMBU-së, është një ndër institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre.

Kjo Strategji, është monitoruar dhe me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Ujit nr. 6, datë 31.5.2023, është miratuar “Raporti i monitorimit mbi zbatimin e planit strategjik të veprimit 2019-2022 të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027”.

AMBU në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga kapitulli 5, i Strategjisë ka kryer monitorimin e zbatimit të SKMBIU-së dhe e ka publikuar këtë raport në faqen zyrtare.

-Në nivel vjetor, janë hartuar planet vjetore të punës së institucionit ku qëllimet dhe objektivat institucionale, janë pasqyruar në dokumentet: i) Plani i Punës për Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore për vitin 2021, ii) Plani i Punës për Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore për vitin 2022 dhe iii) Plani i Punës për Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore për vitin 2023, dokumente këto, të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm, respektivisht me shkresat nr. 1501 prot., datë 31.12.2020, nr. 64 prot., datë 11.01.2022 dhe nr. 2132 prot., datë 30.12.2022, duke përcaktuar aktivitetet dhe nënaktivitetet, afatet në funksion të përmbushjes së objektivave për të gjitha strukturat e institucionit (Drejtori, Sektor).

Në lidhje me zbatimin e projektit, rezultuan plane vjetore të punës të zbatimit të projektit për vitet 2021-2022 për secilin nga komponentët e projektit (RP) të dakortësuar me pikat e kontaktit (personat përgjegjës në AMBU) për implementimin e aktiviteteve për secilin nga komponentët e (RP).

Konkluzion: Institucioni ka ushtruar veprimtarinë institucionale bazuar në objektiva strategjike, plane vjetore dhe për implementimin e projektit rezultojnë plane pune vjetore të veçanta, krahas planeve vjetore institucionale. Vlerësohet pozitivisht hartimi i plan veprimeve për arritjen e

objektivave strategjike dhe objektivave periodike në nivel vjetor, konform përcaktimeve të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

-Mbi rregulloren e brendshme të institucionit.

Me Urdhrin nr. 86, datë 26.7.2023 të Kryeministrit, është miratuar rregullorja “Për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Zyrave të Administrimit të Baseneve Ujore”.

Rregullorja ka si qëllim, administrimin e veprimtarisë dhe mirëfunksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, në nivel qendror dhe në nivel baseni ujor.

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të funksionimit, detyrave të strukturave dhe të sjelljes së personelit të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Zyrave të Administrimit të Baseneve Ujore.

Nga auditimi rezultoi se rregullorja e brendshme, përmbush kërkesat në tërësinë e komponentëve strukturorë që kanë të bëjnë me misionin institucional, drejtimin e administrimin e njësive të brendshme strukturore, kompetencat, aktivitetet, përgjegjësitë menaxheriale dhe operacionale, etj, në funksion të sigurimit të një menaxhimi efektiv të institucionit.

Nga shqyrtimi i rregullores, rezulton se në pikën “d” të nenit 11, është përcaktuar ndër të tjera, objekti i veprimtarisë së Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik, si më poshtë vijon:

“Ndjekja apo realizimi i projekteve me financim të brendshëm dhe atyre të financuara nga donatorët dhe partnerët zhvillimorë, si dhe integrimi dhe koordinimi i tyre, duke synuar maksimizimin e përfitimeve dhe realizimin e produkteve të plota dhe funksionale, në kohë, cilësi dhe kosto, në përputhje me prioritetet e sektorit”.

Në pikën nr. 4, të nenit 11, janë përcaktuar detyrat kryesore të Sektorit të Projekteve të Brendshme dhe i Koordinimit të Projekteve me Donatorët.

Rregullorja e Brendshme, është në përputhje me strukturën e miratuar me Urdhrin nr.152, datë 1.10.2018 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, i ndryshuar.

Konkluzion: 1-Institucioni aktualisht funksionon bazuar në një rregullore të miratuar, konform përcaktimit të Kreut II, pika 6, e VKM nr. 221, datë 26.04.2018 dhe që ka të përcaktuara rregullat e funksionimit, detyrat e strukturave dhe të sjelljes së personelit.

2-Njësitë e brendshme strukturore përfshirë, strukturat përgjegjëse (Drejtoria dhe Sektori) për ndjekjen e projektit “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri” i kanë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme rregullat për administrimin dhe funksionimin e tyre.

- Etika dhe politikat e integritetit.

Me qëllim funksionimin efektiv të sistemit të etikës dhe integritetit, në fokus të menaxhimit institucional ka qenë hartimi dhe miratimi i tre dokumenteve, që përmbajnë rregullat për zbatimin e parimeve dhe standardeve të etikës dhe konkretisht:

- i) Rregullorja e sjelljes së nëpunësve të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, e miratuar me urdhrin e Titullarit nr. 179, datë 21.11.2019.
- ii) Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, miratuar me urdhrin e Titullarit nr.181, datë 2.12.2019.
- iii) Rregullorja e brendshme e miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 86, datë 26.7.2023 e cila në nenin 27, “Etika dhe konflikti interesit”, nenin 28, “Konfidencialiteti” dhe nenin 29, “Kodi i veshjes” trajton rregullat e etikës që duhet të zbatohen nga punonjësit.

Sa më sipër vlerësohet pozitivisht hartimi i tre dokumenteve të cilat, rregullojnë parimet dhe standardet e integritetit dhe etikës, të detyrueshme për zbatim nga punonjësit e institucionit.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të sipërcituara, rezultoi:

-Nuk janë reflektuar dhe përshtatur rregullat në Rregulloren e sjelljes së punonjësve dhe në Rregulloren për parandalimin të konfliktit të interesave, sikurse përcaktuar në Kreun VII, pika 1, të VKM nr.874, datë 29.09.2021 “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike” në të cilin përcaktohet që: “Ngarkohen të gjitha institucionet e administratës publike që, brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2022, të hartojnë dhe të përshtatin rregulloret e tyre të brendshme në përputhje me këtë vendim”.

-Në Rregulloren “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore”, miratuar me urdhrin e Titullarit nr.181, datë 2.12.2019, në nenin nr. 17 “Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve premtive ose trajtimeve preferenciale”, janë vendosur përcaktime, referuar VKM nr.714, datë 22.10.2014, “Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit në administratën publike” vendim ky i cili *rezulton i shfuqizuar*, me VKM nr. 874, datë 29.9.2021 “Për miratimin e rregullave të parimeve të etikës të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”.

Konkluzion: Pavarësisht se nga institucioni, është punuar për hartimin e një kuadri rregullator të funksionimit të etikës dhe integritetit, nevojitet reflektimi e përshtatja e tyre, me rregullat sikurse përcaktuar në Vendimin nr.874, datë 29.9.2021 të Këshillit të Ministrave, me efekt vendosjen e kontrolleve shtesë, me qëllim rritjen së efektivitetit të funksionimit të sistemit të etikës dhe integritetit në institucion, për të cilin adresohet rekomandimi si më poshtë:

Rekomandim: Të merren masat për ngritjen e një grupi pune për:

a) Reflektimin e përshtatjen në Rregulloren për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në AMBU dhe në Rregulloren e sjelljes së punonjësve të rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike, sikurse përcaktuar në Vendimin nr.874, datë 29.9.2021 të Këshillit të Ministrave;

b) Rregulloret e ndryshuara të shqyrtohen paraprakisht nga Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe më pas të miratohen nga Titullari i institucionit.

-Mbi zbatimin e nenit 8 "Klauzola kundër korrupsionit" të Marrëveshjes së Projektit "Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri".

Referuar informacionit të paraqitur grupit të auditimit, konstatohet se në asnjë rast, nuk ka rezultuar masë disiplinore për shkelje të etikës apo praktika të kundra ligjshme në referencë të nenit 8, "Klauzola kundër korrupsionit" të Marrëveshjes së miratuar me VKM nr. 587, datë 4.9.2019 për Projektin "Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri".

-Mbi strukturën organizative dhe plotësimin e organikës.

Struktura dhe Organika e institucionit është miratuar me Urdhrin nr.152, datë 1.10.2018 i Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe organikës të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore" i ndryshuar me Urdhrin nr. 17, datë 30.1.2020 të Kryeministrit. Konstatohet se nuk ka pasur ndryshim të strukturës dhe organikës së AMBU, përgjatë gjithë periudhës objekt auditimi.

Nga shqyrtimi i strukturës organizative rezulton se në AMBU, ka një strukturë të posaçme Sektori i Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit me Donatorët e Huaj, të ngarkuar me ndjekjen apo realizimin e projekteve me financim të brendshëm dhe të huaj si dhe koordinimin e tyre me prioritetet e sektorit. Në këtë kuadër ky sektor ndjek dhe koordinon çështjet që kanë të bëjnë me projektin "Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri".

Drejtoria e Menaxhimit Strategjik, e cila ka vartësi të drejtpërdrejtë, nga Drejtori i Përgjithshëm, ka në vartësi Sektorin e Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit me Donatorët, duke siguruar në këtë mënyrë, një strukturë të përshtatshme organizative, linja efektive kontrolli, mbikëqyrje e raportimi çka mundëson kryerjen e përgjegjësive në funksion të realizimit të objektivave.

Bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr.152, datë 1.10.2018 "Për miratimin e strukturës dhe organikës të Agjencisë së Menaxhimit të burimeve ujore", i ndryshuar, numri total i punonjësve të AMBU, është përcaktuar gjithsej 83 punonjës, ndër të cilët 3 punonjës, i përkasin Sektorit të Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët (PIU) dhe që përbëhet nga 3 nëpunës gjithsej, 1 përgjegjës dhe 2 specialist.

Nga auditimi i kryer mbi plotësimin e organikës së Sektorit për periudhën objekt auditimi (1.1.2021 deri në 31.3.2023), rezultoi se nga janar 2021 deri në datën 20.07.2021, Sektori ka funksionuar i plotë. Ndërkohë prej datës 21.07.2021 e në vijim, kjo strukturë ka funksionuar me dy punonjës (1 përgjegjës dhe një specialist) *pra me organikë të paplotësuar.*

Sipas informacionit të paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse (përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore) rezulton se nuk është adresuar kërkesë pranë DAP, për shpalljen e vendit vakant të specialistit, përgjatë periudhës, 21 korrik 2021 – 31.03.2023. Në informacion theksohet se: "Pamundësia fizike për të sistemuar stafin ka bërë që të kemi një priorizim të nevojave urgjente për staf. Ky priorizim është bërë duke përdorur si kriter shpalljen e atyre vakancave në ato sektorë të cilët ushtrojnë funksione teknike".

Konkluzion: 1. Vlerësohet pozitivisht fakti që në AMBU, është ngritur dhe funksionon një strukturë e posaçme (Sektor në vartësi të Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik) e ngarkuar me ndjekjen apo realizimin e projekteve me financim të brendshëm dhe të huaj si dhe koordinimin e tyre me prioritetet e sektorit.

2. Organika e Sektorit rezultoi e paplotësuar me një vend vakant (pozicioni i specialistit) për periudhën nga 20.7.2021, si dhe nuk janë ndërmarrë procedura të rekrutimit, sikurse përcakton kuadri rregullator.

Rekomandim: Me qëllim funksionimin e strukturës së Sektorit të Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit me Donatorët e Huaj me kapacitet të plotë, konform organikës së miratuar, të merren masa për zbatimin e procedurave të rekrutimit, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, deri në plotësimin e vendit vakant.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi.

-Mbi zhvillimin profesional të punonjësve të Sektorit të Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët.

Bazuar në materialin vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezultoi se punonjësit e Sektorit të Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët, kanë ndjekur trajnime të organizuara kryesisht nga ASPA në funksion të rritjes së kompetencave profesionale në ushtrim të detyrave funksionale (trajnime të lidhura me zbatimin e projekteve). Për periudhën 2020-2022, kanë ndjekur 8 ditë trajnime në 5 trajnime të organizuara nga ASPA.

Po kështu punonjësit e sektorit kanë marrë pjesë dhe në trajnimet e zhvilluara nga projekti EUSIWM.

Rekomandim: Në funksion të implementimit të politikave të zhvillimit profesional, të mbajtjes së një personeli kompetent dhe meqenëse AMBU për periudhat në vijim është e angazhuar me implementimin e disa projekteve me financim të huaj, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse (përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore) në bashkëpunim dhe koordinim me Sektorin e Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët (PIU), të marrin masa, për kryerjen e trajnimeve të stafit të Sektorit dhe sigurimin e pjesëmarrjes së tyre jo vetëm në trajnimet e organizuara nga ASPA dhe trajnime të ndryshme të organizuara brenda vendit, por dhe në eventet, trajnime jashtë vendit për marrjen e eksperiencës nga praktikantët më të mira, duke planifikuar dhe efektet financiare.

-Mbi ngritjen dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS).

Nga auditimi i kryer rezultoi, se është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik i institucionit me: i) urdhrin e titullarit nr.7/1, datë 5.1.2021 “Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik për vitin 2021”; ii) urdhrin e titullarit nr.16, datë 12.1.2022 “Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik për vitin 2022” dhe me iii) urdhrin e titullarit nr.13, datë 25.1.2023 “Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik për vitin 2023” duke vepruar në përputhje me përcaktimet e nenit 8, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, në të cilin theksohet që: “Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë

këto kompetenca kryesore...b) ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik të njësisë publike në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji. Neni 27, i ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, i ndryshuar, përcakton që: “Grupi i Menaxhimit Strategjik, përbëhet nga Titullari i njësisë publike, zëvendës titullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë”.

Nga informacioni i dhënë grupit të auditimit nuk rezultojnë gjurmë të funksionimit të ushtrimit të veprimtarisë së GMS-së. (protokolle takimi të GMS-së apo vendime të marra nga GMS), për rrjedhojë është e pamundur të gjykohet ndër të tjera nëse GMS, ka marrë në analizë dhe shqyrtuar çështjet apo problematikat e ndryshme në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të AMBU, në funksion të implementimit të projektit. Sipas informacionit të dhënë për këtë qëllim grupit të auditimit konfirmohet që: “Nuk ka minuta takimi në kuadër të mbledhjeve të Grupeve të i) Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe të Menaxhimit të Riskut (GMR).

Konkluzion:

i) Vlerësohet pozitivisht ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik, konform kërkesave të kuadrit rregullator të MFK-së.

ii) Nuk rezultojnë protokolle të mbledhjeve të GMS-së në funksion të dokumentimit të ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të anëtarëve të GMS-së sikurse përcakton kuadri rregullator.

Rekomandim:

a) Të merren masa për dokumentimin e mbledhjeve, takimeve (jo më pak se katër herë në vit) të grupit të Menaxhimit Strategjik.

b) Vendimet e marra nga GMS duhet të regjistrohen nga sekretari i GMS-së dhe të vihen në dispozicion të drejtimit të institucionit. (pika 2.2.4 e Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016).

1.2 Mbi vlerësimin e komponentit të menaxhimit të riskut.

U auditua procesi i menaxhimit të riskut në zbatim të kërkesave të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Manualit të dalë në zbatim të ligjit dhe Udhëzimit nr.16, datë 20.7.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” nga i cili rezultoi si më poshtë vijon:

- Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut/plani i menaxhimit të trajtimit të riskut, sikurse përcaktohet në pikën nr. 8, të nenit 8, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Konstatohet se në dokumentin e Planit të ngritjes dhe zhvillimit të MFK-së, si për vitin 2021 dhe për vitin 2022 është parashikuar hartimi i këtij dokumenti dhe *nuk është realizuar*.

- Është ngritur Ekipi i Menaxhimit të Riskut, me urdhrin e Titullarit nr. 31, datë 17.3.2023, sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr.16, datë 20.7.2016, pika 4 “Hapat për ngritjen e sistemit të menaxhimit të riskut, krijimi i Ekipit të Menaxhimit të Riskut”. *Nuk rezulton të jetë ngritur Ekipi i Menaxhimit të Riskut për vitin 2021 dhe 2022.*

- Konstatohet se për çdo njësi të brendshme strukturore, përfshi dhe strukturën përgjegjëse

për ndjekjen e projektit “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri”) është hartuar regjistri i riskut për vitet 2021,2022 por këto regjistra nuk rezultojnë të jenë të zyrtarizuar e miratuar nga Titullari i institucionit. Nga shqyrtimi i regjistrave të riskut, rezulton se regjistri i riskut për vitin 2021, është i njëjtë me regjistrin e riskut të vitit 2022, pra nuk është përditësuar.

Konkluzion: Nuk është përditësuar e zyrtarizuar si dhe në disa aspekte, nuk është ngritur kuadri rregullator për trajtimin dhe menaxhimin e risqeve.

Rekomandim:

Me qëllim ngritjen dhe funksionimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të riskut, të merren masat si më poshtë vijon:

a)Të hartohet dokumenti i planit strategjik të menaxhimit të trajtimit të risqeve dhe të merren masa për përditësimin e planit çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Ky dokument përpara miratimit nga Titullari, të diskutohet e miratohet nga GMS.

b)Të analizohen dhe përditësohen, kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit, bazuar në nenin 21 të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për MFK”, i ndryshuar në të cilin përcaktohet që: Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut të paktën një herë në vit. Çdo menaxher i strukturës së AMBU, të analizojë regjistrin e risqeve për strukturën përkatëse, të identifikojë risqet me nivel të lartë dhe të përgatisë planin e veprimit për minimizimin e tyre sipas formatit të aneksit 3 të Udhëzimit nr.16, datë 20.7.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;

1.3 Mbi vlerësimin e komponentit të aktiviteteve të kontrollit. Zbatimi i procedurave për përmbushjen nga AMBU të detyrimeve të Marrëveshjes së projektit.

-Mbi hartimin e Listës së Proceseve të Punës dhe dokumentimin e aktiviteteve të kontrollit.

Dokumentet e Listës së Proceseve të Punës, janë një instrument efektiv për kryerjen e aktiviteteve të kontrollit, në funksion të përmbushjes së përgjegjësiave të punonjësve, në ushtrimin e detyrave të tyre dhe arritjen e objektivave institucionale.

Me qëllim të garantimit të uniformitetit të kryerjes së proceseve të punës, identifikimit të aktiviteteve të kryera, përgjegjësiave, risqeve, dhe afateve për kryerjen e një aktiviteti (proces), rezultoi se janë listuar proceset e punës, dhe aktivitetet e kontrollit për njësitë e brendshme strukturore të institucionit përfshi dhe strukturën që ndjekjen zbatimin e projektit “Mbështetje për menaxhimin e integruar të ujit në Shqipëri” dhe Drejtorinë Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, për fondet e projektit me financim të brendshëm (TVSH) dhe financim të huaj.

Për çdo proces kryesor, janë përcaktuar nën proceset, risqet kryesore për përmbushjen me sukses të procesit operacional, kuadri ligjor dhe afati si dhe struktura përgjegjëse.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të Listës së Proceseve të Punës, rezultoi se këto dokumente, nuk janë të zyrtarizuara (të pa protokolluara), nuk janë të miratuara nga Titullari dhe nuk janë të konfirmuara nga punonjësit/menaxherët e strukturës përkatëse (hartues/përpilues të dokumentit).

Rekomandim: Në funksion të sigurimit të një kuadri rregullativ të përshtatshëm me qëllim ushtrimin e aktiviteteve të kontrollit dhe monitorimit të realizimit të objektivave e detyrave të caktuara, sigurimit të vendosjes dhe ndarjes së përgjegjësisë, të merren masa për zyrtarizimin dhe miratimin nga Titullari e menaxherët e njësisë të brendshme strukturore (drejtori, sektor) të dokumenteve të Listës së Proceeseve të Punës.

- Zbatimi i procedurave për përmbushjen nga AMBU të detyrimeve të Marrëveshjes.

-Mbi përmbushjen e detyrimeve të AMBU për pjesëmarrje në Komitetin Drejtues (KD) dhe koordinimin e bashkëpunimin për zhvillimin e takimeve të KD-së.

Referuar Marrëveshjes së Projektit të miratuar, pika 5.2 me emërtesën “Komiteti Drejtues” e aneksit “Përshkrimi i aktivitetit”, përcakton që:

-Komiteti Drejtues (KD) do të jetë autoriteti i përgjithshëm për aktivitetin dhe do të ofrojë udhëzime të përgjithshme strategjike për zbatimin e aktivitetit. KD-ja do të përbëhet nga përfaqësues të nivelit të lartë të AMBU-së, ZK, ministri të zgjedhura të linjës, përfaqësues të njësisë të qeverisjes vendore, BE-ja dhe AAZH-ja. Takimet e KD-së do të kryesohen nga AMBU-ja dhe do të bashkë-kryesohen nga AAZH-ja.

Nga auditimi rezultoi se:

Në tre mbledhjet e zhvilluara, përgjatë periudhës objekt auditimit (janar 2021 deri në mars 2023), Drejtori i Përgjithshëm ka kryesuar mbledhjet e Komitetit Drejtues me bashkë kryesues Drejtuesin e Zyrës së AAZH-së, duke përmbushur në këtë mënyrë pikën 5.2 të shtojcës së Marrëveshjes në të cilin përcaktohet që: Takimet e KD-së do të kryesohen, nga AMBU-ja dhe do të bashkë-kryesohen nga AAZH-ja.

-Drejtori i Përgjithshëm i AMBU është caktuar në cilësinë e kryesuesit të Komitetit Drejtues duke përmbushur kërkesat e pikës 5.2 me emërtesën “Komiteti Drejtues” (KD) e aneksit “Përshkrimi i aktivitetit” bashkëlidhur, Marrëveshjes së miratuar ku ndër të tjera përcaktohet që: “KD-ja do të përbëhet nga përfaqësues të nivelit të lartë të AMBU”.

-Nga auditimi rezultoi se në mbledhjet e Komitetit Drejtues, kanë marrë pjesë përfaqësues të nivelit drejtues në AMBU : Drejtori i Përgjithshëm, Drejtor i Drejtorisë Menaxhimit Strategjik dhe Drejtor Drejtorie dhe Përgjegjësit e sektorëve të strukturave respektivë në cilësinë e pikat e kontaktit të komponentëve të Rezultateve të pritshme (RP1, RP2 dhe RP4) si dhe përfaqësues nga struktura e ndjekjes së zbatimit të projektit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se, takimet e Komitetit Drejtues, janë zhvilluar në koordinim dhe bashkëpunim me (strukturat respektive në AMBU dhe me njësinë e projektit).

Konkluzion: Vlerësohet pozitivisht përmbushja e detyrimeve nga AMBU për kryesimin dhe përfaqësimin nga niveli i lartë i menaxhimit (Drejtor i Përgjithshëm), për pjesëmarrjen aktive në mbledhjet e Komitetit Drejtues dhe në procesin e koordinimit dhe bashkëpunimit me Njësinë në Zbatuese të Projektit, për organizimin dhe zhvillimin e takimeve të KD-së.

-Mbi përmbushjen e detyrimit për emërimin nga AMBU të një zyrtari kryesor për aktivitetin në emër të Agjencisë dhe hartimin dhe nënshkrimin e Marrëveshjes midis AMBU dhe AAZH-së me objekt: Përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi gjatë fazës së zbatimit të projektit.

Në pikën 5.23 me emërtesën “Roli i vendit partner” të aneksit “Përshkrimi i aktivitetit” bashkëlidhur Marrëveshjes, përcaktohet që: Kreu i AMBU-së pritet të emërojë një zyrtar bashkëbisedues/negociator kryesor për aktivitetin në emër të Agjencisë dhe përveç kësaj ndërmjet AAZH-së dhe AMBU-së do të nënshkruhet një marrëveshje për të përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë gjatë fazës së zbatimit.

Nga auditimi u konstatua se:

1-Nuk rezulton shkresë zyrtare për emërimin e një punonjësi në AMBU si bashkëbisedues/negociator për aktivitetin në emër të Agjencisë. Në praktikën shkresore të audituara si dhe në informacionin e paraqitur grupit të auditimit për këtë qëllim, rezulton që ky rol është kryer nga Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik në vartësi të të cilit është dhe Sektori i Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit me Donatorët e Huaj.

2-Nuk është hartuar dhe nënshkruar marrëveshje midis AMBU-së dhe AAZH-së, për të përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë gjatë fazës së zbatimit.

-Mbi emërimin e personave të kontaktit (pikat fokale) sipas komponentëve të Rezultateve të Pritshme (RP).

Në nenin 4. “Detyrimet e palëve” të pikës 2/a i) të Marrëveshjes së Projektit përcaktohet: Detyrimet specifike të projektit përfshijnë: i) Bashkëpunimin me ekipin e Projektit mbi bazë ditore në lidhje me çështje operationale, duke caktuar një person kontakti.....” . Caktimi i pikave fokale është diskutuar edhe në mbledhjen e Komitetit Drejtues të datës 28.2.2019, në të cilin është dakortësuar caktimi i personave të kontaktit të dedikuar për aktivitetet e projektit. Nga auditimi rezultoi se pikat e kontaktit kanë funksionuar për komponentët e rezultateve të pritshme (e konfirmuar dhe në Raportin Vjetor të Progresit të vitit 2019) dhe që i përgjigjet ushtrimit të detyrave funksionale në strukturat respektive në AMBU. Përgjatë periudhës objekt auditimi për shkak të ndryshimeve të stafit kanë rezultuar dy ndryshime të personave të cilat kanë luajtur rolin e pikave të kontaktit.

Nga auditimi rezultoi se caktimi i personave të kontaktit *nuk është kryer me shkresë zyrtare por në mënyrë verbale*. Po kështu dorëzimi i dokumentacionit/apo materialeve (elektronik apo në letër) midis personave të kontaktit që janë larguar dhe atyre që merrnin detyrën, nuk është bërë me procesverbal dorëzimi.

Rekomandim:

Meqenëse institucioni i AMBU-t, do të vijojë me projektin EUSIWM 2, nëpërmjet mbështetjes së sektorit të ujit, me instrumentin IPA III, të merren masa që:

a) Caktimi i personit zyrtar kryesor negocues për aktivitetin në emër të agjencisë dhe i punonjësve që do të luajnë rolin e pikave të kontaktit për çdo komponent të projektit të kryhet me shkresë zyrtare të miratuar nga Titullari.

b) Në rast largimi nga detyra të personave të pikave të kontaktit, për çdo rast dorëzimi i detyrës, të kryhet me procesverbal të konfirmuar nga të dy palët.

-Mbi miratimin e progres raporteve vjetore të zbatimit të projektit.

Konstatohet se nga AMBU, janë shqyrtuar dhe miratuar progres raportet vjetore të zbatimit të projektit, të cilat më pas janë miratuar dhe nga Komiteti Drejtues, respektivisht në takimin e 5 dhe takimin e 7, duke zbatuar e përmbushur detyrimin e përcaktuar në nenin 4, pika 2. a. të marrëveshjes, në të cilin përcaktohet detyrimi i përfituesit, për verifikim dhe miratimin e raporteve të paraqitura nga AAZH-ja.

-Mbi përmbushjen e detyrimeve specifike për Rezultatit e Pritshëm 1 (RP1).

Në funksion të auditimit të përmbushjes së detyrimeve specifike nga AMBU, në zbatim të Marrëveshjes grupi i auditimit *shqyrtoi me zgjedhje*, praktikat e ndjekura për komponentin e rezultateve të pritshme RP1, i cili rezultoi:

Rezultati e pritshëm 1 (RP1) sipas përcaktimit në Marrëveshjen e projektit është: Kuadri ligjor në fushën e menaxhimit të ujit të përmirësohet në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe bazuar në prova të zbatohet dhe të realizohet në pajtim me kërkesat e BE-së.

Në përmbushje të detyrimeve specifike të përcaktuara në nenin 4, të marrëveshjes për RP1, u shqyrtuan komunikimet e vendosura në dispozicion të grupit të auditimit si dhe përmbushja e detyrimeve nga stafi respektiv i AMBU-t i aktiviteteve të parashikuara në Planet vjetore të punës për vitin 2021 dhe 2022, në të cilin janë përcaktuar dhe personat përgjegjës për ndjekjen e aktiviteteve.

-Për ndjekjen e procedurave dhe kryerjen e aktiviteteve të parashikuara në planet vjetore për *Rezultatet e pritshme 1 (RP1)* përgjatë periudhës së auditimit kanë kryer funksionet e pikës fokale për këtë komponent, Përgjegjësit e Sektorit Rregullator Ligjor, Marrëveshjeve dhe Bashkëpunimit Ndërkufitar.

Nga auditimi u konstatua se:

-Sistemi i ndërveprimit me ekipin e projektit rezultoi funksional dhe i përshtatshëm. U konstatua një komunikim dhe kooperim i vazhdueshëm me Njësinë e projektit, referuar çështjeve operacionale me personin e kontaktit, për ER1 në përmbushje të detyrimeve specifike nga AMBU në cilësinë e institucionit përfitues.

-Janë diskutuar dhe dakortësuar me ekipin e projektit, planet vjetore të punës në të cilin janë vendosur aktivitetet, afatet, strukturat përgjegjëse. Planet e punës kanë shërbyer si instrumente efektive kontrolli, për të përmbushur objektivat/aktivitetet e komponentit RP1.

-Për aktivitetin “Vendosja e Grupit Ndërinstitucional nga AMBU” përgjegjës është caktuar stafi i AMBU, dhe është vendosur afati i realizimit, muaji shkurt 2021. Ky aktivitet është përmbushur.

-Janë ndjekur praktikat dhe është nxjerrë Urdhri nr. 24, datë 9.2.2021 i Kryeministrit “Mbi vendosjen e grupit ndërinstitucional të punës për draftimin e paketës ligjore në sektorin e menaxhimit burimeve ujore”.

Po kështu referuar planit të aktiviteteve rezulton se janë parashikuar 9 takime, ku strukturat përgjegjëse për këto aktivitete janë caktuar AMBU dhe Grupi Ndërinstitucional (LWG) përgjatë vitit 2021.

Në përmbushje të detyrimeve janë organizuar 10 takime të Grupit Ndërinstitucional dhe grupi i auditimit administroi komunikimet midis pikës së kontaktit të RP1 dhe koordinatores së projektit për realizimin e takimeve (Akhenda, konfirmime të takimeve, minuta takimi etj).

-Në planin e aktiviteteve për vitin 2022, ishte parashikuar aktiviteti për bashkëpunimin e AMBU-t me ekspertët e projektit, për hartimin e Raporteve të Vlerësimit të Ndikimit (RIA) për dy projektligjet. Referuar informacionit të marrë për këtë qëllim, rezulton se nga AMBU është bërë kontrolli i draftit të Raporteve si dhe përshtatja me formatin e përcaktuar për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit (RIA), sipas Rregullores së funksionimit të Këshillit të Ministrave, miratuar me Vendimin nr. 584, datë 28.8.2003, të ndryshuar duke përmbushur detyrimin e përcaktuar në nenin. 4, pika 2.a. të marrëveshjes, në të cilin përcaktohet detyrimi i përfituesit për verifikim dhe miratimin e raporteve të paraqitura nga AAZH-ja.

Në planin e aktiviteteve për vitin 2022 për RP1, rezultojnë të parashikuara katër nënaktivitete/hapa për zhvillimin e takimeve nr. 11-14 të Grupit Ndërinstitucional të punës me objekt rishikimi i draft 12 VKM-ve. (Në kuadër të këtij RP 1, nga projekti në bashkëpunim me përfaqësuesit e AMBU-së, gjatë vitit 2020 është hartuar draft paketa ligjore pjesë e së cilës janë dhe 12 draft VKM në zbatim të projektligjit).

Rezultoi se këto takime nuk janë zhvilluar përgjatë vitit 2022 dhe nga Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik, grupit të auditimit iu paraqit informacioni si më poshtë vijon: Në lidhje me këtë aktivitet, në kushtet kur draftet e projektligjeve pësuan disa ndryshime gjatë konsultimit të tyre si pjesë e këtij grupi pune, si dhe në rrethanat kur këto drafte bazohen në akte ligjore të pamiratuara sikurse draft ligji “Për Burimet Ujore” dhe draft ligji “Për Strategjinë detare të Republikës së Shqipërisë”, nga strukturat menaxheriale të AMBU-së në dakortësi verbale me përfaqësuesit e projektit EUSIWM, është vendosur që këto konsultime, të bëhen në fazat kur projektligjet të jenë miratuar të paktën nga Këshilli i Ministrave dhe gjatë procesit të miratimit në Parlament të bëhet paralelisht konsultimi i legjislacionit plotësues. Kjo duke pasur sigurinë që mbështetja IPA III është miratuar tashmë dhe projekti EUSIWM 2 do të nisë brenda vitit 2023, i cili do të mundësojë dhe finalizimin e këtij procesi nga ana logjistike”.

Po kështu në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në planin e punës, janë realizuar edhe takime konsultuese në nivel ekspertësh në çdo Këshill Baseni Lumor.

-Përsa i përket përmbushjes së nënaktivitetit /hapit nr. 11 të planit të punës për vitin 2022 “Për publikimin e dy projektligjeve nëpërmjet metodës së e-konsultimit në regjistrin elektronik për RP1 rezulton se ky aktivitet është përmbushur. Referuar informacionit të paraqitur për këtë qëllim, rezulton se të dy projektligjet janë konsultuar/publikuar në faqen zyrtare të konsultimit publik. Krahas sa më sipër të dy projektligjet janë publikuar përmes publikimit në faqen zyrtare të AMBU-së.

-Nga AMBU është proceduar me përcjelljen e paketave të projektligjeve në KM, respektivisht me shkresat si më poshtë vijon:

a) Paketa e Projektligjit “Për Burimet Ujore”, me shkresën nr. 1896, datë 17.11.2022, me lëndë “Dërgohet një projektvendim i KM për ndjekjen e procedurave për miratim”.

b) Paketa e Projektligjit “Për Strategjinë detare të Republikës së Shqipërisë”, me shkresën nr. 101, datë 17.01.2023, me lëndë “Dërgohet një projektvendim i KM për ndjekjen e procedurave për miratim”.

Aktualisht nga AMBU, është vijuar për shqyrtimin e komenteve të ardhura nga ministritë e linjës për të dy projektligjet, si dhe marrjen e masave për kryerjen e reflektimeve të nevojshme sipas rastit në tekstin e projektligjeve apo në relacionet përkatëse.

-Për RP1 është përmbushur detyrimi specifik i përcaktuar në pikën nr. 2, germa (b), të nenit nr.4, të Marrëveshjes “Detyrimet e Palëve” sipas të cilit “Përfituesi duhet të garantojë lidhjen e Projektit me politikat kombëtare dhe kuadrin përkatës ligjor për prioritetet e reformës së ujit, me qëllim që tu mundësohet dhe nxitet koherenca e objektivave të Projektit me kushtet e brendshme kuadër”. Produktet e dorëzuara për këtë Rezultat të Pritshëm, specifikisht projektligji “Për Burimet Ujore”, si dhe 12 draft VKM-të në zbatim të tij, projektligji “Për Strategjinë Detare të Republikës së Shqipërisë” dhe draft VKM-së në zbatim të tij, janë në përputhje me politikat kombëtare dhe kuadrin ligjor përkatës në kuadër të reformës së ujit. Përkatësisht, bazuar në parashikimet e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027, miratuar me VKM-në nr. 73, datë 7.02.2018, e cila përcakton si një nga objektivat e saj sa më poshtë:

“Cilësia e ujit: Sigurimi i cilësisë së ujërave të të gjitha burimeve ujore duke arritur statusin “cilësi e mirë” deri në vitin 2027, duke aplikuar aktet edhe nën-aktet ligjore kombëtare të cilat traspozojnë direktivat e BE-së.”

-Mbi aktivitetet e kontrollit dhe funksionimin e sistemit të komunikimit midis Sektorit të Projekteve në AMBU dhe Njësinë e Zbatimit të Projektit për krijimin e arkivit elektronik të trajnimeve të zhvilluara nga projekti.

Në raportin e implementimit të projektit për vitin 2022 (AIR) *citohet që: “EUSIWM ka investuar në vendosjen e një arkivi fizik dhe elektronik të trajnimeve. Pas çdo workshopi dhe trajnimit të kryer i gjithë dokumentacioni i realizuar sipas strukturës/formatit të EUSIWM, është shpërndarë midis pjesëmarrësve dhe depozituar në arkivin e AMBU”.*

Nga auditimi i sistemit të komunikimit midis Sektorit të Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët dhe Njësisë së Zbatimit të Projektit për krijimin e arkivit fizik dhe elektronik të trajnimeve të zhvilluara nga projekti, rezultoi se dokumentacioni i trajnimeve të zhvilluara, është dërguar elektronikisht nga projekti me e-mail tek specialistja e Sektorit e më pas ky dokumentacion ka ardhur në institucion fizikisht (me zarf), pa shkresë përcjellëse, dhe është depozituar, në dosjen përkatëse të çdo moduli.

Dokumentacioni fizik i sjellë, nuk është protokolluar në zyrën e arkiv protokollit të institucionit por është marrë dorazi nga specialistja e sektorit. Dosjet rezultuan të pa inventarizuara.

Nga grupi i auditimit, u krye verifikimi fizik i materialeve të trajnimit pasi u morr paraprakisht lista e trajnimeve të kryera nga Sektori i Burimeve Njerëzore Shërbimeve Mbështetëse (në mungesë të regjistrimit të shkresave në protokoll pra nuk ka gjurmë auditimi).

Nga verifikimi i listës së trajnimeve/workshopeve të zhvilluara përgjatë vitit 2020, 2021, 2022 dhe 2023, dhënë grupit të auditimit nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, njëkohësisht dhe pikë kontakti për RP3, rezultoi se të gjitha trajnimet/workshojet në listë ishin në dosjet fizike të trajnimeve të zhvilluara, që gjenden në Sektorin e Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët, përveç dy trajnimeve të zhvilluara në mars 2022, “Statusi, monitorimi dhe masat e ujërave tokësore” dhe “Takimi përmbyllës dhe vlerësimi për monitorimin e ujërave sipërfaqësore”. Pas verifikimit të dy dosjet e trajnimeve u depozituan në arkivin fizik të trajnimeve.

Rekomandim: 1. Të merren masa që në funksion të sigurimit të gjurmës së auditimit të dokumentacioneve të trajnimeve, të kryera në kuadër të zbatimit të projektit dhe të dërguara në institucionin e AMBU-t, të ndërpritet praktika e marrjes dorazi të dokumentacionit dhe të procedohet me bërjen hyrje në institucion nëpërmjet zyrës/punonjësit të arkiv protokollit dhe bazuar në kartelën shoqëruese të administrohet, nga Sektori i Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët.

2. Të kryhet inventarizimi i dosjeve të trajnimeve dhe të depozitohen në arkivin e institucionit.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi.

Konkluzion: Funksionimi i komponentit të aktiviteteve të kontrollit, përgjithësisht rezulton i përshtatshëm por në disa aspekte evidentohen mangësi, për të cilat nevojitet ndërmarrja e masave dhe kontrolleve shtesë për përmirësimin e sistemit.

1.4 Mbi vlerësimin e komponentit të informim (raportim) komunikimit.

Janë përcaktuar rregulla për komunikimin shkresor dhe elektronik të jashtëm dhe të brendshëm në Rregulloren e Brendshme të institucionit.

Institucioni ka krijuar informacion të përshtatshëm, të identifikuar dhe raportuar në kohë, të përfutur nga burime të jashtme, si dhe informacion të gjeneruar nga brenda, duke ndihmuar procesin e vendimmarrjes.

Informacioni i është komunikuar menaxhimit dhe punonjësve të tjerë dhe ka ndihmuar në kryerjen e përgjegjësive dhe detyrave të ngarkuara.

Komunikimi i brendshëm ndërmjet Titullarit dhe punonjësve të tij (komunikimi vertikal) ka funksionuar në mënyrë efektive dhe ka ndikuar në nivelin e ndërgjegjësimit të punonjësve për rolin dhe përgjegjësitë që kanë në lidhje me arritjen e qëllimeve dhe objektivave.

Rezulton një komunikim horizontal efektiv, me një ndërveprim të mirë dhe shkëmbimin në kohë të informacionit në të gjitha nivelet.

Ky komunikim ka ndikuar pozitivisht në arritjen e objektivave duke minimizuar risqet që ndikojnë Me urdhrin e Titullarit nr.51 datë 7.4.2021 është përcaktuar personi përgjegjës i ngarkuar me detyrën e Koordinatorit për të drejtën e informimit dhe për publikimin në website-in zyrtar të institucionit në aktivitetin e institucionit dhe është synuar një komunikim i hapur dhe interaktiv.

AMBU përdor komunikimin e jashtëm duke siguruar qasjen publike nëpërmjet publikimit në faqen e internetit zyrtar institucional.

Nga auditimi rezultoi se në faqen zyrtare të AMBU, në rubrikën “Projekte”, AMBU publikon të dhëna të projekteve, të cilët janë aktualisht në zbatim dhe projekteve të cilët kanë përfunduar. Në këtë faqe është publikuar informacion, mbi projektet me financim të huaj, të ndarë sipas donatorëve të projekteve dhe konkretisht për projektin “Mbështetja e BE-së për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri-EUSIWM” janë publikuar të dhëna mbi shtrirjen e projektit, financimin, donatorët, përfituesi, kohëzgjatja e projektit, realizimi i projektit deri në gusht 2022, përshkrimi i projektit, rezultatet e projektit etj.

Në këtë faqe gjenden dhe publikime të: 1. Projektligjit “Për burimet ujore”. 2. Publikimi i Projektligjit “Për strategjinë detare. 3. I drafteve finale të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor për Lumin Ishëm dhe Erzen.

Krahas sa më sipër rezulton një rubrikë “postimet e fundit” konsideruar si instrument për të siguruar qasjen publike, për eventet më të përditësuara të institucionit, përmendim: Konferencën e ujit në New York, mars 2023.

Në faqen zyrtare janë publikuar dhe dokumente që kanë të bëjnë me kuadrin strategjik dhe rregullator ligjor nën ligjor etj.

Bazuar në materialin vënë në dispozicion grupit të auditimit, u konstatua se AMBU ka informuar periodikisht institucionin epror (Kryeministrinë) mbi aktivitetin institucional përfshi dhe ecurinë e Projektit “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri”.

-Në kuadrin e zbatimit të projektit, nga auditimi rezultoi një komunikim efektiv midis njësisë së Zbatimit të projektit dhe stafit të AMBU-t.

-Përgjatë zbatimit të projektit janë kryer një sërë aktivitetesh që kanë të bëjnë me rritjen e ndërgjegjësimit të audiencës përkatëse dhe palëve të interesit mbi domosdoshmërinë e menaxhimit të integruar të ujërave në Shqipëri. Në këtë kuadër janë organizuar një sërë takimesh/mbledhje/tryeza të rrumbullakëta AMBU dhe Këshillit të Baseneve ujore, Festimi i Javëve të BE në Shqipëri, fushata të monitorimit të ujit në bashkëpunimin me stafin e AMBU, ZABU, ekspertë të projektit dhe përfaqësues të trupave akademike, fushata sensibilizuese, vizita në terren me fokus monitorimin e cilësisë së ujit, seanca trajnimit në terren dhe takimet konsultuese për paketën ligjore, etj.

Krahas sa më sipër, janë organizuar dhe Konferenca Kombëtare të Ujit më 24 nëntor 2020, 15 dhjetor 2021, 1 qershor 2023, dhe në datë 28 nëntor në Vjenë, është organizuar simpoziumi i lumenjve i cili u mundësua nga projekti dhe në të cilin morën pjesë përfaqësues nga AMBU dhe institucione të tjera.

-Nga auditimi i sistemit të koordinimit dhe përgatitjes së raportit vjetor të implementimit (IPA/AIR) nga Drejtoria e Menaxhimit Strategjik/Spektori i Projekteve rezultoi se është përmbushur detyrimi për përgatitjen e Raportit vjetor të implementimit të projektit për vitin 2021 dhe 2022, dhe për adresimin brenda afatit të përcaktuar në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC).

Po kështu rezulton se nga Spektori i Projekteve, janë kryer raportimet e financimit të huaj në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë bazuar në raportimet e Njësisë së Zbatimit të Projektit konform përcaktimeve të Udhëzimit nr. 35 datë 21.9.2020 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë

“Për kontrollin regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare.

Konkluzion: Funksionimi i komponentit të informim komunikimit rezultoi i përshtatshëm dhe efektiv.

1.5 Mbi vlerësimin e komponentit të monitorimit.

- Përsa i përket vlerësimit dhe monitorimit të sistemeve të MFK-së, konstatohet se:

Konform përcaktimit të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit u konstatua se me shkresën nr.467 prot., datë 4.2.2022 dhe me nr.297 prot., datë 23.2.2023 është dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, paketa dokumentare për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin për vitin 2021 dhe 2022, duke respektuar afatet e përcaktuara në kuadrin rregullator.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se janë hartuar dokumentet e Planit të masave për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Nga auditimi i saktësisë së përpilimit të këtyre dokumenteve rezultoi se: Të dy dokumentet si për vitin 2021 dhe 2022 në rubrikën aktivitete të planifikuara janë të njëjta, të pa përditësuara. Në këtë rubrikë duhet të përfshihen aktivitetet e planifikuara për tu ndërmarrë, me qëllim zgjidhjen e mangësive të zbuluara gjatë përgatitjes së raporteve vjetore mbi funksionimin e sistemit të MFK-së. Në këtë aspekt për të dy vitet, në rubrikën datat e pritshme të realizimit të aktiviteteve janë vendosur afatet e viteve korente 2021 dhe 2022, në vend të vendosjes së vitit pasardhës 2022 dhe 2023. Të dy dokumentet përmbajnë ndër të tjera aktivitete, të cilat nuk janë realizuar.

Konkluzion : Komponenti i funksionimit të monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në disa aspekte paraqet mangësi dhe nevojiten kontrole shtesë.

Rekomandim: Nga Titullari i institucionit dhe Drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të merren masa për:

- a) Hartimin e dokumentit të Planit të masave për menaxhimin financiar dhe kontrollin, bazuar në identifikimin e aktiviteteve që synojnë korrigjimin e dobësive dhe mangësive të rezultuar nga procesi i vlerësimit të sistemit dhe që do të kryhen përgjatë vitit të ardhshëm fiskal.
- b) Monitorimin e zbatimit të aktiviteteve të planifikuara në vijimësi për gjatë vitit.
- c) Paketa e dokumenteve të MFK-së, të diskutohet nga Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe më pas të procedohet me dërgimin në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë.

Përsa i përket monitorimit të projektit rezultoi:

-Në funksion të monitorimit dhe vlerësimit të progresit të arritjes së objektivave janë kryer raportet mbi analizën e performancës institucionale përfshi analizën e ecurisë /progresit zbatimit të projektit.
-Janë kryer raportet e monitorimit të performancës buxhetore të cilat janë dërguar në Ministrinë e Financave me nr.109 prot., datë 17.1.2022 dhe nr.136/1 prot., datë 20.1.2023. Këto raporte përmbajnë analiza të dedikuara për realizimin e fondeve me financim të huaj dhe të brendshëm

referuar projektit “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri”.

-Nga Sektori i Projekteve me Financim të Brendshëm dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj, rezultojnë një sërë komunikimesh me pikat e kontaktit për të ndjekur monitoruar ecurinë e zbatimit të projektit dhe përmbushjen e detyrimeve për zbatimin e aktivitetëve. Janë marrë informacionet dhe hartuar Raportet vjetore të implementimit të Projektit AIR për vitin 2021 dhe 2022.

Konkluzion: Sistemi i monitorimit të projektit nga institucioni i AMBU-t, rezulton i përshtatshëm.

2. Mbi përmbushjen e detyrimeve për alokimin e fondeve të buxhetit për të rimbursuar TVSH-në në lidhje me koston lokale në zbatim të marrëveshjes.

2.1 Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të fondeve me financim të huaj dhe të brendshëm për Projektin "Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri”.

Nga auditimi i zbatimit të procedurave për planifikimin e fondeve të projektit, në dokumentet e PBA-së rezultoi:

1 Janë zbatuar afatet kohore të dërgimit të PBA-së sipas fazave.

2.Në Dokumentet e PBA-ve respektive, janë përfshirë dhe fondet e planifikuara për Projektin “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri” si për shpenzimet e investimeve financim i huaj (kapitull 02) dhe financim i brendshëm fondet e TVSH (kapitull 04).

Nga auditimi i saktësisë së planifikimit të fondeve për dy kategoritë e financimit të huaj apo të brendshëm, rezultuan mangësi pasi:

-Në dokumentet e PBA-së dërguar përgjatë vitit 2021, rezultoi se për dy fazat e para janë adresuar kërkesa buxhetore edhe për vitet 2022, 2023 dhe 2024 ndërkohë që referuar marrëveshjes së projektit nuk parashikohej implementimi i projektit edhe përgjatë vitit 2024 apo 2025.

-Me dokumentet e PBA-së për vitin 2022 përgjatë tre fazave janë kërkuar fonde për tre vitet 2023, 2024 dhe 2025 ndërkohë që referuar marrëveshjes cikli i zbatimit të projektit nuk parashikon zbatimin përgjatë vitit 2024-2025.

-Për planifikimin e kërkesave buxhetore, nuk rezulton komunikim, me Njësinë e Zbatimit të Projektit, për të marrë të dhëna për projeksionet buxhetore, duke konsideruar dhe realizimet shpenzimet e financimit të huaj deri në vitin korrent, pasi struktura e financës, disponon raportet/situacionet e shpenzimeve në nivel mujor të financimit të huaj të cilat i raportohen AMBU-t nga Njësia e Zbatimit të Projektit edhe elektronikisht dhe fizikisht.

Konkluzion: Sistemi i planifikimit të fondeve të investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm për projektin " Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri” në disa aspekte paraqet mangësi me efekt angazhim jo të saktë të fondeve në dokumentet e planit të buxhetit dhe për të cilat nevojitet ndërmarrja a masave korrigjuese (kontrolle shtesë).

Sa më sipër rekomandojmë: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, përpara hartimit të dokumentit të PBA-së, të marrë masa që:

1-Të adresojë kërkesën për informacion Njesisë së Zbatimit të Projektit për vlerën e projeksioneve buxhetore.

2- Të konsiderojë realizimet faktike të financimit të huaj të projektit me qëllim planifikimin e saktë të financimit të huaj dhe të brendshëm (TVSH).

-Mbi rregullshmërinë e likuidimit të shpenzimeve për rimbursim për TVSH.

Nga auditimi i zbatimit të rregullshmërisë së likuidimit të fondeve për TVSH-në rezultoi se:

1. Likuidimi i shpenzimeve ishte kryer bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga projekti (Mbështetje e Bashkimit Europian për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri”).

2. Nga auditimi i Urdhër Shpenzimeve të rimbursimit të TVSH-së si dhe dokumentacionit bashkëlidhur, për periudhën objekt auditimi, rezultoi se:

i)Kërkesat e ardhura nga projekti për rimbursimin e TVSH-së janë protokolluar dhe më pas është kryer rimbursimi i TVSH-së, i cili vetëm në një rast (nga 10 raste gjithsej) rezulton të jetë kryer likuidimi një muaj, pasi është bërë kërkesa nga projekti (USHP nr.103, datë 11.4.2021, kërkesa e ardhur me nr. 374, prot. AMBU, datë 11.3.2021, likuidimi është kryer me vonesë për shkak të çeljes së investimeve për vitin 2021, në muajin prill 2021, e vërtetuar nëpërmjet evidencave mujore me degën e thesarit (janar, shkurt, mars, prill).

ii)U auditua rregullshmëria e faturave të likuiduara dhe rezultoi se në dy raste, faturat e paraqitura nuk ishin të konfirmuara nga blerësi (projekti) dhe në një rast me të drejtë ishte prapësuar (nuk ishte likuiduar fatura).

iii)U konstatuan likuidime të faturave (të sjella nga Njësia e Zbatimit të Projektit) bashkëlidhur Urdhër Shpenzimeve të cilat përkasin periudhave të mëparshme 2-4 muaj, çka përbën risk të shtuar, në evidentimin real të shpenzimeve të kryera për TVSH-në në situacionet e shpenzimeve, apo në raportet e monitorimit të cilat i dërgohen Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

iii) U konstatua se të gjitha formatet e raportimit mujor të Njesisë së Zbatimit të Projektit të cilat paraqiten në AMBU nuk rezultuan të konfirmuara sikurse përcakton Udhëzimi nr. 35 datë 21.9.2020 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për kontrollin regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare”.

Sa më sipër rekomandojmë që:

1-Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa që të bashkëpunojë me Njësinë e Zbatimit të Projektit për: i) sigurimin në kohë të faturave për rimbursimin e TVSH-së në funksion të likuidimit të tyre ii)për dërgimin e formateve të raportimit mujor të konfirmuara.

2-Të merren masa që përpara likuidimit të ushtrohen kontrole të zbatimit të rregullshmërisë të faturave konform kuadrit rregullator.

3-Mbi zbatimin e procedurave të raportimit të buxhetit faktik dhe monitorimit të fondeve të projektit.

Nga auditimi rezultoi se janë zbatuar procedurat konform kuadrit rregullator. (situacionet e shpenzimeve për TVSH, janë rakorduar me thesarin në nivel mujor dhe vjetor). Po kështu janë hartuar dhe dërguar në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, raportet peridodike (katërmujore) dhe vjetore të monitorimit të buxhetit ku në një seksion të veçantë, në kapitullin II, “Investimet”

janë trajtuar dhe paraqitur analiza për projektin “Mbështetje e Bashkimit European për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri”.

-Mbi hartimin e dokumenteve të gjurmëve të auditimit.

Nga auditimi u konstatua se nuk janë hartuar, gjurmët e auditimit për veprimtari që kanë të bëjnë me: i) Procedurat për përgatitjen e dokumentit të Projekt Buxhetit Afatmesëm, ii) Procedurat për monitorimin e performancës buxhetore e të objektivave, sikurse përcakton pika nr. 48/e Udhëzimit nr. 9, datë 20.7.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Rekomandim: Nëpunësi zbatues, t’i propozojë Titullarit për miratim pasi të jenë shqyrtuar dhe miratuar më parë nga GMS:

a) Gjurmët e auditimit për përgatitjen e dokumentit të Projekt Buxhetit Afatmesëm në të cilin të përfshihet dhe procedura e komunikimit me Njësinë e zbatimit të projektit për projeksionet buxhetore.

b) Gjurmët e Auditimit për monitorimin e performancës buxhetore.

2.2 Mbi sistemin e evidentimit në kontabilitet dhe raportimit financiar të shpenzimeve të fondeve me financim të huaj dhe të brendshëm (TVSH) të projektit “Mbështetje e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri”.

1. Janë respektuar afatet e paraqitjes së pasqyrave financiare, në Degën e Thesarit konform, përcaktimeve të kuadrit rregullator.

2. Janë kryer rakordimet periodike dhe vjetore, për situacionet e shpenzimeve me Degën e Thesarit, përgjatë periudhës objekt auditimit (janar 2021-mars 2023) konform, përcaktimeve të kuadrit rregullator.

3. Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021 dhe 2022, rezultuan disa mangësi në plotësimin e tyre.

Konkluzion: Nga auditimi rezultuan mangësi në kontabilizim dhe evidentim në pasqyrat financiare të vitit 2021 dhe 2022 të fondeve të investimeve të projektit, të cilat më hollësisht, janë trajtuar në raport.

Në funksion të marrjes së masave për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë:

Nëpunësi Zbatues për fondet e investimeve të projektit, të kryejë veprimet korrigjuese dhe të hartojë pasqyrën financiare të vitit 2023, konform përcaktimeve të Udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

Opinion përgjithshëm:

Referuar auditimit të kryer sipas procedurave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, si dhe konstatimeve të evidentuara në raportin përfundimtar të auditimit, vlerësohet se sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm, përgjithësisht rezultojnë të përshtatshme por në disa aspekte paraqiten dobësi, për të cilat nevojitet ndërmarrja e masave organizative për përmirësimin e tyre në funksion të përmbushjes së objektivave.

Gjetjet e trajtuara në raport, janë sipas sistemeve/fushave të audituara konform programit/drejtimeve të auditimit, të vlerësuar me impaktin/ndikimin dhe rëndësinë e çdo gjetje si dhe rekomandimin përkatës për përmirësim.

Rekomandimet jepen në Aneksin nr.1 të këtij raporti në përgjigje të gjetjeve të konstatuara.

I. HYRJE

Auditimi u krye në përputhje me programin e miratuar me nr. 2685/1 prot., datë 27.6.2023, për periudhën objekt auditimi 1.1.2021-31.3.2023.

Takimi fillestar, u zhvillua në datë 29.6.2023, me grupin e auditimit të përbërë nga znj. Luljeta Nano dhe znj. Engjellushe Ibraliu me Drejtorin e Përgjithshëm të AMBU, znj. Gerta Lubonja dhe z. Arduen Karagozi, Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik.

Në takim u prezantua qëllimi, programi i punës, tematika dhe objektivat e auditimit. Palët ranë dakort për fillimin e auditimit dhe kushtet e punës.

Qëllimi i auditimit është që të ndihmojë Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), në realizimin e objektivave të veprimtarisë institucionale, duke përmirësuar sistemet e kontrollit si dhe të vlerësojë e japë siguri se sistemet e menaxhimit dhe të kontrollit, të ngritura për përmbushjen e detyrimeve specifike, në cilësinë e përfituesit për projektin “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri” funksionojnë në mënyrë efikase, të përshtatshme dhe janë në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullativ.

Në përfundim të auditimit dhe në përmbushje të objektivave audituese, u vijua me adresimin e rekomandimeve për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit dhe të kontrollit objekt auditimi.

Përpara hartimit të projektraportit mbështetur në konkluzionet e nxjerra nga vlerësimi i të gjithë dokumentacionit të veprimtarisë audituese, u krye takimi ballafaques me Drejtorin e Përgjithshëm (Titullar i institucionit) dhe me Drejtorin e Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik, njëherazi titullar i strukturës përgjegjëse për ndjekjen dhe koordinimin e zbatimit të projektit.

Gjatë këtij takimi nga grupi i auditimit u bënë prezent dhe u dakortësuan, gjetjet e rekomandimet si dhe afatet e zbatimit të rekomandimeve për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit dhe të kontrollit, objekt auditimi.

Me shkresën nr. 2685/2 Prot. Kryeministri datë 1.9.2023, projektraporti i auditimit u adresua në institucionin e AMBU, për tu njohur me gjetjet dhe rekomandimet për marrjen e masave për përmirësimin e funksionimit të sistemeve. Me shkresën nr. 2685/3 Prot. Kryeministri, datë 14.9.2023, nga AMBU është përcjellë projektraporti i auditimit (një kopje) i konfirmuar nga Titullari si dhe është shprehur dakortësia me gjetjet dhe rekomandimet e adresuara në këtë projekt raport.

Raporti përfundimtar i auditimit i vihet në dispozicion institucionit, për tu njohur me gjetjet dhe rekomandimet për marrjen e masave për përmirësimin e funksionimit të sistemeve.

Baza ligjore:

- Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar.
- Ligji nr. 10296, datë 08. 07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- Ligji nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të ujrave” i ndryshuar.
- VKM nr. 221, datë 26.4.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore” i ndryshuar.
- Urdhri nr.152, datë 1.10.2018 i Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore” i ndryshuar me Urdhrin nr. 17, datë 30.1.2020 të Kryeministrit.
- Ligji nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr. 37/2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)”.
- VKM nr. 587, datë 4.9.2019 “Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Austriake të Zhvillimit, për projektin “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri”.
- VKM nr.764 datë 12.12.2022 “Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr.1 të Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Austriake të Zhvillimit, për projektin “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri”.
- Marrëveshja midis Qeverisë Shqiptare dhe Bashkimit Evropian për IPA 2016, miratuar me VKM nr. 740, datë 13.12.2017.
- Urdhri nr. 120, datë 1.8.2022, i Kryeministrit “Për përcaktimin e procedurës së koordinimit të Agjencisë të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) me disa struktura dhe institucione të administratës shtetërore”.
- Ligjet vjetore të zbatimit të buxhetit 2021, 2022, 2023.
- Si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore dhe nën ligjore që lidhet me veprimtarinë e subjektit dhe misionin e auditimit.

II. METODA E AUDITIMIT

Metoda e auditimit, është me bazë në sistem. U përzgjedhën:

- Metoda e intervistimit, në njohjen e proceseve dhe funksionimin e institucionit.
- Përcaktimi/regjistrimi i sistemeve/ proceseve nëpërmjet kërkimit paraprak.
- Metoda e rindërtimit të ngjarjeve, mbështetur në radhën kronologjike dokumentacion - veprime.
- Metoda e ndjekjes së dokumentacionit, gjurmim dokumentacioni sipas rrjedhës/modelit standart.

-Metoda e rishikimit analitik, rishikimi i dokumentacionit deri tek dokumentacioni fillestar etj.

III. TEKNIKAT E AUDITIMIT.

Për të arritur në konkluzione profesionale, janë kombinuar teknikat:

-Testime për ekzaminimin e periudhave të caktuara, për operacione është ndjekur gjurma e procesit.

-Testimi me zgjedhje, në pagesat e kryera për rimbursim TVSH në veprime me bankë.

-Kontrolli aritmetik për kryerjen e pagesave.

-Vlerësim i rregullshmërisë së urdhër shpenzimeve, ditarëve, dhe mbajtjes së kontabilitetit për veprimet e kryera për rimbursim TVSH.

-Informacionet e marra nga stafi i AMBU, etj.

IV. GJETJET KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR ÇDO SISTEM.

Auditimi u krye në përputhje me programin e miratuar me nr. 2685/1 prot., datë 27.6.2023 me afat auditimi nga data 29.6.2023 deri në datë 20.8.2023.

1. Vlerësimi i funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në institucionin e AMBU-t, për përmbushjen e detyrimeve specifike, në cilësinë e përfituesit në kuadër të implementimit të projektit “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e integruar të Ujit në Shqipëri” sikurse përcaktuar në VKM nr. 587, datë 4.9.2019 “Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Austriake të Zhvillimit për projektin “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri”.

1.1 Vlerësimi i komponentit të mjedisit të kontrollit.

-Mbi kuadrin rregullator institucional dhe termat e kushtet e projektit “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri”.

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), është person juridik publik, në varësi të Kryeministrit, që financohet nga buxheti i shtetit dhe nga çdo burim tjetër i ligjshëm.

Agjencia është e organizuar dhe funksionon, bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar dhe të VKM nr. 221, datë 26.4.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, i ndryshuar.

Kompetencat e Agjencisë, janë përcaktuar në nenin 11, të Ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar si dhe përgjegjësitë dhe detyrat janë përcaktuar në VKM

nr. 221, datë 26.4.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”.

Misioni i Agjencisë, është përcaktuar në pikën 2, të Kreut I, të VKM nr. 221, datë 26.4.2018 dhe konkretisht: Misioni i Agjencisë është mirëqeverisja e burimeve ujore me qëllim përmbushjen e të gjitha nevojave jetësore, duke mbajtur në vëmendje qëndrueshmërinë e ekosistemeve, duke nxitur konkurrueshmërinë e përdorimeve dhe priorizimin drejt përfitueshmërisë ekonomike”.

Me VKM nr. 587, datë 4.9.2019 është miratuar, Marrëveshja e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Austriake të Zhvillimit, për projektin “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri” dhe me VKM nr.764, datë 12.12.2022 është miratuar *Marrëveshja ndryshuese nr.1* e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Austriake të Zhvillimit, për projektin “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri”.

Në Marrëveshjen e miratuar, për projektin “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri” janë përcaktuar ndër të tjera termat dhe kushtet si më poshtë:

Neni 3 “Qëllimi dhe objektivat e projektit” janë:

Objektivi i përgjithshëm: Kontribuimi për përmirësimin e zbatimit të reformës kombëtare të ujit dhe progresin e Shqipërisë drejt kërkesave të legjislacionit të BE-së për ujin.

Objektivi specifik: Fuqizimi i kapaciteteve për menaxhimin e sektorit në pajtim me politikat e BE-së dhe konsolidimi i përpjekjeve të mëparshme në këtë drejtim.

Në marrëveshje janë përcaktuar dhe *rezultatet e pritshme të projektit* që janë:

Rezultatet e pritshme 1 - RP1

Kuadri ligjor në fushën e menaxhimit të ujit të përmirësohet në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe bazuar në prova të zbatohet dhe të realizohet ë pajtim me kërkesat e BE-së.

Rezultatet e pritshme 2 - RP2

Planet e Menaxhimit të Baseneve të Lumenjve të zbatohen për basene të zgjedhur të lumenjve, dhe në pajtim me kërkesat e BE-së.

Rezultatet e pritshme 3 - RP3

Të forcohet kapaciteti institucional në nivelin e basenit të lumit për të zbatuar Menaxhimin e Integruar të Ujit.

Rezultatet e pritshme 4 – RP4

Kuadri buxhetor dhe analiza ekonomike e përfutimit dhe përdorimit të ujit në nivel baseni të përmirësohet në pajtim me parimet e direktivës kuadër për ujin, struktura tarifore të rishikohet dhe zbatohet.

Agjencia Austriake për Zhvillim (AAZ), bazuar në nenin 2 të Marrëveshjes, realizon zbatimin e kësaj marrëveshje, nëpërmjet Zyrës së saj të Bashkërendimit për Bashkëpunim Teknik të Ambasadës Austriake në Tiranë.

Përfitues i projektit “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri” referuar paragrafit nr. 2 të nenit 2 të Marrëveshjes, është Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i cili *monitoron zbatimin e kësaj marrëveshje*, nëpërmjet Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) .

Në pikën nr. 2, të nenit 4 të Marrëveshjes së projektit, janë përcaktuar detyrimet specifike të përfituesit që përfshijnë:

- 1.i) Bashkëpunimin me ekipin e Projektit mbi bazë ditore në lidhje me çështjet operacionale, duke caktuar një person kontakti; ii) Garantimi i bashkëpunimit ndërmjet grupeve kryesore të interesit; iii) Verifikimi dhe miratimi i të gjitha raporteve të paraqitura nga Agjencia Austriake për Zhvillim (AAZH); iv) Garantimi i pjesëmarrjes aktive në zbatimin e aktiviteteve; v) Sigurimi i të dhënave dhe informacionit të kërkuar dhe, sipas rastit, ofrimi i një zyre për Ekipin e Projektit; vi) Garantimi i lidhjes së Projektit me politikën kombëtare dhe kuadrin përkatës ligjor për prioritetet e reformës së ujit, me qëllim që tu mundësohet dhe nxitet koherenca e objektivave të Projektit me kushtet e brendshme kuadër;
2. Mbështetja e lehtësimit dhe shpërndarjes së përvojave dhe informacionit, bazuar në rezultatet e arritura dhe ndikimet e projektit në nivel kombëtar;
3. Mbështetja dhe lehtësimi i lidhjes dhe bashkëpunimit me ministritë dhe institucione të tjera dhe Bashkitë, Prefekturat dhe zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore që kanë rol thelbësor në zbatimin e projektit.
4. Ofrimi i alokimit të nevojshëm buxhetor për të rimbursuar TVSH-në, në lidhje me koston lokale të Agjencisë Austriake për Zhvillim, të përfaqësuar nga Zyra e Koordinimit për Bashkëpunim Teknik të Ambasadës Austriake në Tiranë.
5. Garantimi që dispozitat e përgjithshme për Doganat dhe Përrjashtimet Tatimore dhe kushtet për Institucionet e Jashtme, OJQ-të dhe shoqëritë që specifikohen në nenin 5 dhe 6 të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Austrisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin për Zhvillim, zbatohen në kontekstin e zbatimit të Projektit.

Në nenin 5 të Marrëveshjes pika 1, përcaktohet që: Projekti është një ndërrmarje e përbashkët ndërmjet përfituesit të përfaqësuar nga Agjencia për menaxhimin e Burimeve Ujore (AMBU) dhe AAZ-së e përfaqësuar nga Zyra e Koordinimit për Bashkëpunim Teknik të Ambasadës Austriake në Tiranë.

Në pikën nr.4 përcaktohet që: Përfituesi merr të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e aktiviteteve të miratuara nga Projektit, ofron akses tek informacioni përkatës duke përfshirë të dhënat statistikore që çmohen të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektivave të projektit. Kohëzgjatja e projektit referuar VKM nr.764, datë 12.12.2022 “Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr.1 të Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Austriake të Zhvillimit, për projektin “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri” 60 muaj.

Vlera totale e projektit është 3.100.000 Euro nga e cila Delegacioni i Bashkimit Evropian është financues i projektit në vlerën 1,600,000 Euro ndërsa Agjencia Austriake për Zhvillim në vlerën 1,500,000 Euro.

Auditimi u fokusua në vlerësimin e përshtatshmërisë, së funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në institucionin e AMBU-së me synim përmbushjen e detyrimeve specifike të përfituesit të projektit, sikurse përcaktuar në Marrëveshje.

-Mbi planin strategjik, planet vjetore operacionale.

-Dokumenti i Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027, miratuar me VKM nr.73, datë 2.2.2018, përmban objektiva strategjike dhe aktivitetet për përmbushjen e objektivave strategjike, ku institucioni i AMBU-së, është një ndër institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre.

Kjo Strategji është monitoruar dhe me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Ujit nr. 6, datë 31.5.2023, është miratuar “Raporti i monitorimit mbi zbatimin e planit strategjik të veprimit 2019-2022 të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027”.

AMBU në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga kapitulli 5, i Strategjisë ka kryer monitorimin e zbatimit të SKMBIU-së dhe e ka publikuar këtë raport në faqen zyrtare.

-Në nivel vjetor, janë hartuar planet vjetore të punës së institucionit ku qëllimet dhe objektivat institucionale, janë pasqyruar në dokumentet: i) Plani i Punës për Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore për vitin 2021, ii) Plani i Punës për Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore për vitin 2022 dhe iii) Plani i Punës për Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore për vitin 2023, dokumente këto, të miratuara nga Titullari respektivisht me shkresat nr. 1501 prot., datë 31.12.2020, nr. 64 prot., datë 11.01.2022 dhe nr. 2132 prot., datë 30.12.2022 duke përcaktuar aktivitetet dhe nënaktivitetet, afatet në funksion të përmbushjes së objektivave për të gjitha strukturat e institucionit (Drejtori, Sektor).

Në lidhje me zbatimin e projektit, rezultuan plane vjetore të punës të zbatimit të projektit për vitet 2021-2022 për secilin nga komponentët e projektit (RP) të dakortësuar me pikat e kontaktit (personat përgjegjës në AMBU) për implementimin e aktiviteteve për secilin nga komponentët e (RP).

Konkluzion: Institucioni ka ushtruar veprimtarinë institucionale bazuar në objektiva strategjike, plane vjetore dhe për implementimin e projektit rezultojnë plane pune vjetore të veçanta krahas planeve vjetore institucionale.

Vlerësohet pozitivisht hartimi i planveprimeve për arritjen e objektivave strategjike dhe objektivave periodike në nivel vjetor, konform përcaktimeve të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Etika dhe politikat e integritetit.

Me qëllim funksionimin efektiv të sistemit të etikës dhe integritetit, në fokus të menaxhimit institucional ka qenë hartimi dhe miratimi i tre dokumenteve, që përmbajnë rregullat për zbatimin e parimeve dhe standardeve të etikës dhe konkretisht:

- i) Rregullorja e sjelljes së nëpunësve të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, e miratuar me urdhrin e Titullarit nr. 179, datë 21.11.2019.
- ii) Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, miratuar me urdhrin e Titullarit nr.181, datë 2.12.2019.
- iii) Rregullorja e brendshme e miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 86, datë 26.7.2023 e cila në nenin 27, “Etika dhe konflikti interesit”, nenin 28, “Konfidencialiteti” dhe nenin 29, “Kodi i veshjes” trajton rregullat e etikës që duhet të zbatohen nga punonjësit.

Sa më sipër vlerësohet pozitivisht hartimi i tre dokumenteve të cilat, rregullojnë parimet dhe standardet e integritetit dhe etikës, të detyrueshme për zbatim nga punonjësit e institucionit.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të sipërcituara, rezultoi:

-Nuk janë reflektuar dhe përshtatur rregullat, sikurse përcaktuar në Kreun VII, pika 1, të VKM nr.874, datë 29.09.2021 “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike” në të cilin përcaktohet që: “Ngarkohen të gjitha institucionet e administratës publike që, brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2022, të hartojnë dhe të përshtatin rregulloret e tyre të brendshme në përputhje me këtë vendim”.

-Në Rregulloren “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore”, miratuar me urdhrin e Titullarit nr.181, datë 2.12.2019, në nenin 17 “Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve premtimeve ose trajtimeve preferenciale”, janë vendosur përcaktime, referuar VKM nr.714, datë 22.10.2014, “Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit në administratën publike” vendim ky i cili rezulton i shfuqizuar, me VKM nr. 874, datë 29.9.2021 “Për miratimin e rregullave të parimeve të etikës të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”.

Gjetja Nr.1 Reflektimi i kërkesave të kuadrit rregullator në hartimin e rregullave të etikës.	
Subjekti i audituar	AMBU
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	AMBU. Titullari, Grupi i punës i ngritur me Urdhër të Titullarit, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse e ngarkuar me detyrën e menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion.
Përmbledhja e bazës ligjore	-VKM nr. 221, datë 26.4.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, i ndyshuar. -VKM nr. 874, datë 29.09.2021 “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”.
Përshkrim i Gjetjes	Situata: - Në Rregulloren “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore”, miratuar me urdhrin e Titullarit nr.181, datë 2.12.2019, në nenin 17 “Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve premtimeve ose trajtimeve preferenciale”, janë vendosur

	<p>përcaktime, referuar VKM nr.714, datë 22.10.2014, “Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit në administratën publike” vendim ky i cili rezulton i shfuqizuar, me VKM nr. 874, datë 29.9.2021 “Për miratimin e rregullave të parimeve të etikës të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”.</p> <p>-Nuk janë reflektuar dhe përshtatur në dy rregulloret (të sjelljes së punonjësve dhe të parandalimit të konfliktit të interesave) rregullat, sikurse përcaktuar në Kreun VII, pika 1, të VKM nr.874, datë 29.09.2021, në të cilin përcaktohet që: “Ngarkohen të gjitha institucionet e administratës publike që, brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2022, të hartojnë dhe të përshtatin rregulloret e tyre të brendshme në përputhje me këtë vendim”.</p> <p>Kriteri: Ligji nr.10296, datë 8. 7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; VKM nr.874, datë 29.09.2021 “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”;</p> <p>Ndikimi/Efekti: Nuk ka efekt financiar por ndikon në ushtrimin efektiv të aktiviteteve të kontrollit kundrejt përcaktimeve në rregulloret e brendshme si dhe në funksionimin efektiv të sistemit të etikës, integritetit në institucion.</p> <p>Shkaku: Mos reflektim i kërkesave të kuadrit rregullator.</p>
Niveli i Riskut	I lartë
Konkluzion	Pavarësisht se nga institucioni, është punuar për hartimin e një kuadri rregullator të funksionimit të etikës dhe integritetit, nevojitet reflektimi e përshtatja e tyre, me rregullat sikurse përcaktuar në Vendimin nr.874, datë 29.9.2021 të Këshillit të Ministrave, me efekt vendosjen e kontrolleve shtesë, me qëllim rritjen së efektivitetit të funksionimit të sistemit të etikës dhe integritetit në institucion.
Rekomandim	<p>Të merren masat për ngritjen e një grupi pune për:</p> <p>a) Reflektimin e përshtatjen në Rregulloren për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në AMBU dhe në Rregulloren e sjelljes së punonjësve të rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike, sikurse përcaktuar në Vendimin nr.874, datë 29.9.2021 të Këshillit të Ministrave;</p> <p>b) Rregulloret e ndryshuara të shqyrtohen paraprakisht nga Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe më pas të miratohen nga Titullari i institucionit.</p>
Afati i fundit zbatimit të rekomandimit	15 dhjetor 2023
Statusi rekomandimit	Pranuar.

-Mbi zbatimin e nenit 8 "Klauzola kundër korrupsionit" të Marrëveshjes së Projektit "Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri".

Referuar informacionit të paraqitur grupit të auditimit konstatohet se në asnjë rast, nuk ka rezultuar masë disiplinore për shkelje të etikës apo praktika të kundra ligjshme në referencë të nenit 8, "Klauzola kundër korrupsionit" të Marrëveshjes së miratuar me VKM nr. 587, datë 4.9.2019 për Projektin "Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri".

-Mbi rregulloren e brendshme të institucionit.

Me Urdhrin nr. 86, datë 26.7.2023 të Kryeministrit, është miratuar rregullorja "Për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Zyrave të Administrimit të Baseneve Ujore".

Për periudhën objekt auditimi, rezulton se AMBU i ka adresuar shkresën nr.1897 prot., datë 17.11.2022, Kryeministrit "Për miratimin e rregullores "Për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të AMBU dhe ZABU-ve". Në këtë shkresë theksohet se AMBU, ka hartuar draft rregulloren e brendshme dhe ia ka adresuar Kryeministrit, për vijimin e procedurave të miratimit që në vitin 2019, konform përcaktimit të kreut II, pika VI të VKM nr. 221, datë 26.04.2022, të ndryshuar.

Rregullorja ka si qëllim administrimin e veprimtarisë dhe mirëfunksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore në nivel qendror dhe në nivel baseni ujor.

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të funksionimit, detyrave të strukturave dhe të sjelljes së personelit të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Zyrave të Administrimit të Baseneve Ujore.

Nga auditimi rezultoi se rregullorja e brendshme, përmbush kërkesat në tërësinë e komponentëve strukturorë që kanë të bëjnë me misionin institucional, drejtimin e administrimin e njërive të brendshme strukturorë, kompetencat, aktivitetet, përgjegjësitë menaxheriale dhe operacionale, etj, në funksion të sigurimit të një menaxhimi efektiv të institucionit.

Nga shqyrtimi i rregullores, rezulton se në pikën "d" të nenit 11, është përcaktuar ndër të tjera, objekti i veprimtarisë së Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik, si më poshtë vijon:

"Ndjekja apo realizimi i projekteve me financim të brendshëm dhe atyre të financuara nga donatorët dhe partnerët zhvillimorë, si dhe integrimi dhe koordinimi i tyre, duke synuar maksimizimin e përfitimeve dhe realizimin e produkteve të plota dhe funksionale, në kohë, cilësi dhe kosto, në përputhje me prioritetet e sektorit".

Në pikën nr. 4, të nenit 11, janë përcaktuar detyrat kryesore të Sektorit të Projekteve të Brendshme dhe i Koordinimit të Projekteve me Donatorët.

Rregullorja e Brendshme, është në përputhje me strukturën e miratuar me Urdhrin nr.152, datë 1.10.2018 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe organikës të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore", i ndryshuar.

Konkluzion: 1-Institucioni aktualisht funksionon bazuar në një rregullore të miratuar, konform përcaktimit të Kreut II, pika 6, e VKM nr. 221, datë 26.04.2018 dhe që ka të përcaktuara rregullat e funksionimit, detyrat e strukturave dhe të sjelljes së personelit.

2-Njësitë e brendshme strukturore përfshirë, strukturat përgjegjëse (Drejtoria dhe Sektori) për ndjekjen e projektit “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri” i kanë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme rregullat për administrimin dhe funksionimin e tyre.

Mbi zbatimin e nenit 8 “Klauzola kundër korrupsionit” të Marrëveshjes së Projektit “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri”.

Po kështu referuar informacionit të paraqitur nga Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik dhe Përgjegjësi i Sektorit të Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të projekteve me Koordinatorët në asnjë rast, nuk ka rezultuar masë disiplinore për shkelje të etikës apo praktika të kundraligjshme në referencë të nenit 8, “Klauzola kundër korrupsionit” të Marrëveshjes së miratuar me VKM nr. 587, datë 4.9.2019 për Projektin “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri”.

-Nga auditimi rezultoi se në asnjë rast nuk kanë rezultuar, thyerje të rregullave të etikës dhe të procedimit disiplinor.


-Mbi strukturën organizative dhe plotësimin e organikës.

Struktura dhe Organika e institucionit është miratuar me Urdhrin nr.152, datë 1.10.2018 i Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, i ndryshuar me Urdhrin nr. 17, datë 30.1.2020 të Kryeministrit. Konstatohet se nuk ka pasur ndryshim të strukturës dhe organikës së AMBU, përgjatë gjithë periudhës objekt auditimi.

Nga shqyrtimi i strukturës organizative rezulton se në AMBU, ka një strukturë të posaçme Sektori i Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit me Donatorët e Huaj, të ngarkuar me ndjekjen apo realizimin e projekteve me financim të brendshëm dhe të huaj si dhe koordinimin e tyre me prioritetet e sektorit. Në këtë kuadër ky sektor ndjek dhe koordinon çështjet që kanë të bëjnë me projektin “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri”.

Drejtoria e Menaxhimit Strategjik e cila ka vartësi të drejtpërdrejtë, nga Drejtori i Përgjithshëm, ka në vartësi Sektorin e Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit me Donatorët, duke siguruar në këtë mënyrë një strukturë të përshtatshme organizative, linja efektive raportimi çka mundëson kryerjen e përgjegjësive në funksion të realizimit të objektivave.

Linjat e varësisë pasqyrohen në organigramën si më poshtë:



Konkluzion: Vlerësohet pozitivisht fakti që në AMBU, është ngritur dhe funksionon një strukturë e posaçme (Sektor në vartësi të Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik) e ngarkuar me ndjekjen apo realizimin e projekteve me financim të brendshëm dhe të huaj si dhe koordinimin e tyre me prioritetet e sektorit.

Bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr.152, datë 1.10.2018 “Për miratimin e strukturës dhe organikës të Agjencisë së Menaxhimit të burimeve ujore”, i ndryshuar, numri total i punonjësve të AMBU, është përcaktuar gjithsej 83 punonjës, ndër të cilët 3 punonjës, i përkasin Sektorit të Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët (PIU) dhe që përbëhet nga 3 nëpunës gjithsej, 1 përgjegjës dhe 2 specialist.

Pozicionet	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023 (Janar -Mars)	
	Nr. punonjësve të miratuar	Nr. punonjësve faktik	Nr. punonjësve të miratuar	Nr. punonjësve faktik	Nr. punonjësve të miratuar	Nr. punonjësve faktik
Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik	1	1	1	1	1	1
Total Sektorin	3	2	3	2	3	2
Përgjegjës Sektorin	1	1	1	1	1	1
Specialist	1	1	1	1	1	1
Specialist	1	1 (janar-korrik) 0 (korrik-dhjetor)	1	0	1	0

Nga auditimi i kryer mbi plotësimin e organikës së Sektorit për periudhën objekt auditimi (1.1.2021 deri në 31.3.2023), rezultoi se nga janar 2021 deri në datën 20.07.2021, Sektori ka funksionuar i plotë. Ndërkohë prej datës 21.07.2021, e në vijim kjo strukturë ka funksionuar me dy punonjës (1 përgjegjës dhe një specialist) *pra me organikë të paplotësuar*.

Sipas informacionit të paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse (përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore) rezultoi se nuk është adresuar kërkesë pranë DAP, për shpalljen e vendit vakant të specialistit nga 21 korrik 2021 – 31.03.2023.

Në informacion theksohet se: “Pamundësia fizike për të sistemuar stafin ka bërë që të kemi një prioritizim të nevojave urgjente për staf. Ky prioritizim është bërë duke përdorur si kriter shpalljen e atyre vakancave në ato sektorë të cilët ushtrojnë funksione teknike”.

-Mbi zhvillimin profesional të punonjësve të Sektorit të Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët.

Bazuar në materialin vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezultoi se punonjësit e Sektorit të Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët, kanë ndjekur trajnime të organizuara kryesisht nga ASPA në funksion të rritjes së kompetencave profesionale në ushtrim të detyrave funksionale (trajnime të lidhura me zbatimin e projekteve).

Për periudhën 2020-2022, kanë ndjekur 8 ditë trajnime në 5 trajnime të organizuara nga ASPA si më poshtë vijon:

Bazuar në materialin vënë në dispozicion grupit të auditimit rezultoi se punonjësit e Sektorit të Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët kanë ndjekur trajnime të organizuar kryesisht nga ASPA me tema të ndryshme si:

- Menaxhimi i komunikimeve dhe riskut në zbatimin e projekteve, trajnim 1 ditor organizuar nga ASPA (16.4.2021), e cila është ndjekur nga drejtori i drejtorisë, përgjegjësi i sektorit dhe 2 specialistet.
- Konceptet kryesore të zbatimit të projektit, trajnim 1 ditor organizuar nga ASPA (23.3.2021), e cila është ndjekur nga drejtori i drejtorisë, përgjegjësi i sektorit dhe 2 specialistet.
- Hartimi i projektit, trajnim 1 ditor organizuar nga ASPA (27.1.2021), e cila është ndjekur nga drejtori i drejtorisë, përgjegjësi i sektorit dhe 2 specialistet.
- Procesi i auditimit të brendshëm të fondeve IPA, trajnim 1 ditor organizuar nga ASPA (23.3.2021), e cila është ndjekur nga drejtori i drejtorisë, përgjegjësi i sektorit dhe 2 specialistet.

Mësoni bazat e Kornizës së Menaxhimit të Projektit, trajnim 4 ditor organizuar nga ASPA (22/24/29/30.4.2020), e cila është ndjekur nga përgjegjësi i sektorit dhe 2 specialistë.

Po kështu punonjësit e sektorit kanë marrë pjesë dhe në trajnimet e zhvilluara nga projekti EUSIWM.

Gjetja Nr.2 Mbi plotësimin e organikës dhe zhvillimin profesional të punonjësve të Sektorit të Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët (PIU).	
Subjekti i audituar	AMBU
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	AMBU Drejtori i Përgjithshëm i AMBU, Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Sektori i Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët
Përmbledhja e bazës ligjore	VKM nr. 221, datë 26.4.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, i ndryshuar. Urdhri nr.152, datë 1.10.2018 i Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës të Agjencisë së Menaxhimit të burimeve ujore” i ndryshuar. Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr. 243, datë 18.03.2015, i ndryshuar “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.
Përshkrim i Gjetjes	Situata: 1- U konstatua se për pozicionin, specialist në Sektorin e Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit me Donatorët, që nga muaji korrik 2021, është krijuar vendi vakant për shkak të largimit të punonjësit nga ky sektor , dhe nuk është vijuar me adresimin e kërkesës për shpallje në DAP me qëllim zhvillimin e procedurave të rekrutimit. Kriteri: Urdhri nr.152, datë 1.10.2018 i Kryeministrit, i ndryshuar dhe VKM nr. 243, datë 18.03.2015, i ndryshuar . Impakti: Mosplotësimi i organikës ndikon negativisht në mos përmbushjen e përgjegjësiave dhe objektivave sektoriale/institucionale. Funksionimi i sektorit me një punonjës më pak (1/3 e kapacitetit e paplotësuar) sjell për pasojë mbingarkesën e punonjësve të tjerë dhe kufizime në ushtrimin efektiv të aktiviteteve të kontrollit të kësaj njësie strukturore. Shkaku. Moszbatimi i dispozitave të kuadrit rregullator për zbatimin e procedurave të plotësimit të vendeve vakante . 2- Punonjësit e Sektorit të Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët, kanë ndjekur trajnime të organizuara kryesisht nga ASPA në funksion të rritjes së kompetencave profesionale në ushtrim të detyrave funksionale (trajnime të lidhura me zbatimin e projekteve). Për periudhën 2020-2022, kanë ndjekur 8 ditë trajnime në 5 trajnime të organizuara nga ASPA. Ndikimi: Ngritja e kapaciteteve dhe rritja e profesionalizimit të punonjësve, rrit performancën e punonjësve në drejtim të ushtrimit të detyrave funksionale.
Niveli i Riskut	a) I lartë për mosplotësimin e organikës; b) i mesëm për rritjen e kapaciteteve.
Konkluzion	1-Organika e Sektorit rezultoi e paplotësuar me një vend vakant (pozicioni i specialistit) për periudhën nga 20.7.2021, si dhe nuk janë ndërmarrë procedurat të rekrutimit, sikurse përcakton kuadri rregullator.

	2-Meqenëse AMBU është në procesin e implementimit të disa projekteve me financim të huaj, ngritja dhe zhvillimi profesional, referuar eksperiencave më të mira është domosdoshmëri.
Rekomandim	a)Me qëllim funksionimin e strukturës së Sektorit të Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit me Donatorët e Huaj me kapacitet të plotë, konform organikës së miratuar, të merren masa për zbatimin e procedurave të rekrutimit në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike deri në plotësimin e vendit vakant. b)Në funksion të implementimit të politikave të zhvillimit profesional, të mbajtjes së një personeli kompetent dhe meqenëse AMBU, për periudhat në vijim është e angazhuar me implementimin e disa projekteve me financim të huaj, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse (përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore) në bashkëpunim dhe koordinim me Sektorin e Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët (PIU), të marrin masa për kryerjen e trajnimeve të stafit të Sektorit dhe sigurimin e pjesëmarrjes së tyre jo vetëm në trajnimet e organizuara nga ASPA dhe workshope të ndryshme të organizuara brenda vendit, por dhe në eventet, (workshope/konferenca/seminare) trajnime jashtë vendit për marrjen e eksperiencës nga praktikantët më të mira, duke planifikuar dhe efektin financiar.
Afati i fundit zbatimit të rekomandimit	Rekomandimi a) <i>Menjëherë dhe në vijimësi.</i> b) <i>Në vijimësi</i>
Statusi rekomandimit	Pranuar.

-Mbi ngritjen dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS).

Nga auditimi i kryer rezultoi se është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik i institucionit me: i) urdhrin e titullarit nr.7/1, datë 5.1.2021 “Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik për vitin 2021”; ii) urdhrin e titullarit nr.16, datë 12.1.2022 “Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik për vitin 2022” dhe me iii) urdhrin e titullarit nr.13, datë 25.1.2023 “Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik për vitin 2023” duke vepruar në përputhje me përcaktimet e nenit 8, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, në të cilin theksohet që: “Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore...b) ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik të njësive publike në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji. Neni 27, i ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, i ndryshuar, përcakton që: “Grupi i Menaxhimit Strategjik, përbëhet nga Titullari i njësive publike, zëvendës titullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë”. Konkluzion: Vlerësohet pozitivisht ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik, konform kërkesave të kuadrit rregullator të MFK-së.

Nga informacioni i dhënë grupit të auditimit nuk rezultojnë gjurmë të funksionimit të ushtrimit të veprimtarisë së GMS-së. (protokolle takimi të GMS-së apo vendime të marra nga GMS), për rrjedhojë është e pamundur të gjykohet ndër të tjera nëse GMS, ka marrë në analizë dhe shqyrtuar çështjet apo problematikat e ndryshme në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të AMBU, në

funksion të implementimit të projektit. Sipas informacionit të dhënë për këtë qëllim grupit të auditimit konfirmohet që: “Nuk ka minuta takimi në kuadër të mbledhjeve të Grupeve të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe të Menaxhimit të Riskut (GMR).

Gjetja nr.3 Mbi mangësitë në funksionimin e GMS-së.	
Subjekti i audituar	AMBU
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	AMBU, Titullari. Grupi i Menaxhimit Strategjik . Sekretari i GMS-së.
Përmbledhja bazës ligjore	VKM nr.221, datë 26.4.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, i ndryshuar. -Ligji nr.10296, datë 08. 07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. -Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
<i>Përshkrim i Gjetjes</i>	Situata: -Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik i institucionit konform nenit 8, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Nuk rezultojnë gjurmë të funksionimit dhe veprimtarisë së GMS-së. (protokolle takimi të GMS-së apo vendime të marra nga GMS) . Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 8. 7.2010, i ndryshuar neni 27; Udhëzimi nr. 16 datë 20.7.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinorit të riskut të njësisë publike”. Ndikimi/Efekti: Nuk ka efekt financiar por ndikon në mos ushtrimin e aktiviteteve të kontrollit parandalues dhe në cilësinë e vendimmarrjeve kolegjiale për çështje të rëndësishme të veprimtarisë së AMBU përshi dhe përmbushjen e detyrimeve për implementimin e projektit. Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe manualit për MFK.
Niveli i Riskut	I Mesëm
Konkluzioni	Nuk rezultojnë protokolle të mbledhjeve të GMS-së në funksion të dokumentimit të ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësive të anëtarëve të GMS-së sikurse përcakton kuadri rregullator.
Rekomandim	a)Të merren masa për dokumentimin e mbledhjeve, takimeve (jo më pak se katër herë në vit) të grupit të Menaxhimit Strategjik. b)Vendimet e marra nga GMS duhet të regjistrohen nga sekretari i GMS-së dhe të vihen në dispozicion të drejtimit të institucionit. (pika 2.2.4 e Udhëzimit nr.16, datë 20.07.2016).
Afati i fundit i zbatimit të rekomandimit	<i>Në vijimësi.</i>
Statusi rekomandimit	Pranuar.

Opinion mbi vlerësimin e komponentit të ambientit të kontrollit:

-Komponenti i ambientit të kontrollit, përgjithësisht rezulton i përshtatshëm por në disa aspekte paraqiten dobësi/mangësi për të cilat nevojitet ndër marrja e masave respektive për përmirësimin e funksionimit të sistemit.

1.2 Mbi vlerësimin e komponentit të menaxhimit të riskut.

U auditua procesi i menaxhimit të riskut në zbatim të kërkesave të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Manualit të dalë në zbatim të ligjit dhe Udhëzimit nr.16, datë 20.7.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” nga i cili rezultoi si më poshtë vijon:

- Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut/plani i menaxhimit të trajtimit të riskut, sikurse përcaktohet në pikën nr. 8, të nenit 8, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Konstatohet se në dokumentin e Planit të ngritjes dhe zhvillimit të MFK-së, si për vitin 2021 dhe për vitin 2022 është parashikuar hartimi i këtij dokumenti dhe nuk është realizuar.

- Është ngritur Ekipi i Menaxhimit të Riskut, me urdhrin e Titullarit nr. 31, datë 17.3.2023, sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr.16, datë 20.7.2016, pika 4 “Hapat për ngritjen e sistemit të menaxhimit të riskut, krijimi i Ekipit të Menaxhimit të Riskut”. *Nuk rezulton të jetë ngritur Ekipi i Menaxhimit të Riskut për vitin 2021 dhe 2022.*

- Konstatohet se për çdo njësi të brendshme strukturore, përfshi dhe strukturën përgjegjëse për ndjekjen e projektit “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri”) është hartuar regjistri i riskut për vitet 2021,2022 por këto regjistra nuk rezultojnë të jenë të zyrtarizuar e miratuar nga Titullari i institucionit. Nga shqyrtimi i regjistrave të riskut, rezulton se regjistri i riskut për vitin 2021, është i njëjtë me regjistrin e riskut të vitit 2022, pra nuk është përditësuar.

Konkluzion: Nuk është përditësuar e zyrtarizuar si dhe në disa aspekte, nuk është ngritur kuadri rregullator për trajtimin dhe menaxhimin e risqeve.

Gjetja Nr. 4 Mbi dobësitë e sistemit të menaxhimit të riskut.	
Subjekti i audituar	AMBU
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	AMBU Titullari, GMS, Ekipi i Menaxhimit të Riskut.
Përmbledhja bazës ligjore	VKM nr. 221, datë 26.4.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, i ndryshuar. Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin; Manuali për MFK, Udhëzim nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të

	menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinorit të riskut në njësitë publike”.
Përshkrim i Gjetjes	<p>Situata: -Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut/plani i menaxhimit të trajtimit të riskut, sikurse përcaktohet në pikën nr. 8, të nenit 8, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.</p> <p>-Nuk rezulton të jetë ngritur Ekipi i Menaxhimit të Riskut për vitin 2021 dhe 2022.</p> <p>-Nga shqyrtimi i regjistrave të riskut, rezulton se regjistri i riskut për vitin 2021, është i njëjtë me regjistrin e riskut të vitit 2022, pra nuk është përditësuar dhe nuk rezultojnë të jenë të zyrtarizuar e miratuar nga Titullari i institucionit. Kriteri: Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, Manuali për MFK e Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Nuk ka efekt financiar. Ndikon në realizimin e objektivave afatshkurtra e afatgjata me efektivitet e efikasitet.</p> <p>Shkaku: Moszbatimi i kërkesave të kuadrit rregullator.</p>
Niveli i Riskut	I mesëm
Konkluzion	Nuk është përditësuar zyrtarizuar dhe në disa aspekte nuk është ngritur kuadri rregullator për menaxhimin e risqeve.
Rekomandim	<p>Me qëllim ngritjen dhe funksionimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të riskut, të merren masat si më poshtë vijon:</p> <p>a)Të hartohet dokumenti i planit strategjik të menaxhimit të trajtimit të risqeve dhe të merren masa për përditësimin e planit çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Ky dokument përpara miratimit nga Titullari, të diskutohet e miratohet nga GMS.</p> <p>b)Të analizohen dhe përditësohen, kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit, bazuar në nenin 21 të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për MFK”, i ndryshuar në të cilin përcaktohet që: Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut të paktën një herë në vit. Çdo menaxher i strukturës së AMBU, të analizojë regjistrin e risqeve për strukturën përkatëse, të identifikojë risqet me nivel të lartë dhe të përgatisë planin e veprimit për minimizimin e tyre sipas formatit të aneksit 3 të Udhëzimit nr.16, datë 20.7.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinorit të riskut në njësitë publike”;</p>
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	<i>Rekomandimi a) 15 dhjetor 2023 ; Rekomandimi b) Në vijimësi.</i>
Statusi rekomandimit	Pranuar.

Opinion mbi vlerësimin e komponentit të menaxhimit të riskut:

Institucioni ka krijuar një kuadër rregullator të brendshëm të papërshtatshëm, për trajtimin dhe menaxhimin e risqeve pasi në disa aspekte paraqiten dobësi/mangësi, për të cilat nevojitet marrja e masave respektive për përmirësimin e funksionimit të sistemit.

1.3 Mbi vlerësimin e komponentit të aktiviteteve të kontrollit dhe zbatimi i procedurave për përmbushjen nga AMBU të detyrimeve të Marrëveshjes së projektit.

-Mbi hartimin e Listës së Proceseve të Punës dhe dokumentimin e aktiviteteve të kontrollit.

Dokumentet e Listës së Proceseve të Punës janë një instrument efektiv për kryerjen e aktiviteteve të kontrollit, në funksion të përmbushjes së përgjegjësi të punonjësve, në ushtrimin e detyrave të tyre dhe arritjen e objektivave institucionale.

Në funksion të garantimit të uniformitetit të kryerjes së proceseve të punës, identifikimit të aktiviteteve të kryera, përgjegjësi, risqeve, dhe afateve për kryerjen e një aktiviteti (procesi), rezultoi se janë listuar proceset e punës, dhe aktivitetet e kontrollit për njësitë e brendshme strukturore të institucionit përfshi dhe strukturën për ndjekjen zbatimin e projektit "Mbështetje për menaxhimin e integruar të ujit në Shqipëri" dhe Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, për fondet e projektit me financim të brendshëm (TVSH) dhe financim të huaj.

Për çdo proces kryesor, janë përcaktuar nën proceset, risqet kryesore për përmbushjen me sukses të procesit operacional, kuadri ligjor dhe afati si dhe struktura përgjegjëse.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të Listës së Proceseve të Punës, rezultoi se këto dokumente, nuk janë të zyrtarizuara (të pa protokolluara), nuk janë të miratuara nga Titullari dhe nuk janë të konfirmuara nga punonjësit/menaxherët e strukturës përkatëse (hartues/përpilues të dokumentit).

Gjetja Nr.5 Mbi mangësitë në zyrtarizimin/miratimin nga Titullari i Listës së Proceseve të Punës.	
Subjekti i audituar	AMBU
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	AMBU Titullari, Menaxherët e njësive të brendshme strukturore të institucionit.
Përmbledhja e bazës ligjore	VKM nr. 221, datë 26.4.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore", i ndryshuar. -Ligji nr.10296, datë 08. 07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar. -Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
Përshkrim i Gjetjes	Situata: Nga shqyrtimi i dokumenteve të Listës së Proceseve të Punës, rezultoi se këto dokumente, nuk janë të zyrtarizuara (të pa protokolluara), nuk janë të miratuara nga Titullari dhe nuk janë të konfirmuara nga punonjësit/menaxherët e strukturës përkatëse (hartues/përpilues të dokumentit).

	<p>Kriteri: Ligji nr.10296, datë 08. 07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit Kapitulli “Komponentët e MFK-së” pika 3.3 Harta e proceseve të punës”. Ndikimi/Efekt: Nuk ka efekt financiar por hartimi i dokumenteve të pa zyrtarizuara dhe të pakonfirmuara nga Titullari, nuk përfaqësojnë akte administrtrive të vlefshme dhe për rrjedhojë impaktojnë procesin e ushtrimit të aktiviteteve të kontrollit parandalues, kryerjen e detyrave funksionale dhe arritjen e objektivave. Shkaku: Mos zbatim i kërkesave të kuadrit rregullator.</p>
Niveli i Riskut	I lartë
Rekomandim	Në funksion të sigurimit të një kuadri rregullativ të përshtatshëm, me qëllim ushtrimin e aktiviteteve të kontrollit dhe monitorimit të realizimit të objektivave e detyrave të caktuara, sigurimit të vendosjes dhe ndarjes së përgjegjësi, të merren masa për zyrtarizimin dhe miratimin nga Titullari e menaxherët e njësi të brendshme strukturore (drejtori, sektor) të dokumenteve të Listës së Proceseve të Punës.
Afati i fundit i zbatimit të Rekomandimit	30 nëntor 2023.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

- Zbatimi i procedurave për përmbushjen nga AMBU të detyrimeve të Marrëveshjes.

-Mbi përmbushjen e detyrimeve të AMBU për pjesëmarrje në Komitetin Drejtues (KD) dhe koordinimin e bashkëpunimin për zhvillimin e takimeve të KD-së.

Referuar Marrëveshjes së Projektit të miratuar, pika 5.2 me emërtesën “Komiteti Drejtues” e aneksit “Përshkrimi i aktivitetit”, përcakton që:

-Komiteti Drejtues (KD) do të jetë autoriteti i përgjithshëm për aktivitetin dhe do të ofrojë udhëzime të përgjithshme strategjike për zbatimin e aktivitetit. KD-ja do të përbëhet nga përfaqësues të nivelit të lartë të AMBU-së, ZK, ministri të zgjedhura të linjës, përfaqësues të njësi të qeverisjes vendore, BE-ja dhe AAZH-ja. Takimet e KD-së *do të kryesohen nga AMBU-ja* dhe do të bashkë-kryesohen nga AAZH-ja.

Nga auditimi rezultoi se:

Në tre mbledhjet e zhvilluara, përgjatë periudhës objekt auditimit (janar 2021 deri në mars 2023), Drejtori i Përgjithshëm ka kryesuar mbledhjet e Komitetit Drejtues, me bashkë kryesues Drejtuesin e Zyrës së AAZH-së, duke përmbushur në këtë mënyrë pikën 5.2 të shtojcës së Marrëveshjes në të cilin përcaktohet që: Takimet e KD-së do të kryesohen, nga AMBU-ja dhe do të bashkë-kryesohen nga AAZH-ja.

-Drejtori i Përgjithshëm i AMBU është caktuar në cilësinë e kryesuesit të Komitetit Drejtues duke përmbushur kërkesat e pikës 5.2 me emërtesën “Komiteti Drejtues” (KD) e aneksit “Përshkrimi i aktivitetit” bashkëlidhur, Marrëveshjes së miratuar ku ndër të tjera përcaktohet që: “KD-ja do të përbëhet nga përfaqësues të nivelit të lartë të AMBU”.

-Nga auditimi rezultoi se në mbledhjet e Komitetit Drejtues, kanë marrë pjesë përfaqësues nga AMBU (Drejtori i Përgjithshëm, Drejtor i Drejtorisë Menaxhimit Strategjik, Drejtor Drejtorie dhe Përgjegjësit e sektorëve të strukturave respektive në cilësinë e pikat e kontaktit të komponentëve të Rezultateve të pritshme (RP1, RP2 dhe RP4) si dhe përfaqësues nga struktura e ndjekjes së zbatimit të projektit.

Takimet e Komitetit drejtues dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të AMBU-t paraqiten si më poshtë:

-Në takimin e Komitetit Drejtues (takimi i 5) i mbajtur më 9.2.2021 kanë marrë pjesë 3 përfaqësues nga AMBU si: Drejtori i Përgjithshëm, Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik dhe Përgjegjësi i Sektorit të Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët .

-Në takimin e Komitetit të Drejtues, (takimi i 6) zhvilluar më 11 nëntor 2021, nga AMBU kanë marrë pjesë 4 përfaqësues: Drejtori i Përgjithshëm i AMBU, Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik dhe dy Përgjegjësit e Sektorit të Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik një herazi dhe persona kontakti për ER1 dhe ER2.

Në takimin e Komitetit Drejtues (takimi i 7), i mbajtur më 9.2.2022, kanë marrë pjesë 7 punonjës përfaqësues nga AMBU si: Drejtori i përgjithshëm, Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik dhe 2 Përgjegjësit e Sektorit të Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik njëherazi dhe persona kontakti për ER1 dhe ER2, dhe Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse i cili është person kontakti për ER4 si dhe Përgjegjësi dhe specialisti i Sektorit të Projekteve të Brëndshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se, takimet e komitetit drejtues, janë zhvilluar në koordinim dhe bashkëpunim me (strukturat respektive në AMBU dhe me njësinë e projektit).

Konkluzion: Vlerësohet pozitivisht përmbushja e detyrimeve nga AMBU për kryesimin dhe përfaqësimin nga niveli i lartë i menaxhimit (Drejtor i Përgjithshëm), për pjesëmarrjen aktive në mbledhjet e Komitetit Drejtues dhe në procesin e koordinimit dhe bashkëpunimit me Agjencinë Zbatuese të Projektit për organizimin dhe zhvillimin e takimeve të KD-së.

-Mbi përmbushjen e detyrimit për emërimin nga AMBU të një zyrtari kryesor për aktivitetin në emër të Agjencisë dhe hartimin dhe nënshkrimin e Marrëveshjes midis AMBU dhe AAZH-së me objekt: Përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi gjatë fazës së zbatimit të projektit.

Në pikën 5.3 me emërtesën “Roli i vendit partner” të aneksit “Përshkrimi i aktivitetit” bashkëlidhur Marrëveshjes, përcaktohet që: Kreu i AMBU-së pritet të emërojë një zyrtar bashkëbisedues/negociator kryesor për aktivitetin në emër të Agjencisë dhe përveç kësaj ndërmjet AAZH-së dhe AMBU-së do të nënshkruhet një marrëveshje për të përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë gjatë fazës së zbatimit.

Nga auditimi u konstatua se:

1-Nuk rezulton shkresë zyrtare për emërimin e një punonjësi në AMBU si bashkëbisedues/negociator për aktivitetin në emër të Agjencisë. Në praktikat shkresore të audituara si dhe në informacionin e paraqitur grupit të auditimit për këtë qëllim rezulton që ky rol është kryer nga Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik në vartësi të të cilit është dhe Sektori i Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit me Donatorët e Huaj.

2-Nuk është hartuar dhe nënshkruar marrëveshje midis AMBU-së dhe AAZH-së, për të përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë gjatë fazës së zbatimit.

-Mbi emërimin e personave të kontaktit (pikat fokale) sipas komponentëve të Rezultateve të Pritshme (RP).

Në nenin 4. “Detyrimet e palëve” të pikës 2/a i) të Marrëveshjes së Projektit përcaktohet: Detyrimet specifike të projektit përfshijnë: i) Bashkëpunimin me ekipin e Projektit mbi bazë ditore në lidhje me çështje operationale, duke caktuar një person kontakti.....” . Caktimi i pikave fokale është diskutuar edhe në mbledhjen e komitetit Drejtues të datës 28.2.2019, në të cilin është dakortësuar caktimi i personave të kontaktit të dedikuar për aktivitetet e projektit.

Nga auditimi rezultoi se pikat e kontaktit kanë funksionuar për komponentët e rezultateve të pritshme (e konfirmuar dhe në Raportin Vjetor të Progresit të vitit 2019) dhe që i përgjigjet ushtrimit të detyrave funksionale në strukturat respektive në AMBU. Përgjatë periudhës objekt auditimi, për shkak të ndryshimeve të stafit, kanë rezultuar dy ndryshime të personave të cilat kanë luajtur rolin e pikave të kontaktit. *Për periudhën objekt auditimi sipas informacionit të paraqitur grupit të auditimit nga Sektori i Projekteve, rezultojnë si pika kontakti punonjësit si më poshtë vijon:*

Pikat Fokale sipas Rezultateve të Pritshme (RP)
RP1. Janar-mars 2021 -Parid Sinella, Përgjegjës Sektori. Sektori Rregullator Legal i Marrëveshjeve dhe Bashkëpunimit Ndërkufitar. mars 2021 e ne vazhdim. Irma Themeli, Përgjegjës Sektori. Sektori Rregullator Legal i Marrëveshjeve dhe Bashkëpunimit Ndërkufitar.
RP 2. Ermela Kraja, Përgjegjës Sektori. Sektori i Burimeve Ujore.
RP 3. Janar 2021-shkurt 2022-Albana Idershari, Drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Shkurt 2022 e ne vijim Erina Çumashi, Përgjegjës Sektori. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
RP 4. Elona Kuçi, Drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Nga auditimi rezultoi se caktimi i personave të kontaktit *nuk është kryer me shkresa zyrtare por në mënyrë verbale*. Po kështu dorëzimi i dokumentacionit/apo materialeve (elektronik apo në letër) midis personave të kontaktit që janë larguar dhe atyre që merrnin detyrën, nuk është bërë me procesverbal dorëzimi.

Gjetja Nr.6 Mbi caktimin e personit zyrtar negocues dhe të personave të kontaktit në zbatim të Marrëveshjes.	
Subjekti audituar	i AMBU

Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	AMBU Drejtori i Përgjithshëm. Drejtori i Menaxhimit Strategjik.
Përmbledhja e bazës ligjore	-VKM nr. 587, datë 4.9.2019 “Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Austriake të Zhvillimit, për projektin “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri”. -VKM nr.764 datë 12.12.2022 “Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr.1 të Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Austriake të Zhvillimit, për projektin “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri”.
Përshkrim i Gjetjes	Situata: i) Nuk rezulton shkresë zyrtare për emërimin e një punonjësi në AMBU si bashkëbisedues/negociator për aktivitetin në emër të Agjencisë. ii) Caktimi i personave të kontaktit <i>nuk është kryer me shkresa zyrtare.</i> iii) Dorëzimi i dokumentacionit/apo materialeve (elektronik apo në letër) midis personave të kontaktit që janë larguar dhe atyre që merrnin detyrën, nuk është bërë me procesverbal dorëzimi. Kriteri: Pika 5.3 me emërtesën “Roli i vendit partner” të aneksit “Përshkrimi i aktivitetit” bashkëlidhur Marrëveshjes. Neni 4. “Detyrimet e palëve” të pikës 2/a i) të Marrëveshjes së Projektit. Ndikimi/Efekti: Caktimi i personave të kontaktit/negocues pa shkresa zyrtare përbën riskun të shtuar në drejtim të marrjes së përgjegjësiive të punonjësve pa akt administrativ zyrtar në funksion të ushtrimit të detyrave të tyre funksionale. Shkaku: Mos zbatim i kërkesave të kuadrit rregullator.
Niveli i Riskut	I mesëm
Rekomandim	Meqenëse institucioni i AMBU-t, do të vijojë me projektin EUSIWM 2, nëpërmjet mbështetjes së sektorit të ujit, me instrumentin IPA III, të merren masa që: 1-Caktimi i personit zyrtar kryesor negocues për aktivitetin në emër të agjencisë dhe i punonjësve që do të luajnë rolin e pikave të kontaktit për çdo komponent të projektit të kryhet me shkresë zyrtare të miratuar nga Titullari. 2-Në rast largimi nga detyra të personave të pikave të kontaktit, për çdo rast dorëzimi i detyrës, të kryhet me procesverbal të konfirmuar nga të dy palët.
Afati i fundit i zbatimit të Rekomandimit	<i>Në vijimësi.</i>
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

-Mbi miratimin e progres raporteve vjetore të zbatimit të projektit.

Konstatohet se nga AMBU, janë shqyrtuar dhe miratuar progres raportet vjetore të zbatimit të projektit, të cilat më pas janë miratuar dhe nga Komiteti Drejtues respektivisht në takimin e 5 dhe takimin e 7, duke zbatuar e përmbushur detyrimin e përcaktuar në nenin 4, pika 2.a. të marrëveshjes, në të cilin përcaktohet detyrimi i përfituesit, për verifikim dhe miratimin e raporteve të paraqitura nga AAZH-ja.

-Në funksion të auditimit të përmbushjes së detyrimeve specifike nga AMBU, në zbatim të Marrëveshjes grupi i auditimit *shqyrtoi me zgjedhje*, praktikat e ndjekura për komponentin e rezultateve të pritshme RP1, i cili rezultoi:

Rezultati e pritshëm 1 (RP1) është : Kuadri ligjor në fushën e menaxhimit të ujit të përmirësohet në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe bazuar në prova të zbatohet dhe të realizohet në pajtim me kërkesat e BE-së.

Në përmbushje të detyrimeve specifike të përcaktuara në nenin 4, të marrëveshjes për RP1, u shqyrtuan komunikimet e vendosura në dispozicion të grupit të auditimit si dhe përmbushja e detyrimeve nga stafi respektiv i AMBU-t i aktiviteteve të parashikuara në Planet vjetore të punës për vitin 2021 dhe 2022, në të cilin janë përcaktuar dhe personat përgjegjës për ndjekjen e aktiviteteve.

-Për ndjekjen e procedurave dhe kryerjen e aktiviteteve të parashikuara në planet vjetore për *Rezultatet e pritshme 1 (RP1)* përgjatë periudhës së auditimit kanë kryer funksionet e pikës së kontaktit për këtë komponent, Përgjegjësit e Sektorit Rregullator Ligjor, Marrëveshjeve dhe Bashkëpunimit Ndërkufitar.

Nga auditimi u konstatua se:

-Sistemi i ndërveprimit me ekipin e projektit rezultoi funksional dhe i përshtatshëm. U konstatua një komunikim dhe kooperim i vazhdueshëm me Njësinë e projektit, referuar çështjeve operacionale me personin e kontaktit, për ER1 në përmbushje të detyrimeve specifike nga AMBU në cilësinë e institucionit përfitues.

-Janë diskutuar dhe dakortësuar me ekipin e projektit planet vjetore të punës në të cilin janë vendosur aktivitetet, afatet, strukturat përgjegjëse. Planet e punës kanë shërbyer si instrumente efektive kontrolli për të përmbushur objektivat/aktivitetet e komponentit RP1.

Referuar Planit të aktivitetit të vitit 2022, *grupi i auditimit administroi* komunikimet dhe dokumentacionin mbështetës për përmbushjen e aktiviteteve të parashikuara, për vitin 2022 dhe konkretisht:

-Nënaktiviteti/hapi, për konsolidimin e Projektligjit “Për burimet ujore” dhe Projektligjit “Për strategjinë detare të Republikës së Shqipërisë” përmes zhvillimit të takimeve të Brendshme të AMBU specifikisht sektorit ligjor dhe ekspertizës së projektit pas takimeve të grupit të punës.

-Komunikimi më datë 25.8.2022, për fillimin e procesit të Vlerësimit të impaktit rregullator (Regulatory Impact Assessment, RIA) për Projektligjin “Për burimet ujore” dhe Projektligjin për ‘Strategjinë detare të republikës së Shqipërisë’.

Më datë 18 Maj 2022., rezulton komunikimi me koordinatoren e projektit për Projektligjin “Për burimet ujore”, për tu diskutuar si subjekt i RIA.

Më datë 15.8.2022, komunikimi për fillimin e procesit të Vlerësimit të Impaktit Rregullator (RIA) për projektligjet.

Në 25 korrik 2022, është dërguar nga ekspertet raporti, mbi vlerësimin ligjor dhe institucional për tu diskutuar, në Gusht 2022.

-Më datë 14.11.2022 dhe 10.11.2022 komunikimi midis koordinatores së projektit dhe pikave të kontaktit, për paketën e RIA, për Projektligjin “Për burimet ujore” dhe Projektligjin “Për strategjinë detare të Republikës së Shqipërisë”.

Me e-mailin e datës 21.10.2022, nga koordinatoresha e projektit, është dërguar plani i punës deri në miratimin e ligjeve dhe aktiviteteve që mund të lidhen me mbështetjen e projektit.

-Po kështu rezultojnë e-maile komunikuese me koordinatoren e projektit për takimet e zhvilluar për konsultimin e ligjit në përmbushje të aktivitetit nr. 8 të planit të punës adresuar nga projekti.

Më 21.11.2022 nga personi i kontaktit për ER1, është dërguar koordinatorit të projektit paketa e përcjellë në KM për Projektligjin “Për burimet ujore”.

Sa më sipër rezulton një komunikim dhe kooperim i vazhdueshëm me Njësine e projektit, referuar çështjeve operacionale me personin kontaktit, për RP1 në përmbushje të detyrimeve specifike nga AMBU në cilësinë e institucionit përfitues.

-Për aktivitetin “Vendosja e Grupit Ndërinstitucional nga AMBU” përgjegjës është caktuar stafi i AMBU, dhe është vendosur afati i realizimit, muaji shkurt 2021. Ky aktivitet është përmbushur.

-Janë ndjekur praktikat dhe është nxjerrë Urdhri nr. 24, datë 9.2.2021 i Kryeministrit “Mbi vendosjen e grupit ndërinstitucional të punës për draftimin e paketës ligjore në sektorin e menaxhimit burimeve ujore”.

Po kështu referuar planit të aktiviteteve rezulton se janë parashikuar 9 takime, ku strukturat përgjegjëse për këto aktivitete janë caktuar AMBU dhe Grupi Ndërinstitucional (LWG) përgjatë vitit 2021.

Në përmbushje të detyrimeve janë organizuar 10 takime të Grupit Ndërinstitucional dhe grupi i auditimit administroi komunikimet midis pikës fokale të RP1 dhe koordinatores së projektit për realizimin e takimeve (Axxhenda, konfirmime të takimeve, minuta takimi etj).

-Në planin e aktiviteteve për vitin 2022, ishte parashikuar aktiviteti për bashkëpunimin e AMBU- me ekspertët e projektit, për hartimin e Raporteve të Vlerësimit të Ndikimit (RIA) për dy projektligjet. Referuar informacionit të marrë për këtë qëllim, rezulton se nga AMBU është bërë kontrolli i draftit të Raporteve si dhe përshtatja me formatin e përcaktuar për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit (RIA), sipas Rregullores së funksionimit të Këshillit të Ministrave, miratuar me Vendimin nr. 584, datë 28.8.2003, të ndryshuar duke përmbushur detyrimin e përcaktuar në nenin. 4, pika 2.a. të marrëveshjes, në të cilin përcaktohet detyrimi i përfituesit për verifikim dhe miratimin e raporteve të paraqitura nga AAZH-ja.

Në planin e aktiviteteve për vitin 2022 për RP1, rezultojnë të parashikuara katër nënaktivitete/hapa për zhvillimin e takimeve nr. 11-14 të Grupit Ndërinstitucional të punës me

objekt rishikimi i draft 12 VKM-ve. (Në kuadër të këtij RP 1, nga projekti në bashkëpunim me përfaqësuesit e AMBU-së, gjatë vitit 2020 është hartuar draft paketa ligjore pjesë e së cilës janë dhe 12 draft VKM në zbatim të projektligjit).

Rezultoi se këto takime nuk janë zhvilluar përgjatë vitit 2022 dhe nga Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik, grupit të auditimit iu paraqit informacioni si më poshtë vijon: Në lidhje me këtë aktivitet, në kushtet kur draftet e projektligjeve pësuan disa ndryshime gjatë konsultimit të tyre si pjesë e këtij grupi pune, si dhe në rrethanat kur këto drafte bazohen në akte ligjore të pamiratuara sikurse draft ligji “Për Burimet Ujore” dhe draft ligji “Për Strategjinë detare të Republikës së Shqipërisë”, nga strukturat menaxheriale të AMBU-së në dakortësi verbale me përfaqësuesit e projektit EUSIWM, është vendosur që këto konsultime, të bëhen në fazat kur projektligjet të jenë miratuar të paktën nga Këshilli i Ministrave dhe gjatë procesit të miratimit në Parlament të bëhet paralelisht konsultimi i legjislacionit plotësues. Kjo duke pasur sigurinë që mbështetja IPA III është miratuar tashmë dhe projekti EUSIWM 2 do të nisë brenda vitit 2023, i cili do të mundësojë dhe finalizimin e këtij procesi nga ana logjistike”.

Po kështu në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në planin e punës, janë realizuar edhe takime konsultuese në nivel ekspertësh në çdo Këshill Baseni Lumor si më poshtë vijon:

1. Takim konsultues në KBU Drin - Bunë, datë 22 qershor 2022;
2. Takim konsultues në KBU Mat date 23 qershor 2022;
3. Takim konsultues në KBU Erzen date 24 qershor 2022;
4. Takim konsultues në KBU Ishëm datë 27 qershor 2022;
5. Takim konsultues në KBU Seman date 30 qershor 2022;
6. Takim konsultues në KBU Shkumbin date 4 korrik 2022;
7. Takim konsultues në KBU Vjosë date 6 korrik 2022.

-Përsa i përket përmbushjes së nënaktivitetit /hapi nr. 11 të planit të punës për vitin 2022 “Për publikimin e dy projektligjeve nëpërmjet metodës së e-konsultimit në regjistrin elektronik për RP1 rezulton se ky aktivitet është përmbushur. Referuar informacionit të paraqitur për këtë qëllim, rezulton se të dy projektligjet janë konsultuar/publikuar në faqen zyrtare të konsultimit publik :

-<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/463>; -Projektligji “Për burimet ujore” dhe -<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/465>; -Projektligji “Për strategjinë detare të Republikës së Shqipërisë”.

Krahas sa më sipër të dy projektligjet janë publikuar përmes publikimit në faqen zyrtare të AMBU:<http://www.ambu.gov.al/publikimi-i-draft-projektligjit-per-strategjine-detare/>; dhe <http://www.ambu.gov.al/publikimi-i-draft-projektligjit-per-burimet-ujore/>;

-Nga AMBU është proceduar me përcjelljen e paketave të projektligjeve në KM, respektivisht me shkresat si më poshtë vijon:

a) Paketa e Projektligjit “Për Burimet Ujore”, me shkresën nr. 1896, datë 17.11.2022, me lëndë “Dërgohet një projektvendim i KM për ndjekjen e procedurave për miratim”.

b) Paketa e Projektligjit “Për Strategjinë detare të Republikës së Shqipërisë”, me shkresën nr. 101, datë 17.01.2023, me lëndë “Dërgohet një projektvendim i KM për ndjekjen e procedurave për miratim”.

Aktualisht nga AMBU, është vijuar për shqyrtimin e komenteve të ardhura nga ministrinë e linjës për të dy projektligjet, si dhe marrjen e masave për kryerjen e reflektimeve të nevojshme sipas rastit në tekstin e projektligjeve apo në relacionet përkatëse.

-Për RP1 është përmbushur detyrimi specifik i përcaktuar në pikën nr. 2, germa (b), të nenit 4, të Marrëveshjes “Detyrimet e Palëve” sipas të cilit “Përfituesi duhet të garantojë lidhjen e Projektit me politikën kombëtare dhe kuadrin përkatës ligjor për prioritetet e reformës së ujit, me qëllim që tu mundësohet dhe nxitet koherenca e objektivave të Projektit me kushtet e brendshme kuadër” dhe konkretisht:

Në nenin 4 të Marrëveshjes “Detyrimet e Palëve” në pikën nr. 2, germa (b), është përcaktuar detyrimi specifik që duhet të përmbushë përfituesi “Garantimi i lidhjes së Projektit me politikën kombëtare dhe kuadrin përkatës ligjor për prioritetet e reformës së ujit, me qëllim që tu mundësohet dhe nxitet koherenca e objektivave të Projektit me kushtet e brendshme kuadër”. Referuar informacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit referuar përmbushjes së këtij detyrimi për RP1, rezultoi:

Produktet e dorëzuara për këtë Rezultat të Pritshëm, specifiku projektligji “Për Burimet Ujore”, si dhe 12 draft VKM-të në zbatim të tij, projektligji “Për Strategjinë Detare të Republikës së Shqipërisë” dhe draft VKM-së në zbatim të tij, janë në përputhje me politikën kombëtare dhe kuadrin ligjor përkatës në kuadër të reformës së ujit. Përkatësisht, bazuar në parashikimet e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027, miratuar me VKM-në nr. 73, datë 7.02.2018, e cila përcakton si një nga objektivat e saj sa më poshtë:

“Cilësia e ujit: Sigurimi i cilësisë së ujërave të të gjitha burimeve ujore duke arritur statusin “cilësi e mirë” deri në vitin 2027, duke aplikuar aktet edhe nën-aktet ligjore kombëtare të cilat traspozojnë direktivat e BE-së.”

Konkluzion: Nga auditimi i përmbushjes së detyrimeve specifike nga AMBU për RP1 rezultoi se këto detyrime janë përmbushur.

-Mbi aktivitetet e kontrollit dhe funksionimin e sistemit të komunikimit midis Sektorit të Projekteve në AMBU dhe Njësinë e Zbatimit të Projektit për krijimin e arkivit elektronik e fizik të trajnimeve të zhvilluara nga projekti.

Në raportin e implementimit të projektit për vitin 2022 (AIR) citohet që: EUSIWM ka investuar në vendosjen e një arkive fizike dhe elektronike të trajnimeve. Pas çdo workshopi dhe trajnimi të kryer i gjithë dokumentacioni i realizuar sipas strukturës/formatit të EUSIWM është shpërndarë midis pjesëmarrësve dhe depozituar në arkivin e AMBU.

Nga auditimi i sistemit të komunikimit midis Sektorit të Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët dhe Njësisë së Zbatimit të Projektit për krijimin e arkivit elektronik të trajnimeve të zhvilluara nga projekti, rezultoi se dokumentacioni i trajnimeve të zhvilluara, është dërguar elektronikisht nga projekti me e-mail tek specialistja e Sektorit e më pas ky dokumentacion ka ardhur në institucion fizikisht (me zarf), pa shkresë përcjellëse, dhe është depozituar, në dosjen përkatëse të çdo moduli.

Dokumentacioni fizik i sjellë, nuk është protokolluar në zyrën e arkiv protokollit të institucionit por është marrë dorazi nga specialistja e sektorit.

Bazuar në rregulloren e brendshme të institucionit, neni 23 “Menaxhimi i korrespondencave me institucionet e tjera” në pikën 3, citohet se: “Çdo shkresë e institucioneve shtetërore apo subjekteve private drejtuar AMBU-së shoqërohet me “Kartelë shoqëruese”.

Në fillim të dosjes ishte vendosur përmbajta e saj si dhe dokumentacioni përkatës që përmbante axhendën, përshkrimin e moduleve të trajnimit, prezantimin, vlerësimin dhe listën e pjesëmarrësve. Nga verifikimi i kryer në Sektorin Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët, nga audituesja E.Ibraliu në prani të specialistes së këtij sektori, i listës së trajnimeve/workshopeve të zhvilluara përgjatë vitit 2020, 2021, 2022 dhe 2023, dhënë grupit të auditimit nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse (në mungesë të regjistrimit të shkresave në protokoll, pra nuk ka gjurmë auditimi) rezultoi se të gjitha trajnimet/workshopet në listë, ishin në dosjet fizike të trajnimeve të zhvilluara që gjenden në Sektorin e Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët, përveç dy trajnimeve të zhvilluara në mars 2022, “Statusi, monitorimi dhe masat e ujërave tokësore” dhe “Takimi përmbyllës dhe vlerësimi për monitorimin e ujërave sipërfaqësore”. Pas verifikimit të dy dosjet e trajnimeve u depozituan në arkivin fizik të trajnimeve. Dosjet rezultuan të pa inventarizuara.

Tabela e mëposhtme paraqet listën e workshopeve të zhvilluara në vitin 2020, 2021, 2022, prill-maj 2023, dhënë grupit të auditimit dhe rezultatet e verifikimit.

Nr	Vendi organizmit	Data	Muaji	Viti	Tema e trajnimit	Shënime
1	AMBU	15	Janar	2020	Transpozimi dhe zbatim i acquis për mjedisin dhe ndryshimet klimatike / Cilësia e ujit - Kapitulli 27: Statusi dhe planet	
2	AMBU	3	Shkurt	2020	Workshop 3-të për Paketën Ligjore.	
3	Rogner	4	Shkurt	2020	Përcaktimi i trupave ujore, presionet, statusi, ndikimet për shpërndarjen e RBMP.	
4	AMBU	7	Shkurt	2020	Workshop 4-të për Paketën Ligjore.	
5	AMBU	13	Shkurt	2020	Workshop 5-të për Paketën Ligjore.	
6	AMBU	4	Mars	2020	Workshop 6-të për Paketën Ligjore.	
7	online	12	Mars	2020	Workshop 7-të për Paketën Ligjore.	
8	online	27	Mars	2020	Workshop 8-të për Paketën Ligjore.	
9	Zoom	22	Prill	2020	Bazat e Kornizës së Menaxhimit të Projektit.	
10	Zoom	24	Prill	2020	Bazat e Kornizës së Menaxhimit të Projektit: Identifikimi/formulimi i projektit, grafiku i projektit dhe	

					identifikimi i palëve të interesuara.	
11	Zoom	29	Prill	2020	Bazat e Kornizës së Menaxhimit të Projektit: Përmasat e vogla, të mesme dhe të mëdha të sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri.	
12	Zoom	30	Prill	2020	Learn the Fundamentals of Project Management Framework: Draft of project proposal fishe based on AMBU's current needs .	
13	online skype	20	Korrik	2020	Presioni dhe ndikimi i trupave ujqorë.	
14	AMBU (Zoom)	1	Shtator	2020	Bazat e IWRM dhe WFD (Njohuri të Përgjithshme).	
15	AMBU (Zoom)	9	Shtator	2020	Kuptimi bazë i procesit të përafritimit.	
16	Ishem-Erzen river basin	17	Shtator	2020	Udhëtim në terren – Fushata Monitoruese.	
17	AMBU (Zoom)	23	Shtator	2020	Ndikimet e hidrocentraleve në statusin e trupave ujqorë dhe përcaktimi i kushteve të lejes dhe masave zbutëse.	
18	AMBU (Zoom)	28	Shtator	2020	Hyrje në përmbajtjen dhe dobinë e analizës ekonomike për planifikimin e RBM.	
19	Ibe e poshtme Tirane	14	Tetor	2020	Vizitë në terren të Hidroenergjisë Murdhar.	
20	Rogner + Zoom	20	Janar	2021	Përcaktimi për basenin e lumit Mat dhe ilustrimi i sistemit të kodimit të basenit/trupave ujqorë PFAFSTETTER.	
21	Zoom	18	Mars	2021	Rishikimi i opsioneve për programin e masave – Basenet e lumenjve Ishëm dhe Erzen – seminari 1 – masat bazë dhe plotësuese.	
22	Rogner + Zoom	25	Mars	2021	Rishikimi i opsioneve për programin e masave – Basenet e lumenjve Ishem dhe Erzen – seminari 1 – masat bazë dhe plotësuese.	
23	Teams	27	Prill	2021	Përmbledhje–metodologjia për plotësimin e tabelave të RBMP 13-4, 13-5, 13-6.	
24	Rogner	17	Mars	2021	Analiza dhe vlerësimi i të dhënave të monitorimit duke përdorur funksionin MS excel 'pivot'.	
25	Baseni Ishem	14, 15, 19, 21, 22, 26, 28, 29	Prill	2021	Fushata e Monitorimit të Kampionimit - Trajnim në	

					terren për marrjen e mostrave nga makroinvertebrorët	
26	Rogner + Zoom	20	Maj	2021	Vlerësimi i Ndikimit të Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Zeza 'Kashar' në cilësinë e ujit të basenit të lumit Ishëm.	
27	Zyrat EUSIWM	10. 18, 21	Maj	2021	Designing the surface eater monitoring programme for the 2022-2027 Ishëm river basin management plan.	
28	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	21	Qershor	2021	Trajtimi i mostrave të makroinvertebrorëve (Zgjidhja, identifikimi i specieve, vlerësimi).	
29	Bovilla, Cekreza, Tapiza & Tirana Lake	23, 28 & 1	Qershor -Korrik	2021	Fushata e Monitorimit të Kampionimit - Trajnim në terren për marrjen e mostrave nga makroinvertebrorët.	
30	Rogner	8	Korrik	2021	Vlerësimi i të dhënave të cilësisë së ujërave sipërfaqësore.	
31	Zyrat EUSIWM	1, 15	Shtator	2021	Mbështetje në përgatitjen e Programeve të Masave për RBMB 2022-2027 Mat, Ishëm dhe Erzen.	
32	AMBU + Ekipet	17	Shtator	2021	Realiteti Shqiptar mbi trajtimin e ujërave të zeza dhe llumit.	
33	Rogner	21	Shtator	2021	Klasifikimi, Karakterizimi dhe Statusi i Trupit Ujor nëntokësor (GWB).	
34	Rogner	29	Tetor	2021	Workshop me temë "Metodat e vlerësimit biologjik".	
35	ZABU Tirana	16	Shtator	2021	Moduli i Trajnimit GIS IN - Bazat.	
36	ZABU Shkodra	30	Shtator	2021	Moduli i Trajnimit GIS IN - Bazat.	
37	ZABU Vlora	15	Nëntor	2021	Moduli i Trajnimit GIS IN - Bazat.	
38	Zyrat e AMBU	4	Tetor	2021	Moduli II i Trajnimit të GIS-it - RBMP.	
39	ZABU Shkodra	7	Tetor	2021	Moduli II i Trajnimit të GIS-it - RBMP.	
40	ZABU Tirana	8	Tetor	2021	Moduli II i Trajnimit të GIS-it - RBMP.	
41	ZABU Vlora	23	Nëntor	2021	Moduli II i Trajnimit të GIS-it - RBMP.	
42	Zyrat e AMBU	21	Tetor	2021	Moduli i Trajnimit të GIS III - Kadastra e Ujit.	
43	ZABU Tirana	22	Tetor	2021	Moduli i Trajnimit të GIS III - Kadastra e Ujit.	
44	ZABU Shkodra	25	Tetor	2021	Moduli i Trajnimit të GIS III - Kadastra e Ujit.	
45	ZABU Vlora	24	Nëntor	2021	Moduli i Trajnimit të GIS III - Kadastra e Ujit.	

46	Zyrat EUSIWM	3	Mars	2022	Analiza Ekonomike dhe Tarifat/Tarifat e Ujit: rezultatet dhe rruga përpara.	
47	Rogner	17	Mars	2022	Statusi, monitorimi dhe masat e ujërave nëntokësore.	nuk ndodheshi n në dosjen fizike të modulit përkatës u vendosen gjatë auditimit
48	Zyrat EUSIWM	25	Mars	2022	Takimi përmbyllës dhe vlerësimi për monitorimin e ujërave sipërfaqësore.	Nuk ndodheshi n në dosjen fizike të modulit përkatës u vendosen gjatë auditimit
49	Zyrat EUSIWM	28	Qershor	2022	Komponenti i Analizës Ekonomike (ER4): rezultatet dhe rruga përpara.	
50	Zyrat EUSIWM	27	Korrik	2022	Kuptimi për monitorimin dhe detyrimet e ardhshme në respektim me MMBP dhe vlerësim strategjik mjedisor.	
51	Zyrat EUSIWM	12	Shtator	2022	Zhvillimi I një kuadri monitorimi dhe raportimi për PRMB-të dhe detet, bazuar në raportimin e treguesve.	
52	Zyrat EUSIWM	17	Qershor	2022	Takimi prezantues: roli dhe rëndësia e pjesëmarrjes së publikut në procesin e VSM-së.	
53	Zyrat EUSIWM	4	Prill	2023	Kuptimi dhe identifikimi i çështjeve themelore problemeve brenda procedurave aktuale të administrimit të lejes.	
54	Mat RB, Udhëtim	20, 21	Qershor	2022	Vizitë në terren (fushatë monitoruese) + ëorkshop.	
55	Rogner	18	Maj	2023	Vlerësimi teknik i përmirësuar i ndikimit të lejeve të nxjerrjes dhe mjedisit.	

Sa më sipër sistemi i komunikimit me Njësinë e Zbatimit të Projektit për dokumentacionin e trajnimeve, të protokollimit inventarizimit dhe arkivimit, paraqet mangësi për të cilin është e nevojshme, marrja e kontrolleve shtesë për funksionimin e përshtatshëm dhe efektiv të tij (sistemit).

Gjetja Nr.7 Mbi sistemin e komunikimit të dokumentacionit të trajnimeve protokollimi dhe arkivimi tyre.	
Subjekti i audituar	AMBU
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	AMBU Drejtori i Përgjithshëm i AMBU, Drejtori i Drejtorisë së menaxhimit Strategjik, Sektori i Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët, Nëpunësi përgjegjës për arkiv protokollin në institucion.
Përmbledhja e bazës ligjore	VKM nr.221, datë 26.4.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”. Rregullorja e Brendshme e intitucionit. Urdhri nr. 86, datë 26.7.2023 i Kryeministrit, “Për miratimin e rregullores për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Zyrave të Administrimit të Baseneve Ujore”. Vendimi nr.4 datë 19.6.2017 “Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumente në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë” miratuar nga Këshilli i Lartë i Arkivave. -Rregullorja e Brendshme
Përshkrim i Gjetjes	Situata: Nga auditimi i sistemit të komunikimit të dokumentacionit të trajnimeve të zhvilluara, rezultoi se dokumentacioni fizik i trajnimeve është dërguar elektronikisht nga projekti me e-mail tek specialistja e Sektorit e më pas ky dokumentacion është dërguar pranuar/marrë nga specialistja e Sektorit të Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët dorazi. Dokumentacioni i dërguar nuk është shoqëruar me shkresë zyrtare, rezulton i paprotokolluar dhe i painventarizuar. Kriteri: VKM nr.221, datë 26.4.2018 , Rregullorja e brendshme e AMBU. Vendimi nr.4 datë 19.6.2017 . Ndikimi: Mos protokollimi i dokumentacionit të trajnimeve të dërguara nga Njësia e Zbatimit të Projektit në AMBU dhe mosinventarizimi i tyre përbën risk të shtuar në drejtim të mos sigurimit të gjurmëve të auditimit dhe të mirëadministrimit të arkivit fizik dhe elektronik të trajnimeve. Shkaku: Moszbatimi i kërkesave të kuadrit rregullator.
Niveli i Riskut	I Lartë.
Rekomandim	1. Të merren masa që në funksion të sigurimit të gjurmës së auditimit të dokumentacioneve të trajnimeve, të kryera në kuadër të zbatimit të projektit dhe të dërguara në institucionin e AMBU-t, të ndërpritet praktika e marrjes dorazi të dokumentacionit dhe të procedohet me bërjen hyrje në institucion nëpërmjet zyrës/punonjësit së arkiv protokollit dhe bazuar në kartelën shoqëruese të administrohet, nga

	Sektori i Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët. 2.Të kryhet inventarizimi i dosjeve të trajnimeve dhe të depozitohen në arkivin e institucionit.
Afati i fundit zbatimit të rekomandimit	<i>Afati: Menjëherë dhe në vijimësi.</i>
Statusi rekomandimit	Pranuar.

Opinion: Funksionimi i komponentit të aktiviteteve të kontrollit, përgjithësisht rezulton i përshtatshëm por në disa aspekte evidentohen mangësi, për të cilat nevojitet ndërmarrja e masave dhe kontrolleve shtesë për përmirësimin e sistemit.

Opinion: Funksionimi i komponentit të aktiviteteve të kontrollit, përgjithësisht rezulton i përshtatshëm por në disa aspekte evidentohen mangësi, për të cilat nevojitet ndërmarrja e masave dhe kontrolleve shtesë për përmirësimin e sistemit.

1.4 Mbi vlerësimin e komponentit të informim (raportim) komunikimit.

Nga auditimi rezultoi se janë përcaktuar rregulla për komunikimin shkresor dhe elektronik të jashtëm dhe të brendshëm në Rregulloren e Brendshme të institucionit.

Institucioni ka krijuar informacion të përshtatshëm, të identifikuar dhe raportuar në kohë, të përfutur nga burime të jashtme, si dhe informacion të gjeneruar nga brenda, duke ndihmuar procesin e vendimmarrjes.

Informacioni i është komunikuar menaxhimit dhe punonjësve të tjerë dhe ka ndihmuar në kryerjen e përgjegjësiave dhe detyrave të ngarkuara.

Komunikimi i brendshëm ndërmjet Titullarit dhe punonjësve të tij (komunikimi vertikal) ka funksionuar në mënyrë efektive dhe ka ndikuar në nivelin e ndërgjegjësimit të punonjësve për rolin dhe përgjegjësitë që kanë në lidhje me arritjen e qëllimeve dhe objektivave.

Rezultoni një komunikim horizontal efektiv, me një ndërveprim të mirë dhe shkëmbimin në kohë të informacionit në të gjitha nivelet.

Ky komunikim ka ndikuar pozitivisht në arritjen e objektivave duke minimizuar risqet që ndikojnë në aktivitetin e institucionit dhe është synuar një komunikim i hapur dhe interaktiv.

Me urdhrin e Titullarit nr.51 datë 7.4.2021 është përcaktuar personi përgjegjës i ngarkuar me detyrën e Koordinatorit për të drejtën e informimit dhe për publikimin në website-in zyrtar të institucionit

AMBU përdor komunikimin e jashtëm duke siguruar qasjen publike nëpërmjet publikimit në faqen e internetit zyrtar institucional.

Nga auditimi rezultoi se në faqen zyrtare të AMBU, në rubrikën “Projekte”, AMBU publikon të dhëna të projekteve, të cilët janë aktualisht në zbatim dhe projekteve të cilët kanë përfunduar. Në këtë faqe është publikuar informacion, mbi projektet me financim të huaj, të ndarë sipas donatorëve të projekteve dhe konkretisht për projektin “Mbështetja e BE-së për Menaxhimin e Integruar të Ujit

në Shqipëri-EUSIWM” janë publikuar të dhëna mbi shtrirjen e projektit, financimin, donatorët, përfituesi, kohëzgjatja e projektit, realizimi i projektit deri në gusht 2022, përshkrimi i projektit, rezultatet e projektit si: 1. Përmirësimi i kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të ujit në mënyrë gjithëpërfshirëse, bazuar në rezultate konkrete dhe në përputhje me kërkesat e BE-së; 2. Përgatitja e Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore për basenet ujore Ishëm, Erzen, Mat dhe analiza paraprake për basenin e lumit Vjosa; 3. Përmirësimi i kapaciteteve institucionale në nivel baseni ujor; 4. Përmirësimi i kuadrit financiar, analizës ekonomike të nxjerrjes së ujit dhe përdorimit të burimeve ujore në nivel baseni lumor, në përputhje me parimet e DKU-së, si dhe rishikimi dhe zbatimi i një qasje të re të tarifimit.

Në këtë faqe gjenden dhe publikime të: 1. Projektligjit “Për burimet ujore”. 2. Publikimi i Projektligjit “Për strategjinë detare. 3. I drafteve finale të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor për Lumin Ishëm dhe Erzen.

Krahas sa më sipër rezulton një rubrikë “postimet e fundit” konsideruar si instrument për të siguruar qasjen publike, për eventet më të përditësuara të institucionit, përmendim: Konferencën e ujit në New York, mars 2023.

Krahas sa më sipër në faqen zyrtare janë publikuar dhe dokumente që kanë të bëjnë me kuadrin strategjik dhe rregullator ligjor nën ligjor etj.

Bazuar në materialin vënë në dispozicion grupit të auditimit u konstatua se AMBU ka informuar periodikisht institucionin epror (Kryeministrinë) mbi aktivitetin institucional përfshi dhe ecurinë e Projektit “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri”.

Sa më sipër trajtuar përmendim:

-Në datën 4.3.2021, Drejtori i Përgjithshëm i agjencisë, ka dërguar e-mail në Kryeministri ku raporton mbi veprimtarinë e kryer nga agjencia për muajin Shkurt 2021.

-Në datën 8.7.2022, Drejtori i Përgjithshëm i agjencisë, ka dërguar e-mail në Kryeministri ku raporton mbi veprimtarinë e kryer nga agjencia për 6 mujorin e parë të vitit 2022 mbi bazën e informacionit të kërkuar nga Kryeministria për: -Realizimin e objektivave të institucionit.

-Realizimin e investimeve.

-Realizimin e shërbimeve.

-Aktet nën-ligjore të miratuara.

-Aplikimin e shërbimeve on-line.

-Indikatorët matës për përfitimet e qytetarëve.

-Mundësia e promovimit të produkteve pozitive.

-Uljen e riskut për të marrë kosto.

-Specifika që mbart secili institucion.

-Problematika të konstatuara.

-Në datën 2.11.2022, Drejtori i Përgjithshëm i agjencisë, ka dërguar e-mail në Kryeministri ku raporton mbi veprimtarinë e kryer nga agjencia për 6 mujorin e dytë të vitit 2022.

-Në datën 28.4.2023, Drejtori i Përgjithshëm i agjencisë, ka dërguar e-mail në Kryeministri ku raporton mbi veprimtarinë e kryer nga agjencia për 4 mujorin e parë të vitit 2023.

-Në kuadrin e zbatimit të projektit, nga auditimi rezultoi një komunikim efektiv midis njësive së Zbatimit të projektit dhe stafit të AMBU-t.

-Përgjatë zbatimit të projektit janë kryer një sërë aktiviteteve që kanë të bëjnë me rritjen e ndërgjegjësimit të audiencës përkatëse dhe palëve të interesit mbi domosdoshmërinë e menaxhimit të integruar të ujërave në Shqipëri. Në këtë kuadër janë organizuar një sërë takimesh/mbledhje/tryeza të rrumbullakëta AMBU dhe Këshillit të Baseneve ujore, Festimi i Javëve të BE në Shqipëri, fushata të monitorimit të ujit në bashkëpunimin me stafin e AMBU, ZABU, ekspertë të projektit dhe përfaqësues të trupave akademike, fushata sensibilizuese, vizita në terren me fokus monitorimin e cilësisë së ujit, seanca trajnimi në terren dhe takimet konsultuese për paketën ligjore, etj.

Krahas sa më sipër, janë organizuar dhe Konferenca Kombëtare të Ujit më 24 nëntor 2020, 15 dhjetor 2021, 1 qershor 2023, dhe në datë 28 nëntor në Vjenë është organizuar simpoziumi i lumenjve i cili u mundësua nga projekti dhe në të cilin morën pjesë përfaqësues nga AMBU dhe institucione të tjera.

-Mbi sistemin e koordinimit dhe përgatitjen e raportimit në SASPAC të raporteve vjetore të implementimit të zbatimit të projektit 2021 dhe 2022 (IPA/AIR)

-Nga auditimi i sistemit të koordinimit dhe përgatitjes së raportit vjetor të implementimit (IPA/AIR) nga Drejtoria e Menaxhimit Strategjik/Spektori i Projekteve rezultoi se është përmbushur detyrimi për përgatitjen e Raportit vjetor të implementimit të projektit për vitin 2021 dhe 2022, dhe për adresimin brenda afatit të përcaktuar në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (SASPAC). Konkretisht:

i) Mbi Raportin vjetor të implementimit IPA për vitin 2021.

Nga Drejtori i Përgjithshëm i SASPAC më datë 12 Janar 2022 është adresuar kërkesa në AMBU për dërgimin në SASPAC të kontributit për raportin vjetor të implementimit (AIR) IPA për projektin EUSËIM.

Me e-mailin e datës 20 janar 2022 të Drejtorit të Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik është adresuar Raporti për ecurinë e projektit dhe progresin e AMBU-së konform formatit të IPA AIR të vitit 2021.

ii) Mbi Raportin vjetor të implementimit IPA për vitin 2022.

Bazuar në email-in e dërguar nga Drejtori i Drejtorisë për Administrimin e Asistencës Financiare të BE-së, më 21.12.2022, për dorëzimin e kontributeve për hartimin e raportit vjetor, nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, është dërguar në SASPAC, kontributi mbi raportin vjetor të implementimit të Projektit EUSIWM për vitin 2022, me e-mail në datë 20.1.2023 konform modelit të përcaktuar nga Shërbimet e Komisionit dhe brenda afatit të përcaktuar.

Për përgatitjen e Raportit referuar informacionit të paraqitur rezultoi se për përgatitjen e raportit vjetor IPA AIR, mbi realizimin e projektit EUSIWM gjatë vitit 2022, nga Spektori i projekteve për përgatitjen e raportit:

Është marrë informacion mbi statusin e realizimit të aktiviteteve të projektit për secilin rezultat nga pikat fokale brenda AMBU-së, sipas komponenteve përkatëse, bazuar në planet e punës të hartuar në fillim të vitit 2022, si dhe referuar komunikimeve periodike me zyrën e projektit etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultojnë komunikime dhe kërkesa të Sektorit të projekteve adresuar pikave të kontaktit në funksion të ndjekjes së zbatimit të detyrimeve/aktiviteteve të planifikuara dhe evidentimit të progresit të arritur.

Konkluzion: Nga AMBU është përmbushur detyrimi për përgatitjen e Raportit vjetor të implementimit të projektit për vitin 2021 dhe 2022, dhe për adresimin brenda afatit të përcaktuar në SASPAC.

Po kështu rezulton se nga Sektori i Projekteve, çdo muaj (me përjashtim të një rasti që nuk u gjet shkresa përcjellëse në protokoll janë kryer raportimet e financimit të huaj në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, konform përcaktimeve të Udhëzimit nr. 35, datë 21.9.2020 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “Për kontrollin regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare, bazuar në raportimet e Njesisë së Zbatimit të Projektit.

Konkluzion: Funksionimi i komponentit të informim komunikimit rezulton i përshtatshëm dhe efektiv.

1.5 Mbi vlerësimin e komponentit të monitorimit.

- Përsa i përket vlerësimit dhe monitorimit të sistemeve të MFK-së konstatohet se:

Konform përcaktimit të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Manuali të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit u konstatua se me shkresën nr.467 prot., datë 4.2.2022 dhe me nr.297 prot., datë 23.2.2023 është dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë paketa dokumentare për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin për vitin 2021 dhe 2022 duke respektuar afatet e përcaktuara në kuadrin rregullator.

Po kështu konform procedurave të përcaktuara në aktet rregullative është proceduar me organizimin e procesit të hartimit të raportit vjetor dhe të deklaratës, në drejtim të mbledhjes së informacionit nga njësitë e brendshme strukturore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se janë hartuar dokumentet e Planit të masave për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Nga auditimi i saktësisë së përpilimit të këtyre dokumenteve rezultoi se: Të dy dokumentet si për vitin 2021 dhe 2022 në rubrikën aktivitete të planifikuara janë të njëjta, të pa përditësuara.

Në këtë rubrikë duhet të përfshihen aktivitetet e planifikuara për tu ndërmarrë, me qëllim zgjidhjen e mangësive të zbuluara gjatë përgatitjes së raporteve vjetore mbi funksionimin e sistemit të MFK-së. Në këtë aspekt për të dy vitet, në rubrikën datat e pritshme të realizimit të aktiviteteve janë vendosur afatet e viteve korente 2021 dhe 2022, në vend të vendosjes së vitit pasardhës 2022 dhe 2023. Të dy dokumentet përmbajnë ndër të tjera aktivitete të cilat nuk janë realizuar.

Gjetja Nr. 8 Mbi dobësitë në sistemin e vlerësimit e monitorimit të MFK-së.	
Subjekti i audituar	AMBU
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	AMBU Titullari, GMS,.
Përmbledhja bazës ligjore	VKM nr. 221, datë 26.4.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore” i ndyshuar. -Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin; Manuali për MFK; Udhëzimi i Ministrisë të Financave”Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë e sistemit të Brendshëm”.
Përshkrim i Gjetjes	Situata: -Është përgatitur dhe dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë paketa dokumentare për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin për vitin 2021 dhe 2022 duke respektuar afatet e përcaktuara në kuadrin rregullator. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se janë hartuar dokumentet e Planit të masave për menaxhimin financiar dhe kontrollin si për vitin 2021 dhe 2022 dhe nga auditimi rezultoi se të dy dokumentet në rubrikën aktivitete të planifikuara janë të njëjta, të pa përditësuara dhe në rubrikën datat e pritshme të realizimit të aktiviteteve janë vendosur afatet e viteve korente 2021 dhe 2022, në vend të vendosjes së vitit pasardhës 2022 dhe 2023. Të dy dokumentet përmbajnë ndër të tjera aktivitete të cilat nuk janë realizuar. Kriteri: Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, Manuali për MFK e Udhëzimi i Ministrisë të financave”Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë e sistemit të Brendshëm”. Ndikimi/Efekti: Nuk ka efekt financiar. Mos përcaktimi i saktë aktiviteteve të planifikuara për tu ndërmarrë, me qëllim zgjidhjen e mangësive të zbuluara gjatë përgatitjes Planit të ngritjes dhe zhvillimit të MFK-së, sjell për pasojë mosfunksionimin efektiv të sistemit të MFK-së në institucion. Shkaku: Moszbatimi i kërkesave të kuadrit rregullator.
Niveli i Riskut	I mesëm
Konkluzion	Sistemi i vlerësimit dhe monitorimit të MFK-së në disa aspekte paraqet dobësi për të cilat nevojitet ndërmarrja e kontrolleve shtesë dhe masave korrigjuese për përmirësim.
Rekomandim	Nga Titullari i institucionit dhe Drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të merren masa për: b) Hartimin e dokumentit të Planit të masave për menaxhimin financiar dhe kontrollin, bazuar në identifikimin e aktiviteteve që synojnë korrigjimin e dobësive dhe mangësive të rezultuar nga procesi i vlerësimit të sistemit dhe që do të kryhen përgjatë vitit të ardhshëm fiskal. b) Monitorimin e zbatimit të aktiviteteve të planifikuara në vijimësi për gjatë vitit.

	c) Paketa e dokumenteve të MFK-së, të diskutohet nga Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe më pas të procedohet me dërgimin në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	<i>Në vijimësi.</i>
Statusi rekomandimit	Pranuar.

Përsa i përket monitorimit të zbatimit të projektit rezulton:

-Në funksion të monitorimit dhe vlerësimit të progresit të arritjes së objektivave, janë kryer raportet mbi analizën e performancës institucionale përfshi analizën e ecurisë /progresit zbatimit të projektit.

-Janë kryer raportet e monitorimit të performancës buxhetore, periodike (4 mujore) dhe në nivel vjetor, të cilat janë dërguar në Ministrinë e Financave me nr.109 prot., datë 17.1.2022 dhe nr.136/1 prot., datë 20.1.2023. Këto raporte përmbajnë analiza të dedikuara për realizimin e fondeve me financim të huaj dhe të brendshëm referuar projektit “Mbështetja e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit, në Shqipëri”.

-Nga Sektori i Projekteve me Financim të Brendshëm dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, rezultojnë një sërë komunikimesh me pikat e kontaktit për të ndjekur monitoruar ecurinë e zbatimit të projektit dhe përmbushjen e detyrimeve për zbatimin e aktiviteteve.

Janë marrë informacionet dhe hartuar Raportet vjetore të implementimit të Projektit AIR për vitin 2021 dhe 2022.

Konkluzion: Sistemi i monitorimit të projektit nga institucioni i AMBU-t, rezulton i përshtatshëm.

2. *Mbi përmbushjen e detyrimeve për alokimin e fondeve të buxhetit për të rimbursuar TVSH-në, në lidhje me koston lokale në zbatim të marrëveshjes.*

Në pikën nr. 2, të nenit 4 të Marrëveshjes së projektit, janë përcaktuar *detyrimet specifike të përfituesit* që përfshinë ndër te tjera:

Pika 4. Ofrimi i alokimit të nevojshëm buxhetor për të rimbursuar TVSH-në në lidhje me koston lokale të Agjencisë Austriake për Zhvillim, të përfaqësuar nga Zyra e Koordinimit për Bashkëpunim Teknik të Ambasadës Austriake në Tiranë.

5. Garantimi që dispozitat e përgjithshme për Doganat dhe Përjashtimet Tatimore dhe kushtet për Institucionet e Jashtme, OJQ-të dhe shoqëritë që specifikohen në nenin 5 dhe 6 të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Austrisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin për Zhvillim, zbatohen në kontekstin e zbatimit të Projektit.

2.1 Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të fondeve me financim të huaj dhe të brendshëm për Projektin "Mbështetje e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri".

Nga auditimi i zbatimit të procedurave për planifikimin e fondeve të projektit, në dokumentet e PBA-së rezultoi:

1. Janë zbatuar afatet kohore të dërgimit të PBA-së sipas fazave.

2. Në Dokumentet e PBA-ve respektive, janë përfshirë dhe fondet e planifikuara për Projektin "Mbështetje e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri" si për shpenzimet e investimeve financim i huaj (kapitull 02) dhe financim i brendshëm fondet e TVSH (kapitull 04).

Nga auditimi u konstatua se janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë shkresat e PBA përkatësisht:

- Shkresa me nr.890 prot., datë 24.8.2020 "Dërgimi i PBA 2021-2023 Faza II".
- Shkresa me nr.588 prot., datë 23.4.2021 "Dërgimi i PBA 2022-2024 Faza I".
- Shkresa me nr.1093/1 prot., datë 2.8.2021 "Dërgimi i PBA 2022-2024 Faza II".
- Shkresa me nr.1706 prot., datë 13.12.2021 "Dërgimi i PBA 2022-2024 Faza III".
- Shkresa me nr.877 prot., datë 29.4.2022 "Dërgimi i PBA 2023-2025 Faza I".
- Shkresa me nr.1470 prot., datë 30.8.2022 "Dërgimi i PBA 2023-2025 Faza II".
- Shkresa me nr.2061 prot., datë 16.12.2022 "Dërgimi formatin nr.2 "Politikat ekzistuese" të PBA 2023-2025".

Nga auditimi i saktësisë së planifikimit të fondeve për dy kategoritë e financimit të huaj apo të brendshëm, rezultuan mangësi pasi:

-Në dokumentet e PBA-së dërguar përgjatë vitit 2021 rezultoi se për dy fazat e para janë adresuar kërkesa buxhetore edhe për vitet 2022, 2023 dhe 2024 ndërkohë që referuar marrëveshjes së projektit nuk parashikohej implementimi i projektit edhe përgjatë vitit 2024 apo 2025.

-Me dokumentet e PBA-së për vitin 2022 përgjatë tre fazave janë kërkuar fonde për tre vitet 2023, 2024 dhe 2025 ndërkohë që referuar marrëveshjes cikli i zbatimit të projektit nuk parashikon zbatimin përgjatë vitit 2024-2025.

Bazuar shkresave të PBA-së rezultoi se janë planifikuar fondet për rimbursimin e TVSH-së për Projektin "Mbështetje e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri" si në tabelën e mëposhtme.

PBA 2021-2022-2023, Viti 2020

Kaptulli	Financimi	Buxheti 2020	Planifikuar PBA 2021	Planifikuar PBA 2022	Planifikuar PBA 2023	Tavanet 2021	Tavanet 2022	Tavanet 2023	Buxheti i miratuar 2021	Fakt (shpenzuar) 31.12.2021	Realizimi në %
02	Financim i huaj (Projekti ADA & BE)	93,000	93,000	93,000	93,000	93,000	93,000	93,000	93,000	87,897	95%
04	Kosto lokale (TVSH Projekti ADA & BE)	2,000	7,000	7,000	7,000	17,000	17,000	17,000	12,000	3,733	31%
Totali		95,000	100,000	100,000	100,000	110,000	110,000	110,000	105,000	91,631	87%

PBA 2022-2023-2024, Viti 2021

Kaptulli	Financimi	Buxheti 2021	Faza I			Faza II		
			Planifikuar PBA 2022	Planifikuar PBA 2023	Planifikuar PBA 2024	Planifikuar PBA 2022	Planifikuar PBA 2023	Planifikuar PBA 2024
02	Financim i huaj (Projekti ADA & BE)	93,000	93,000	93,000	93,000	93,000	93,000	93,000
04	Kosto lokale (TVSH Projekti ADA & BE)	12,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000

PBA 2023-2024-2025, Viti 2022

Kaptulli	Financimi	Buxheti 2022	Faza I			Faza II	
			Planifikuar PBA 2023	Planifikuar PBA 2024	Planifikuar PBA 2025	Planifikuar PBA 2023	Planifikuar PBA 2024
02	Financim i huaj (Projekti ADA & BE)	93,000	93,000	93,000	93,000	93,000	93,000
04	Kosto lokale (TVSH Projekti ADA & BE)	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000
Totali		103,000	103,000	103,000	103,000	103,000	103,000

PBA 2023-2024-2025, Viti 2022

		Faza III						Ne 000 leke			
Kaptulli	Financimi	Buxheti 2022	Planifikuar PBA 2023	Planifikuar PBA 2024	Planifikuar PBA 2025	Tavanet 2023	Tavanet 2024	Tavanet 2025	Buxheti i miratuar janar-mars 2023	Fakt (shpenzuar) 31.3.2023	Realizimi në %
02	Financim i huaj (Projekti ADA & BE)	93,000	93,000	93,000	93,000	93,000	93,000	93,000	-	-	0%
04	Kosto lokale (TVSH Projekti ADA & BE)	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	-	-	0%

-Për planifikimin e kërkesave buxhetore, nuk rezulton komunikim me Njësinë e Zbatimit të Projektit për të marrë projeksionet buxhetore, duke konsideruar dhe realizimet deri në vitin korrent, pasi struktura e financës disponon raportet e shpenzimeve në nivel mujor të financimit të huaj të cilat raportohen AMBU-t nga Njësia e Zbatimit të Projektit edhe elektronikisht dhe fizikisht.

Konkluzion: Sistemi i planifikimit të fondeve të investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm për projektin " Mbështetje e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri" në disa aspekte paraqet mangësi me efekt angazhim jo të saktë të fondeve në dokumentet e planit të buxhetit dhe për të cilat nevojitet ndërmarrja a masave korrigjuese (kontrolle shtesë).

Gjetja Nr.9 Mbi mangësitë e sistemit të planifikimit të fondeve të investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm për projektin " Mbështetje e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri"	
Subjekti i audituar	AMBU
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	AMBU, Titullari. Nëpunësi zbatues.GMS.
Përmbledhja e bazës ligjore	- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm".
Përshkrim i Gjetjes	Situata Në dokumentet e PBA-së dërguar përgjatë vitit 2021 rezultoi se për dy fazat e para janë adresuar kërkesa buxhetore edhe për vitet 2022, 2023 dhe 2024 ndërkohë që referuar marrëveshjes së projektit nuk parashikohej implementimi i projektit edhe përgjatë vitit 2024 apo 2025.

	<p>-Me dokumentet e PBA-së për vitin 2022 përgjatë tre fazave janë kërkuar fonde për tre vitet 2023, 2024 dhe 2025 ndërkohë që referuar marrëveshjes cikli i zbatimit të projektit nuk parashikon zbatimin përgjatë vitit 2024-2025.</p> <p>-Për planifikimin e fondeve të periudhave të ardhshme nuk janë marrë nga Njësia e Zbatimit të Projektit projektionet buxhetore dhe nuk janë konsideruar shpenzimet faktike të fondeve deri në momentin e hartimit të PBA-së.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Metodologjia e përdorur ndikon negativisht në rregullshmërinë e saktësinë e planifikimit të fondeve të PBA-së.</p> <p>Shkaku: Mos zbatim i kërkesave të kuadrit rregullator.</p>
Niveli i Riskut	I Larte
Konkluzioni	Metodologjia e përdorur për planifikimin e fondeve të investimeve për projektin rezultoi me mangësi për të cilat nevojitet marrja e masave për përmirësimin e gjëndjes.
Rekomandim	<p>Nëpunësi zbatues në kuadër të përgatitjes së dokumentit të PBA-së të marrë masa që:</p> <p>1-Të adresojë kërkesën për informacion Njesisë së Zbatimit të Projektit për vlerën e projeksioneve buxhetore.</p> <p>2- Të konsiderojë realizimet faktike të financimit të huaj të projektit me qëllim planifikimin e saktë të financimit të huaj dhe të brendshëm (TVSH).</p>
Afati i fundit zbatimit të Rekomandimit	<i>Në vijimësi gjatë fazave të përgatitjes së PBA-së.</i>
Statusi rekomandimit	Pranuar.

-Mbi rregullshmërinë e likuidimit të shpenzimeve për rimbursim për TVSH.

Nga auditimi i zbatimit të rregullshmërisë së likuidimit të fondeve për TVSH-në rezultoi se:

1. Likuidimi i shpenzimeve ishte kryer bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga projekti (Mbështetje e Bashkimit Europian për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri”).

2. Nga auditimi i Urdhër Shpenzimeve të rimbursimit të TVSH-së si dhe dokumentacionit bashkëlidhur, për periudhën objekt auditimi, rezultoi se:

i) Kërkesat e ardhura nga projekti për rimbursimin e TVSH-së janë të protokolluara dhe më pas është kryer rimbursimi i TVSH-së, i cili vetëm në një rast (nga 10 raste gjithsej) rezulton të jetë kryer likuidimi një muaj pasi është bërë kërkesa nga projekti (USHP nr.103, datë 11.4.2021, kërkesa e ardhur me nr. 374, prot. AMBU, datë 11.3.2021, likuidimi është kryer me vonesë për shkak të çeljes së investimeve për vitin 2021, në muajin prill 2021, e vërtetuar nëpërmjet evidencave mujore me degën e thesarit (janar, shkurt, mars, prill) dhe konkretisht:

Nr.	USHP, Nr.,Dt.	Kerkese, nr.,dt.	Prot.nr.dt.	Vlerta e TVSH	Periudha e faturave të likuiduara	Diferenca
1	103 dt.21.4.2021	11 dt. 9.3.2021	374 dt.11.3.2021	578,310	dhjetor 2020, janar-shkurt 2021	40 ditë
2	130 dt.19.5.2021	12 dt.6.5.2021	631 dt.18.5.2021	399,248	mars-prill 2021	1 dite
3	198 dt.21.7.2021	13 dt.8.7.2021	974 dt.18.7.2021	705,771	maj-qershor 2021	3 dite

4	256 dt.5.10.2021	14 dt.9.9.2021	1246 dt.14.9.2021	539,025	korrik-gusht 2021	21 dite
5	302 dt.17.11.2021	15 dt.8.11.2021	1555 dt.15.11.2021	872,219	shtator-tetor 2021	2 dite
6	343 dt.21.12.2021	16 dt.17.12.2021	1725 dt.20.12.2021	638,653	nentor-dhjetor 2021	1dite
	TOTALI 2021			3,733,226		
7	95 dt.21.4.2022	17 dt.11.4.2022	774 dt.12.4.2022	461,714	janar- mars 2022	9 dite
8	150 dt.9.6.2022	18 dt.3.6.2022	1078 dt.7.6.2022	793,248	prill-maj 2022	2 dite
9	204 dt.10.8.2022	19 dt. 2.8.2022	1393 dt.3.8.2022	424,080	qershor-korrik 2022	7 dite
10	309 dt.24.11.2022	20 dt.2.11.2022	1812 dt.3.11.2022	169,639	gusht-tetor 2022	21 dite.
	TOTALI 2022			1,848,681		

i) U auditua rregullshmëria e faturave të likuiduara dhe rezultoi se në dy raste faturat e paraqitura nuk ishin të konfirmuara nga blerësi (projekti) dhe në një rast me të drejtë ishte prapësuar (nuk ishte likuiduar fatura).

Nr.	USHP, Nr.,Dt.	Vlerat e TVSH	Periudha e faturave te likuiduara	Totali i tabelës a përputhet me vlerën e likuiduar?	Vlera e TVSH përputhet me vlerën e tabelës dhe faturës?	Shënime
1	103 dt.21.4.2021	578,310	dhjetor 2020,janar-shkurt 2021	po	po	
2	198 dt.21.7.2021	705,771	maj-qershor 2021	po	Po	
3	130 dt 19.5.2021	399,248	mars-prill 2021	po	Po	Fat.ne shumën e tvsh 18239.52 lekë e pakonfirmuar, Fat. në shumën e tvsh 15640.22 lekë e pakonfirmuar.
4	256 dt.5.10.2021	539,025	korrik-gusht 2021	jo	Po	diferenca 1,027 leke/e palikujduar
5	302dt.17.11.2021	872,219	shtator-tetor 2021	po	Po	
6	343dt 21.12.2021	638,653	nëntor-dhjetor 2021	po	Po	
7	95 dt.21.4.2022	461,714	janar- mars 2022	po	Po	
8	150 dt.9.6.2022	793,248	prill-maj 2022	po	Po	
9	204 dt.10.8.2022	424,080	qershor-korrik 2022	po	Po	
10	309 dt. 24.11.2022	169,639	gusht-tetor 2022	po	Po	

i) U konstatuan likuidime të faturave (të sjella nga Njësia e Zbatimit të Projektit) bashkëlidhur Urdhër Shpenzimeve të cilat përkasin periudhave të mëparshme 2-4 muaj, çka përbën risk të shtuar, në evidentimin real të shpenzimeve të kryera për TVSH-në në situacionet e shpenzimeve, apo në raportet e monitorimit të cilat i dërgohen Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Nr.	USHP, Nr.,Dt.	Kerkese, nr.,dt.	Prot.nr.dt.	Vlerat e TVSH	Periudha e faturave te likuiduara
1	103 dt.21.4.2021	11 dt. 9.3.2021	374 dt.11.3.2021	578,310	dhjetor 2020, janar-shkurt 2021
2	130 dt.19.5.2021	12 dt.6.5.2021	631 dt.18.5.2021	399,248	mars-prill 2021
3	198 dt.21.7.2021	13 dt.8.7.2021	974 dt.18.7.2021	705,771	maj-qershor 2021
4	256 dt.5.10.2021	14 dt.9.9.2021	1246 dt.14.9.2021	539,025	korrik-gusht 2021
5	302 dt.17.11.2021	15 dt.8.11.2021	1555 dt.15.11.2021	872,219	shtator-tetor 2021
6	343 dt.21.12.2021	16 dt.17.12.2021	1725 dt.20.12.2021	638,653	nentor-dhjetor 2021
TOTALI 2021				3,733,226	
7	95 dt.21.4.2022	17 dt.11.4.2022	774 dt.12.4.2022	461,714	janar- mars 2022
8	150 dt.9.6.2022	18 dt.3.6.2022	1078 dt.7.6.2022	793,248	prill-maj 2022
9	204 dt.10.8.2022	19 dt.2.8.2022	1393 dt.3.8.2022	424,080	qershor-korrik 2022
10	309 dt.24.11.2022	20 dt.2.11.2022	1812 dt.3.11.2022	169,639	gusht-tetor 2022
TOTALI 2022				1,848,681	

-Krahas sa me sipër rezultoi se të gjitha formatet e raportimit mujor të Njesisë së Zbatimit të Projektit të cilat paraqiten në AMBU, nuk rezultuan të konfirmuara nga projekti sikurse përcakton Udhëzimi nr. 35, datë 21.9.2020 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për kontrollin regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare”.

Gjetja Nr.10 Mbi sistemin e rimbursimit të TVSH-se dhe formatet e raportimit të fondeve të projektit.	
Subjekti i audituar	AMBU
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	AMBU Titullari, Nëpunësi zbatues.
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë. Udhëzimi nr. 35, datë 21.9.2020 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “Për kontrollin regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare”.
Përshkrim i Gjetjes	Situata - U auditua rregullshmëria e faturave të likuiduara dhe rezultoi se në dy raste faturat e paraqitura nuk ishin të konfirmuara nga blerësi (projekti) dhe në një rast me të drejtë ishte prapësuar (nuk ishte likuiduar fatura). -U konstatuan likuidime të faturave (të sjella nga Njësia e Zbatimit të Projektit) bashkëlidhur Urdhër Shpenzimeve të cilat përkasin periudhave të mëparshme 2-4 muaj. -Formatet e raportimit mujor të Njesisë së Zbatimit të Projektit të cilat paraqiten në AMBU, nuk rezultuan të konfirmuara sikurse përcakton Udhëzimi nr. 35, datë 21.9.2020 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “Për kontrollin regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare”. Ndikimi/Efekti: Përbën risk të shtuar, në evidentimin real të shpenzimeve të kryera për TVSH-në në situacionet e shpenzimeve, apo në raportet e monitorimit të cilat i dërgohen Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Shkaku: Mos zbatim i kërkesave të kuadrit rregullator.
Niveli i Riskut	I mesëm
Konkluzioni	Sistemi i rimbursimit të TVH-së dhe i bashkëpunimit me projektin, parë në disa aspekte, paraqet mangësi për të cilat duhet të merren masa korrigjuese.
Rekomandim	Sa më sipër rekomandojmë që: 1-Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa që të bashkëpunojë me Njësinë e Zbatimit të Projektit për: i) sigurimin në kohë të faturave për rimbursimin e TVSH-së në funksion të likuidimit të tyre ii)për dërgimin e formateve të raportimit mujor të konfirmuara. 2-Të merren masa që përpara likuidimit të ushtrohen kontrolle të zbatimit të rregullshmërisë të faturave konform kuadrit rregullator.
Afati i fundit zbatimit të Rekomandimit	<i>Në vijimësi .</i>
Statusi rekomandimit	Pranuar.

3-Mbi zbatimin e procedurave të raportimit të buxhetit faktik dhe monitorimit të fondeve të projektit.

Nga auditimi rezultoi se janë zbatuar procedurat konform kuadrit rregullator. (situacionet e shpenzimeve për TVSH, janë rakorduar me thesarin në nivel mujor dhe vjetor). Po kështu janë hartuar dhe dërguar në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë raportet peridodike (katërmujore) dhe vjetore të monitorimit të buxhetit ku në një seksion të veçantë, në kapitullin II, “Investimet” janë trajtuar dhe paraqitur analiza për projektin “Mbështetje e Bashkimit European për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri”.

Nga auditimi u konstatua se vlerat totale të TVSH të likuiduar rakordojnë me shumat totale në raportet e monitorimit të vitit 2021 dhe 2022 dhe me rakordimet me Thesarin, dhe konkretisht:

Në lekë

	Shuma totale e TVSH në Ushp.	Shuma totale e TVSH në rakordimet e thesarit.	Shuma totale e TVSH në raportet e monitorimit.
Viti 2021	3,733,226	3,733,226	3,733,226
Viti 2022	1,848,681	1,848,681	1,848,681

Realizimi i financimit të brendshëm për zërin TVSH të rimbursuar për dy vitet kundrejt planifikimit rezulton:

Emërtimi	Plani	Fakti	Realizimi
TVSH 2021	12,000,000	3,733,226	31%
TVSH 2022	10,000,000	1,848,681	18%

-Mbi hartimin e dokumenteve të gjurmëve të auditimit.

Nga auditimi u konstatua se nuk janë hartuar, gjurmët e auditimit për veprimtari që kanë të bëjnë me: i) Procedurat për përgatitjen e dokumentit të Projekt Buxhetit Afatmesëm, ii) Procedurat për monitorimin e performancës buxhetore e të objektivave, sikurse përcakton pika nr. 48/e Udhëzimit nr. 9, datë 20.7.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Gjetja Nr.11 Mbi mangësitë në hartimin e gjurmëve të auditimit.	
Subjekti i audituar	AMBU
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	AMBU Titullari. Nëpunësi zbatues.

Përmbledhja e bazës ligjore	-Ligji nr.10296, datë 08. 07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. -Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
Përshkrim i Gjetjes	Situata: -Nuk janë hartuar, gjurmët e auditimit për veprimtari që kanë të bëjnë me: a) Procedurat për përgatitjen e dokumentit të Projekt Buxhetit Afatmesëm;b) Monitorimin e performancës buxhetore e të objektivave . Kriteri: Ligji nr.10296, datë 08. 07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar; Udhëzimi nr. 9, datë 20.7.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika nr. 48/e Ndikimi/Efekti: Nuk ka efekt financiar por ndikon në mos ushtrimin e aktiviteteve të kontrollit parandalues, kryerjen e detyrave funksionale dhe arritjen e objektivave. Shkaku: Mos zbatim i kërkesave të kuadrit rregullator.
Niveli i Riskut	I lartë
Konkluzioni	Nuk janë vendosur aktivitete kontrolli përmes politikave dhe procedurave të shkruara për funksionimin efektiv të sistemeve.
Rekomandim	Nëpunësi zbatues, t’i propozojë Titullarit për miratim pasi të jenë shqyrtuar dhe miratuar më parë nga GMS: a)Gjurmët e auditimit për përgatitjen e dokumentit të Projekt Buxhetit Afatmesëm në të cilin të përfshihet dhe procedura e komunikimit me Njësinë e zbatimit të projektit për projeksionet buxhetore. b)Gjurmët e Auditimit për monitorimin e performancës buxhetore
Afati i fundit i zbatimit të Rekomandimit	Rekomandimi a) Në vijimësi sa herë përgatitet PBA Rekomandimi b) 15 dhjetor 2023.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

1.2 Mbi sistemin e evidentimit në kontabilitet dhe raportimit financiar të shpenzimeve të fondeve me financim të huaj dhe të brendshëm (TVSH) të projektit “Mbështetje e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri”.

Auditimi u krye në referencë të zbatimit të kërkesave të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar nga i cili rezultoi se:

1. Janë respektuar afatet e paraqitjes së pasqyrave financiare, në Degën e Thesarit konform, përcaktimeve të kuadrit rregullator dhe konkretisht: shkresa dërguar Degës së Thesarit me nr.707 prot., datë 31.3.2022 “Dërgojmë pasqyrat financiare për vitin 2021” si dhe shkresa me nr.503 prot., datë 29.3.2023 “Dërgojmë pasqyrat financiare për vitin 2022”.

2. Janë kryer rakordimet periodike dhe vjetore, për situacionet e shpenzimeve me Degën e Thesarit, përgjatë periudhës objekt auditimit (janar 2021-mars 2023) konform, përcaktimeve të kuadrit rregullator.

3. Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021 dhe 2022, rezultuan disa mangësi në plotësimin e tyre dhe konkretisht:

-Vlerat e shpenzimeve të investimeve të financimit të brendshëm për rimbursim TVSH nuk ishin evidentuar kontabilizuar si investime në proces por si aktive të kapitalizuara.

Në Formatin nr. 1 Pasqyra e Pozicionit financiar, shpenzimet e investimeve nuk rezultojnë në llogarinë 230 si investime në proces. (projekti ka qenë në proces zbatimi pra duhet të rezultojnë vlerat respektive në llogarinë 230 “Investime në proces” dhe në llogarinë 105 teprica e grantit kapital të brendshëm. Pas përfundimit të projektit do të procedohet me kontabilizimet e kapitalizimit të projektit.

Formati i bilancit “Investimet dhe burimet e financimit të tyre” rezultojnë pasaktësi për zërat: Llogaria 105 “Grante kapitale të brendshëm” rezulton në vlerën 0 pasi gabimisht është kontabilizuar në llogarinë 11 “Fonde të tjera bazë” (llogaria 115), “Caktim fondi për minvestime nga rezultati i vitit”.

Po kështu për investimet në proces duhet të plotësohej kolona “Teprica në fillim të vitit”, “debi kredi” dhe “Gjendja në fund”, por meqenëse TVSH është kontabilizuar si e kapitalizuar pra e përfunduar rezultojnë mangësitë si më sipër.

Në formatin “Shënime shpjeguese” rezultojnë pasaktësi: Në plan është vendosur e gjithë vlera e planifikuar e fondeve të projektit 105,000 mijë lekë dhe në fakt është vendosur vlera e financimit të brendshëm TVSH 3733 mijë leke. Për vitin 2022 në llogarinë e investimeve 230 është vendosur vlera e planifikuar e TVSh-së, pra financimi i brendshëm dhe nuk është vendosur vlera e financimit të huaj (kap. 02).

Gjetja Nr.12 Mbi mangësitë e hartimit te pasqyrave financiare.	
Subjekti i audituar	
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	AMBU Nëpunësi Zbatues,
Përmbledhja e bazës ligjore	- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022.
Përshkrim i Gjetjes	1.U konstatua se është respektuar afatit i paraqitjes së pasqyrave financiare, në Degën e Thesarit konform, përcaktimeve të kuadrit rregullator; 2. Janë kryer rakordimet periodike dhe vjetore, për situacionet e shpenzimeve me Degën e Thesarit, përgjatë periudhës objekt auditimi konform, përcaktimeve të kuadrit rregullator.

	3. Pasqyrat Financiare rezultojnë me mangësi në evidentimin e investimeve të projektit në Formatin nr. 1 Pasqyra e Pozicionit financiar Formatin i bilancit “investimet dhe burimet e financimit të tyre” dhe Formatin “Shënime shpjeguese”. Ndikimi/Efekti: Plotësimi me mangësi i pasqyrave ndikon në paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Shkak: Mos zbatim i kërkesave të kuadrit rregullator.
Niveli i Riskut	I lartë
Konkluzioni	Rezultatet e gjëndjes financiare të raportuar janë paraqitur me mangësi.
Rekomandim	Nëpunësi Zbatues për fondet e investimeve të projektit, të kryejë veprimet korrigjuese dhe të hartojë pasqyrën financiare të vitit 2023, konform përcaktimeve të Udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.
Afati i fundit zbatimit të Rekomandimit	<i>Deri 31 Mars 2024.</i>
Statusi rekomandimit	Pranuar.

Mbi detyrimin specifik të pikës nr.2 neni 4 të Marrëveshjes së Projektit.

Në pikën nr. 2, të nenit 4 të Marrëveshjes së projektit, janë përcaktuar *detyrimet specifike të përfituesit* që përfshinë ndër të tjera:

Pika 5. Garantimi që dispozitat e përgjithshme për Doganat dhe Përjashtimet Tatimore dhe kushtet për Institucionet e Jashtme, OJQ-të dhe shoqëritë që specifikohen në nenin 5 dhe 6 të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Austrisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin për Zhvillim, zbatohen në kontekstin e zbatimit të Projektit.

Sipas informacionit të paraqitur Grupit të Auditimit nga Nëpunësi zbatues rezulton se nuk ka patur raste të zbatimit/përmbushjes të këtij detyrimi specifik.

Opinion përgjithshëm:

Referuar auditimit të kryer sipas procedurave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, si dhe konstatimeve të evidentuara në projektraportin e auditimit, vlerësohet se sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm, përgjithësisht rezultojnë të përshtatshme por në disa aspekte paraqiten dobësi, për të cilat nevojitet ndërmarrja e masave organizative për përmirësimin e tyre në funksion të përmbushjes së objektivave.

V. FALENDERIMET

Për plotësimin e misionit të auditimit, grupi i punës falenderon Drejtorin e Përgjithshëm Znj. Gerta Lubonja dhe punonjësit e institucionit, për gadishmërinë e plotë që treguan për vënien në dispozicion të dokumentacionit, krijimin e kushteve të punës, bashkëpunimin gjatë gjithë kohës së auditimit dhe trajtimin e problemeve të konstatuara nga grupi i auditimit në zbatimin të standarteve të veprimtarisë audituese.

VI. FORMULARI I VLERËSIMIT

Pas përfundimit të angazhimit të auditimit të kryer, mirëpresim rekomandimet, të cilat do të shërbejnë për vlerësimin e performancës së Drejtorisë së Auditimit dhe për të identifikuar fushat ku përmirësimi në qasjen tonë do të ishte i dobishëm për institucionin dhe subjekte të tjera që do të auditohen.

Në funksion të vlerësimit të komponentëve të performancës bashkëlidhur është Aneksi nr. 3.

“Formulari i vlerësimit/reagimit nga subjekti i audituar” i cili pasi të plotësohet, të përcillet në Drejtorinë e Auditimit së bashku me Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

VII. PLANI I VEPRIMIT

Mbështetur në nenin 16 të Ligjit nr. 114, 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar, kapitullin IV pika 4 dhe 5 “Raportimi dhe Komunikimi i Auditimit”, “Sigurimi i Cilësisë së Punës” të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e manualit të procedurave të auditimit të brendshëm”, i ndryshuar, për eliminimin e mangësive të konstatuara, rritjen e nivelit të punës, auditimi ka dhënë *rekomandime* në Aneksin nr. 1 “Përmbledhëse e Rekomandimeve” të këtij Raporti.

Bazuar në nenin 12, germa d, e Ligjit 114 datë 22.20.2015, i ndryshuar, pikës nr. 3, të Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 14 datë 13.2.2017 “Për zbatimin e rekomandimeve të Auditimit të brendshëm” brenda 30 (tridhjetë) ditëve, nga data e marrjes së Raportit Përfundimtar të Auditimit, duhet të plotësohet, miratohet nga Titullari dhe të përcillet në Drejtorinë e Auditimit në Kryeministri, Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve i cili është bashkëlidhur Raportit Përfundimtar.

Grupi i auditimit *vlerëson* se zbatimin e rekomandimeve do të ndikojë në arritjen e objektivave të Institucionit, në zbatimin më të mirë të dispozitave ligjore, ndërkohë që menaxhimi i Institucionit duhet të marrë përsipër koston negative, rrisqet që mund të shkaktojnë mos zbatimin e tyre.

GRUPI I AUDITIMIT

Luljeta NANO



Engjellushe IBRALIU



PËRMBLEDHËSE E REKOMANDIMEVE

Nr.	REKOMANDIMET	Renditja sipas nivelit
1.	<p>Të merren masat për ngritjen e një grupi pune për:</p> <p>a) Reflektimin e përshtatjen në Rregulloren për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në AMBU dhe në Rregulloren e sjelljes së punonjësve të rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike, sikurse përcaktuar në Vendimin nr.874, datë 29.9.2021 të Këshillit të Ministrave;</p> <p>b) Rregulloret e ndryshuara të shqyrtohen paraprakisht nga Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe më pas të miratohen nga Titullari i institucionit.</p>	I lartë
2.	<p>Me qëllim funksionimin e strukturës së Sektorit të Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit me Donatorët e Huaj me kapacitet të plotë, konform organikës së miratuar, të merren masa për zbatimin e procedurave të rekrutimit në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike deri në plotësimin e vendit vakant.</p>	I lartë
3.	<p>Në funksion të implementimit të politikave të zhvillimit profesional, të mbajtjes së një personeli kompetent dhe meqenëse AMBU për periudhat në vijim është e angazhuar me implementimin e disa projekteve me financim të huaj, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse (përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore) në bashkëpunim dhe koordinim me Sektorin e Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët (PIU), të marrin masa për kryerjen e trajnimeve të stafit të Sektorit dhe sigurimin e pjesëmarrjes së tyre jo vetëm në trajnimet e organizuara nga ASPA dhe workshope të ndryshme të organizuara brenda vendit, por dhe në eventet, trajnime jashtë vendit për marrjen e eksperiencës nga praktikantët më të mira, duke planifikuar dhe efektin financiar.</p>	I mesëm
4.	<p>a) Të merren masa për dokumentimin e mbledhjeve, takimeve (jo më pak se katër herë në vit) të grupit të Menaxhimit Strategjik.</p> <p>b) Vendimet e marra nga GMS duhet të regjistrohen nga sekretari i GMS-së dhe të vihen në dispozicion të drejtimit të institucionit. (pika 2.2.4 e Udhëzimit nr.16, datë 20.07.2016).</p>	I mesëm
5.	<p>Me qëllim ngritjen dhe funksionimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të riskut, të merren masat si më poshtë vijon:</p> <p>a) Të hartohet dokumenti i planit strategjik të menaxhimit të trajtimit të risqeve dhe të merren masa për përditësimin e planit çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Ky dokument përpara miratimit nga Titullari, të diskutohet e miratohet nga GMS.</p> <p>b) Të analizohen dhe përditësohen, kontrollat që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit, bazuar në nenin 21 të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për MFK”, i ndryshuar në të cilin përcaktohet që: Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollat që synojnë minimizimin e riskut të paktën një herë në vit. Çdo menaxher i strukturës së AMBU, të analizojë regjistrin e risqeve për strukturën përkatëse, të identifikojë risqet me nivel të lartë dhe të përgatisë planin e veprimit për minimizimin e tyre sipas formatit të aneksit 3 të Udhëzimit nr.16, datë 20.7.2016</p> <p>“Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;</p>	I mesëm

Nr.	REKOMANDIMET	Renditja sipas nivelit
6.	Në funksion të sigurimit të një kuadri rregullativ të përshtatshëm, me qëllim ushtrimin e aktiviteteve të kontrollit dhe monitorimit të realizimit të objektivave e detyrave të caktuara, sigurimit të vendosjes dhe ndarjes së përgjegjësisë, të merren masa për zyrtarizimin dhe miratimin nga Titullari e menaxherët e njësive të brendshme strukturore (drejtori, sektor) të dokumenteve të Listës së Proceseve të Punës.	I lartë
7.	Meqenëse institucioni i AMBU-t, do të vijojë me projektin EUSIËM 2, nëpërmjet mbështetjes së sektorit të ujit, me instrumentin IPA III, të merren masa që: 1-Caktimi i personit zyrtar kryesor negocues për aktivitetin në emër të agjencisë dhe i punonjësve që do të luajnë rolin e pikave të kontaktit për çdo komponent të projektit të kryhet me shkresë zyrtare të miratuar nga Titullari. 2-Në rast largimi nga detyra të personave të pikave të kontaktit, për çdo rast dorëzimi i detyrës, të kryhet me procesverbal të konfirmuar nga të dy palët.	I mesëm
8.	1. Të merren masa që në funksion të sigurimit të gjurmës së auditimit të dokumentacioneve të trajnimeve, të kryera në kuadër të zbatimit të projektit dhe të dërguara në institucionin e AMBU-t, të ndërpritet praktika e marrjes dorazi të dokumentacionit dhe të procedohet me bërjen hyrje në institucion nëpërmjet zyrës/punonjësit së arkiv protokollit dhe bazuar në kartelën shoqëruese të administrohet, nga Sektori i Projekteve të Brendshme dhe Koordinimit të Projekteve me Donatorët. 2.Të kryhet inventarizimi i dosjeve të trajnimeve dhe të depozitohen në arkivin e institucionit.	I lartë
9.	Nga Titullari i institucionit dhe Drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të merren masa për: a) Hartimin e dokumentit të Planit të masave për menaxhimin financiar dhe kontrollin, bazuar në identifikimin e aktiviteteve që synojnë korrigjimin e dobësive dhe mangësive të rezultuar nga procesi i vlerësimit të sistemit dhe që do të kryhen përgjatë vitit të ardhshëm fiskal. b) Monitorimin e zbatimit të aktiviteteve të planifikuara në vijimësi për gjatë vitit. c) Paketa e dokumenteve të MFK-së, të diskutohet nga Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe më pas të procedohet me dërgimin në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë.	I mesëm
10.	Nëpunësi zbatues në kuadër të përgatitjes së dokumentit të PBA-së të marrë masa që: 1-Të adresojë kërkesën për informacion Njesisë së Zbatimit të Projektit për vlerën e projeksioneve buxhetore. 2- Të konsiderojë realizimet faktike të financimit të huaj të projektit me qëllim planifikimin e saktë të financimit të huaj dhe të brendshëm (TVSH).	I lartë
11.	1-Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa që të bashkëpunojë me Njësinë e Zbatimit të Projektit për: i) sigurimin në kohë të faturave për rimbursimin e TVSH-së në funksion të likuidimit të tyre ii)për dërgimin e formateve të raportimit mujor të konfirmuara. 2-Të merren masa që përpara likuidimit të ushtrohen kontrole të zbatimit të rregullshmërisë të faturave konform kuadrit rregullator.	I mesëm

Nr.	REKOMANDIMET	Renditja sipas nivelit
12.	<p>Nëpunësi zbatues, t'i propozojë Titullarit për miratim pasi të jenë shqyrtuar dhe miratuar më parë nga GMS:</p> <p>a)Gjurmët e auditimit për përgatitjen e dokumentit të Projekt Buxhetit Afatmesëm në të cilin të përfshihet dhe procedura e komunikimit me Njësinë e zbatimit të projektit për projeksionet buxhetore.</p> <p>b)Gjurmët e Auditimit për monitorimin e performancës buxhetore</p>	I lartë
13	<p>Nëpunësi Zbatues për fondet e investimeve të projektit, të kryejë veprimet korrigjuese dhe të hartojë pasqyrën financiare të vitit 2023, konform përcaktimeve të Udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.</p>	I larte

GRUPI I AUDITIMIT

LULJETA NANO



ENGJELLUSHE IBRALIU



Reagimi nga subjekti i audituar

Subjekti i audituar: Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU).
Angazhimi i auditimit: I kombinuar.
Data e raportimit: 21.9.2023

Pas përfundimit të angazhimit të auditimit të kryer në mirëpresim rekomandimet tuaja, për të na ndihmuar të vlerësojmë performancën e Drejtorisë së Auditimit dhe për të identifikuar fushat ku përmirësimi në qasjen tonë do të ishte i dobishëm për Ju dhe subjekte të tjera që do të auditohen.

Duke përdorur shkallën e vlerësimit si më poshtë, ju lutem rrethoni numrin në kolonën e djathtë që reflekton pikëpamjet tuaja në punën tonë në secilën nga fushat e përmendura.

✓ Shkalla e vlerësimit

(1)- Shumë të kënaqur (2)- Të kënaqur (3)- Të pakënaqur (4)- Shumë të pakënaqur

Nr.	Komponentet e Performancës (sa të kënaqur jeni?)	1	2	3	4	Komente
I	Planifikimi i auditimit					
1	Ju janë dhënë mundësi të përshtatshme për të rënë dakord në fushë veprimin e auditimit para se të fillonte puna audituese në terren ?					
2	Ju është dhënë njoftim i duhur për kohën dhe kohëzgjatjen e auditimit?					
II	Kryerja e Auditimit					
1	A kanë qenë audituesit e brendshëm profesionistë dhe të sjellshëm gjatë kryerjes të auditimit?					
2	A zotëronin audituesit e brendshëm njohuri të mjaftueshme në fushën e veprimtarisë tuaj?					
3	A ju është komunikuar në mënyrën e duhur progresi i angazhimit auditimit, duke përfshirë detajet e çështjeve kryesore që u shqyrtuan?					
III	Raportimi i Rezultateve të Auditimit					

1	Projekt raporti është marrë brenda një kohe të pranueshme të parashikuar? <i>Data e leshimit të Projekt Raportit 1.9.2023</i>					
2	Projekt raporti është prezantuar në mënyrë të qartë në lidhje me formatin dhe gjuhën e përdorur?					
3	Pas përgjigjeve të menaxhimit për komentet, raporti përfundimtar është marrë brenda një kohe të pranueshme të parashikuar?					
4	A ofruan rekomandimet zgjidhje praktike dhe konstruktive për çështjet e identifikuara?					
5	A është shpjeguar në mënyrë të kënaqshme argumentimi për gjetjet dhe përfundimet e auditimit?					
IV	Cilësia e Auditimit të Brendshëm					
1	A do të kontribuojë zbatimi i rekomandimeve në përmirësimin e menaxhimit të risqeve, të kontrollit dhe proceseve të qeverisjes?					
2	A kontribuon Auditimi i Brendshëm në përmirësimin dhe arritjen e objektivave strategjike të institucionit Tuaj?					
V	Shërbime të tjera të ofruara nga Auditimi i Brendshëm					
1	A keni dijeni se Njësia e Auditimit të Brendshëm në Kryeministri ofron shërbime këshillimi? (plotësohet me përgjigjen po ose jo në rubriken komente).					Po Jo

Shënim: Në qoftë se jepet një vlerësim 3 ose 4, ju lutem jepni më shumë hollësi në seksionin “Komente” në mënyrë që ne të mund të marrim parasysh si mund të përmirësohemi.